

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Qershor 2011 • Numri: 39 • E përmuajshme



NË RRJETËN E
INDIFERENCËS

www.revistaetika.com

EDITORIAL

O robërit e Zotit! Ju nuk jeni të ndryshëm nga ata që janë larguar nga kjo jetë. Ata jetuan më gjatë se ju, qenë më të fuqishëm dhe zotëronin vende më të zhvilluara dhe vepra më të pavdekshme sesa ato që keni ju. Pas disa brezash, zëri i tyre u sheshua, derisa nuk u ndie më. Trupat e tyre u kalbën, banesat e tyre mbetën të zbrazëta dhe veprat e tyre u shkatërruan. Ata i këmbyen sarajet e tyre të mrekullueshme, rehatinë e tyre dhe shtretërit me jastëkë prej atllasi, me varre të ngritura me gurë të ngulur mbi grumbuj dheu. Banesa e tyre e re është e ngushtë. Ata që banojnë brenda saj, janë të ngratë. Aty janë mes të të vetmuarve, të shqetësuarve për hallin e tyre dhe të të pasinqertëve. Komshinjtë nuk e vizitojnë njëri-tjetrin, ndonëse shtëpitë i kanë afër dhe muret ngjitur. Si ta vizitojnë njëri-tjetrin, përderisa koha i ka bluar dhe kanë ngrënë dhé e gurë. Pas jetës, shijuan vdekjen dhe, pas mirëqenies, hallet. U ndanë nga miqtë, zunë vend në dhé e u nisën drejt një udhëtimi që nuk ka kthim.

Ajme! Ata vetëm thonë më kot duke iu lutur Zotit që t'i krijojë sërish, se do të bëjnë punë të mira dhe do të jenë të përpiktë në kryerjen e tyre. Pas tyre ndodhen pengesa që nuk i lënë të kthehen pas, deri në çastin kur do të ringjallen sërish.

Së afërmi edhe ju do të mbërrini tek toka e të vdekurve dhe do të mbeteni aty si peng i punëve që keni bërë. Edhe ju do t'ju përqafojë një varr. Çfarë do të ndodhë me ju, kur gjithçka të ketë përfunduar? Të varrosurit do të ringjallen, do të dalin në shesh të fshehtat dhe do të qëndrojnë përpara një Gjykatësi Madhështor për të dhënë llogari. Zemrat dridhen nga frika e gjynaheve të kryera në këtë botë. Hiqen perdet e mbulesat dhe dalin në shesh të metat dhe të fshehtat tuaja. Aty të gjithë do të gjykohen për ato që kanë bërë. Ata që kanë bërë vepra të këqija do të dënohen për to, ndërsa ata që kanë bërë vepra të mira do të shpërblehen me të mirë. Kur të hapen regjistrat e veprave, ke për të parë se si mëkatarët do të dridhen nga frika e atyre që kanë bërë. Ata do të thonë: "Të mjerët ne! Si ka mundësi që ky regjistër ka ruajtur çdo gjë, sado e vogël të ketë qenë ajo". Të gjitha ato që kanë punuar janë shënuar në regjistrin e veprave. Zoti juaj nuk i bën padrejtësi asnjë njeriu.

O njeri! Mos u bëj si ai që shpreson të hyjë në xhenet, por nuk punon për këtë gjë, që ka shpresa jetëgjata, prandaj shtyn momentin e pendesës, që flet për këtë botë si ata që nuk janë të dhënë pas saj, por punon për këtë botë si ata që janë të dhënë pas saj, që nuk ngopet, sado që t'i jepet dhe nuk gjen rehati, po nuk i dhanë, që kërkon përherë e më shumë dhe nuk falënderon për atë që i jepet, që urdhëron të tjerët të bëjnë gjëra që vetë nuk i kryen dhe ua ndalon të tjerëve gjërat që i bën vetë, që nuk përpiket të jetë njeri i devotshëm (salih), megjithëse i do njerëzit e tillë, që është si njerëzit e këqinj, megjithëse nuk i do ata, që nuk e përmban veten të ndjekë pandehmat dhe dyshimet, duke lënë pas dore dituritë e sakta dhe të prera, që hazdiset sa më shumë që të pasurohet, që rri e qahet kur sëmuret, që bëhet pesimist kur bie në varfëri, që noton mes mëkateve, megjithë begatitë e shumta që i ka dhuruar Allahu, që nuk falënderon për shëndetin e mirë dhe nuk bën durim në fatkeqësi, që këshillat dhe paralajmërimet nuk i bëjnë dobi dhe, kur vdekja i shtie frikën, sillet sikur nuk ia ka frikën ai vetë, por të tjerët.

Do të lexoni:



Ahmet Tashgetiren /
Zgjoju nga gjumi i indiferencës

4



- Ahmet Tashgetiren / 4** Zgjoju nga gjumi i indiferencës
Ma. Gilman Kazazi / 10 Ndryshim drejt harmonizimit
Ismail H. Muçej / 12 Si ta luftojmë alkoolizimin
Edison Çeraj / 14 Mbi marrëdhënien e religjionit me moralin
Nexhat Ibrahimimi / 18 Besimi Islam në dritën e njohjes racionale
Sadik Dana / 22 Kopracia
Zimo Krutaj / 23 Ekran i lirë dhe shpërdorimi i lirisë
Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 26 Vorbulla e indiferencës
Ali Byjyqçapar / 29 Rëndësia e shkencave fetare në jetën tonë
Nuro Nazarko / 30 Totalitarizmi dhe tiparet e totalitarizmit komunist e fashist
Prof. dr. Selman Sheme / 34 Trojet shqiptare dhe trashëgimia shtetformuese

Nexhat Ibrahimimi /
Besimi Islam në dritën e njohjes racionale

18



Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz /
Vorbulla e indiferencës

26



Viti: VI | Numri: 39 | Qershor 2011

Administrator i Progresi botime:
Shuaqip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:
Alban Kali / Albert Halili / Artur Tagani
Drita Muça / Elvira Puka / Elona Sytari
Evans Drishti / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Redaktor:
Zija Vukaj
Korrektore:
Ma. Irida Hoti

Kopertina:
Edison Çeraj

Dizajn-Grafik:
Bledar Xama

Për artikuj
e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com
e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Qershor 2011

40

Osman Nuri Topbash /
Disiplina e dhurimit



Një Ajet - Një Hadith

Disiplina e dhurimit

Shpifja në moral
dhe masat ndëshkuese

38 / 39

40 / Osman Nuri Topbash

48 / Ma. sci. Flamur Sofiu

48

Ma. sci. Flamur Sofiu /
Shpifja në moral dhe masat ndëshkuese



Shkrimtari, personazhi, lexuesi i
vogël - marrëdhënie, raporte
dhe aspekte të komunikimit
artistik në poezinë për fëmijë
të Adelira R. Mamaqit

52 / Xhahid Bushati

Ndikimi i librit
"Muhtasar Sahihul-Buhari"
në jetën e përditshme
të një myslimani shqiptar

55 / Imam Muhamed Sytari

Ndërroi jetë Haxhi Faik Hoxha

58 /

Mesazhet e katër halifeve
me ardhjen në pushtet

60 / Imam Naim Drijaj

Zoologjia dhe shkenca
e veterinarisë

62 / Ma. Artur Tagani

Ebu Hasan Eshariu

64 / Enciklopedi Islame


Dy ndërtime të Sulltan Sulejmanit
në Vlorë:

67 / Ma. Ermal Nurja

Kalaja dhe Xhamia Muradije

60

Imam Naim Drijaj /
Mesazhet e katër halifeve me ardhjen në pushtet



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634

Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro



Zgjohu nga gjumi i indiferencës

Ahmet Tashgetiren

Allahu i lartësuar na njeh me veçoritë e atyre që i cilësoi si “indiferentët e vërtetë”, në ajetin 179 të sures Araf, duke i konsideruar “të tromaksur si bagëtitë, madje edhe më keq se ato” dhe fundin e rrugës së tyre në xhehenem:

“Ata kanë zemra, por nuk u vlejnë që të kuptojnë. Kanë sy, por nuk u vlejnë që të shohin. Kanë edhe veshë, por nuk u vlejnë që të dëgjojnë.”

Ndërsa në ajetin 108, të sures Nahl, për njerëzit e përkufizuar si “indiferentët vetë”, Ai përdor fjalët “personat që i kanë zemrat, veshët dhe sytë të vullosura nga vetë Allahu.”

Indiferenca (gaflet), nga këndvështrimi i Krijuesit, do të thotë vullosja e zemrës, veshëve dhe syve. Pra, që zemra të humbasë aftësinë e të konceptuarit, syri atë të shikimit dhe veshi atë të dëgjimit.

Sipas njohurive të Kuranit, shkalla më e ulët e kësaj (gafletit) është “më poshtë se kafsha”, ndërsa shkalla më e lartë “si kafsha”.

Sidoqoftë, indiferenca (gaflet) nuk përputhet

me natyrën e njeriut.

Kur i hedhim një vështrim Kuranit, kuptojmë se edhe bagëtia sheh, dëgjon, madje edhe ndjen në një shkallë të caktuar.

Njeriu përjeton vullosje të të gjithë aftësive të sipërpërmendura, kur është në gjendje indiference.

Çfarë janë ato gjëra që njeriu nuk i sheh, nuk i dëgjon dhe nuk i ndjen në gjendje indiference?

Çfarë nuk arrin të kuptojë?

Para së gjithash vetveten... nga ka ardhur dhe për ku është duke shkuar... Jetën, vdekjen... duart, krahët, sytë, zemrën, mendjen dhe gjithë këtë gjithësi... Qiellin, tokën... Ujin, diellin... Natën dhe ditën... Prindërit, fëmijët.

Krijuesin e të gjitha këtyre që numëruam...

Çfarë ka për të ngjarë pas vdekjes...

Kuptimin e veprimeve dhe sjelljeve të tij... Pasojat e të mirave dhe të këqijave...

Dallimin mes shtypjes dhe drejtësisë, mes së mirës dhe së keqes, hajrit dhe sherrit...

Kuptimin e ekzistencës...

Po sikur qëllimi i ekzistencës së njeriut të konsistojë në kuptimin e saktë të të gjitha këtyre gjërave dhe rregullin që duhet t'i japë jetës në varësi të tyre...

Atëherë njeriu indiferent nuk e kupton dot kuptimin e jetës dhe nuk e rregullon jetën e tij sipas këtij qëllimi.

Atëherë njeriu jeton më kot.

Ja pra, Krijuesi nuk dëshiron që njeriu të jetojë më kot.

Nuk dëshiron që njeriu të mendojë se është krijuar më kot.

Dëshiron që njeriu t'i japë kuptim ekzistencës së tij dhe ta perceptojë atë kuptim në përputhje me qëllimin e krijimit të Zotit.

Profetët dhe librat hyjnorë kanë ardhur që të ndërtojnë këtë gjendje ndërgjegjshmërie tek njeriu, pasi njeriu është krijesë që ka pikë të dobët vetmashttrimin.

Njeriu është një krijesë që mund ta mashtrosh shumë thjesht, madje shpeshherë ai mashton vetveten.

Prandaj edhe fjala hyjnore e paralajmëron në mënyrë të vazhdueshme njeriun.

Një zë i brendshëm e fton në mënyrë të vazhdueshme duke e paralajmëruar...

Mos u trego indiferent! Mos u trego indiferent! Tregohu vigjilent!

"Gjendja e besimit" është pikërisht kjo gjendje shpirtërore, kur perceptohet urtësia e ekzistencës dhe zemra lidhet pas kësaj urtësie.

Gjatë përkufizimit të moralit të besimtarëve në Kuran, na bëhet e ditur se asnjë gjë në botë nuk i pengon ata që ta përmendin Allahun dhe t'i kryejnë adhurimet që janë të detyrueshme për ta:

"Njerëzit që nuk i pengon as shitblerja dhe as tregtia ta përmendin Allahun, të falin namazin, të japin zekatin. Ia kanë frikën tmerrit të ditës kur do të çatrafillohen sytë dhe zemrat." (Nur Suresi, 37)

Njeriu, të cilin asnjë lidhje e kësaj bote "nuk e pengon ta përmendë Allahun" dhe që ndërton



"Përmende Zotin tënd, në vetvete, me përgjërime dhe drithërimë, me zë të ulët në mëngjes dhe në mbrëmje."

(A'raf, 205)



jetën e tij sipas varësisë ndaj Allahut, është njeriu që ndjen thellë në zemër shqetësimin e ditës kur do të bëhet vetëm një pyetje: **"Ku të ikim"** (ejne'l-mefer)...

Besimtari...

Personaliteti që Allahu e ka përkufizuar "burrë i vërtetë".

Allahu i Lartësuar thërret:

"Mos u bëj indiferent!"

"Përmende Zotin tënd, në vetvete, me përgjërime dhe drithërimë, me zë të ulët në mëngjes dhe në mbrëmje." (A'raf, 205)

Mos u ndaj prej Tij. Mos e harro. Dije se është pranë teje.

Në këtë botë, mos u bëj i verbër, as i shurdhër, as i pazemër.

Shiko ato që duhen parë. Dëgjo ato që duhen dëgjuar. Ndjej atë që duhet ndjerë.

Në të kundërt të pret dënimi në jetën e përherëshme. (Nahl, 109)

Allahu është çdo çast së bashku me ty. Ai është pranë teje më afër se damari yt i qafës. Ai di çdo gjë. Dëgjon çdo gjë. Sheh çdo gjë.

Jeto si ta shohësh Zotin me sytë e tu.

**“Mjerë ne! Si nuk e ditëm këtë gjë!
Sa indiferentë paskemi qenë!
Sa zullumqarë për veten tonë!”**

(Enbija, 97)

Mos harro se një ditë do të shkosh pranë Tij.

Mos harro se ka një jetë tjetër të përhershme.

Mos harro se kjo botë është kalimtare.

Mos harro se çdo gjë që bën, shkruhet diku dhe një ditë do të tregohen të gjitha duke të thënë:
“Lexoje librin tënd.”

Mos të të mashtrojë kjo botë me lojëra dhe dëf-rime.

Askush nuk ka jetuar përgjithmonë në këtë botë, që nuk ka stacion të amshueshëm.

“Qëndro me gjithë shpirt së bashku me ata që bëjnë dua, duke kërkuar kënaqësinë e Zotit në mbrëmje dhe në mëngjes. Mos e largo vëmendjen prej tyre për shkak të stolive të jetës së kësaj bote. Mos u nënshtro para atij, zemra e të cilit është aq indiferente, sa nuk na kujton Neve, që ndjek dëshirat e mbrapshta dhe nuk merret me gjë tjetër vetëm me gjëra ekstreme.” (Kehf, 28)

Mos prefero jetën e kësaj bote përpara jetës tjetër.

Kur të afrojnë premtimi i vërtetë, mos u bëj nga mohuesit me sy të shtangur që bërtasin: **“Mjerë ne! Si nuk e ditëm këtë gjë! Sa indiferentë paskemi qenë! Sa zullumqarë për veten tonë!”** (Enbija, 97)

Enigma e jetës është të perceptosh marrëdhënien tënde me Zotin e Gjithësisë...

Ai është me ne. Po ne, me kë jemi? Ai na sheh ne. A arrijmë ta ndjejmë këtë gjë? Ai di çdo situatë tonën. A jetojmë ne një jetë duke qenë të ndër-gjegjshëm për këtë?

Enigma e jetës është të perceptosh se kjo jetë ka një fund... Ja tek duket edhe fundi i saj... Ka nga ata që e kanë parë që në fillim. Nuk e shohin ata që kanë mbyllur sytë përpara kësaj të vërtete. Ata që kanë lëshuar perden e indiferencës mbi zemrat e tyre. Po shkojmë drejt saj. Drejt mejdanit të llogarisë së madhe... Mahsherit... para Zotit... rru-

ga kalon dhe ne shkojmë drejt saj. Këmbët ecin edhe kur dëshirojmë të ndalojmë. Madje edhe në këtë çast ne jemi në rrugën tonë drejt saj. Nuk ka çast frymëmarrjeje që të mos lëvizim drejt saj.

Le të shkojmë drejt saj me petka të bardha.

Me zemër të bardhë...

Me sy të pastër...

Me duar të pastra...

Me një libër jete të dëlirë...

Pa shih, a i ke duart e tua të pastra?

Kë ke në zemër, pa shihe një herë. Pa shih nëse do të mund të dalësh së bashku me atë që ke në zemër përpara Allahut.

Pa shih se si na ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut:

- Kërkojini Allahut t’u ruajë nga ajo gjendje ku përzihen me njëra-tjetrën hushu-ja dhe dyfytyrësia.

- Si mund të bjerë njeriu në këtë gjendje, o i Dërguari i Allahut? – e pyetën.

- Atëherë kur trupi është në hushu, ndërsa zemra juaj dyfytyrëshe.

Pra... Trupi është në hushu, por zemra në dyfytyrësi. Si mund të ngjajë një gjë e tillë? Le të shohim veprat tona.

Pa shih se çfarë na thotë i dashuri i të Dërguarit të Allahut:

- Nuk ka hajër në fjalën që nuk thuhet për hir të Zotit. As në pasurinë që nuk shpenzohet në rrugën e Zotit. (Ebu Bekr r.a.)

Pa shih çfarë na mëson një tjetër sahab i të Dërguarit të Allahut:

- Më i zgjuari nga ju është ai që e kujton vdekjen e tij më shumë. Më i përgatituri dhe më i kujdesshmi ndër ju është ai që përgatitet më së shumti për atë që do të ndodhë pas vdekjes.” (Ebu Derda r.a.)

Ja një këshillë tjetër e sahabiut drejtuar një sahabin tjetër:

- O Amr! Kija frikën Allahut për çdo veprim të fshehtë apo publik që kryen. Ai të sheh ty dhe punët që bën.” (Ebu Bekri drejtuar Amr b. As)

Si mund të sillet me indiferentizëm zemra, e cila ka kuptuar këto paralajmërime të Aliut (r.a.):

- O robërit e Zotit! Ju nuk jeni të ndryshëm nga ata që janë larguar nga kjo jetë. Ata jetuan më gjatë se ju, qenë më të fuqishëm dhe zotëronin vende më të zhvilluara dhe vepra më të pavdekshme sesa ato që keni ju. Pas disa brezash, zëri i tyre u sheshua, derisa nuk u ndie më. Trupat e tyre u kalbën, banesat e tyre mbetën të zbrazëta dhe veprat e tyre u shkatërruan. Ata i këmbyen sarajet e tyre të mrekullueshme, rehatinë e tyre dhe shtretërit me jastëkë prej atlasi, me varre të ngritura me gurë të ngulur mbi grumbuj dheu. Banesa e tyre e re është e ngushtë. Ata që banojnë brenda saj, janë të ngratë. Aty janë mes të të vetmuarve, të shqetësuarve për hallin e tyre dhe të të pasinqertëve. Komshijtë nuk e vizitojnë njëri-tjetrin, ndonëse shtëpitë i kanë afër dhe muret ngjitur me njëri-tjetrin. Si ta vizitojnë njëri-tjetrin, përdërisa koha i ka bluar dhe kanë ngrënë dhé e gurë. Pas jetës, shijuan vdekjen dhe, pas mirëqenies, hallet. U ndanë nga miqtë, zunë vend në dhé e u nisën drejt një udhëtimi që nuk ka kthim.

Ajme! Ata vetëm thonë më kot duke iu lutur Zotit që t'i krijojë sërish, se do të bëjnë punë të mira dhe do të jenë të përpiktë në kryerjen e tyre. Pas tyre ndodhen pengesa që i pengojnë të kthehen pas, deri në çastin kur do të ringjallen sërish."

Radha do të vijë tek ne, tek ju... Aliu (r.a.), na tërheq vëmendjen:

"Së afërmi edhe ju do të mbërrini tek toka e të vdekurve dhe do të mbeteni aty si peng i punëve që keni bërë. Edhe ju do t'u përqafojë një varr. Çfarë do të ndodhë me ju, kur gjithçka të ketë përfunduar? Të varrosurit do të ringjallen, do të dalin në shesh të fshehtat dhe do të qëndrojnë përpara një gjykatësi madhështor për të dhënë llogari. Zemrat dridhen nga frika e gjynaheve të kryera në këtë botë. Hiqen perdet e mbulesat dhe dalin në shesh të metat dhe të fshehtat tuaja. Aty të gjithë do të gjykohen për ato që kanë bërë. Ata që kanë bërë vepra të këqija do të dënohen për to, ndërsa ata që kanë bërë vepra të mira do të shpërblehen me të mirë. Kur të hapen regjistrat e veprave, ke për të parë se si mëkatarët do të dridhen nga frika e atyre që kanë punuar. Ata do të thonë: "Të mjerët ne! Si ka mundësi që ky regjistër ka ruajtur çdo gjë, sado e vogël të ketë qenë ajo". Të gjitha ato që kanë punuar janë shënuar në regjistrin e veprave. Zoti juaj nuk i bën padrejtësi asnjë njeriu".

Pastaj Aliu (r.a.), na përshkruan "njeriun indife-



rent", duke na këshilluar që të mos bëhemi kurrë të tillë dhe thotë:

"O njeri! Mos u bëj si ai që shpreson të hyjë në xhennet, por nuk punon për këtë gjë, që ka shpresa jetëgjata, prandaj shtyn momentin e pendesës, që flet për këtë botë si ata që nuk janë të dhënë pas saj, por punon për këtë botë si ata që janë të dhënë pas saj, që nuk ngopet, sado që t'i jepet dhe nuk gjen rehati, po nuk i dhanë, që kërkon përherë e më shumë dhe nuk falënderon për atë që i jepet, që urdhëron të tjerët të bëjnë gjëra që vetë nuk i kryen dhe ua ndalon të tjerëve gjërat që i bën vetë, që nuk përpriqet të jetë njeri i devotshëm (salih), megjithëse i do njerëzit e tillë, që është si njerëzit e këqinj, megjithëse nuk i do ata, që nuk e përmban veten të ndjekë pandehmat dhe dyshimet, duke lënë pas dore informacionet e sakta dhe të prera, që hazdiset sa më shumë që të pasurohet, që rri e qahet kur sëmuret, që bëhet pesimist kur bie në varfëri, që noton mes mëkateve, megjithë begatitë e shumta që i ka dhuruar Allahu, që nuk falënderon për shëndetin e mirë dhe nuk bën durim në fatkeqësi, që nuk i bëjnë dobi këshillat dhe paralajmërimet dhe, kur vdekja i shtie frikën, sillet sikur nuk ia ka frikën ai vetë, por të tjerët."

Pastaj Aliu e këshillon me këto fjalë Hasanin, të cilin e thërriste me dashuri edhe "drita e syve të mi":

"Bota të merr me të mirë nganjëherë, a thua se dëshiron të të jepet ty e gjitha. Mos u mashtro me këtë dredhi të sajën... nganjëherë të kthen shpinën, sikur arratiset prej teje, por edhe kësaj mos i kushto rëndësi..."

Bota është dëshmitare shumë e çuditshme, nuk di të të bëhet e dashur.

**“Tri gjëra më bëjnë edhe të qesh,
edhe të qaj. Njeriu që kërkon
këtë botë, megjithëse
e thërret ora e vdekjes,
njeriu indiferent që nuk i lë të tjerët
të tregohen indiferentë me të
dhe njeriu që rri e qesh
me të madhe, megjithëse nuk e di
nëse Zoti është i kënaqur
apo është i zemëruar me të.”**

Ndarja prej saj ngjason me njerëzit e ftohtë që përherë ta thyejnë zemrën.

Shkurtimisht bota e ka të paktë hajrin, të shkurtër vitalitetin, të rrejshme buzëqeshjen, të tmerrshme braktisjen, të përkohshme kënaqësinë, kalimtare begatinë, të përhershëm mëkatin...

Prandaj mëso të përgatitesh sa më shpejt për kapitalin tënd të jetës tjetër, pa mbaruar koha, pa të shterrur fuqia, pa u hequr perdja e indiferencës, duke ia ditur vlerën lirisë së kohës dhe shansit të mundësisë!...”

Po ky Ali (r.a.), i shkruan këto fjalë valiut të tij Malik bin Eshterit:

“Në qoftë se posti që ke të bën të ndihesh madhështor dhe mendjemadh, mendo për fuqinë e Allahut që rëndon mbi ty. Kujto fuqinë e Tij, kur përballësh me gjëra që nuk je i aftë t’i kryesh, sepse, kur mendon këtë gjë, atëherë shikimi yt që sheh shumë lart, zbret në tokë dhe kështu zhduket forca jote shtypëse mbi të tjerët.

Mos bëj gabim të mendosh të krahasohesh me madhësitinë e Zotit. Mos të të shkojë ndër mend të ngjasosh me Zotin për nga madhështia, sepse Zoti bën që të shtypet çdo dorëhekurt dhe të nënvleftësohet çdo prepotent.”

Ja dhe fjalët e një sahabiu tjetër:

“Pendesa më e keqe është ajo që bëhet në momentet e vdekjes. Dritëshkurtri më i keq është zemra e verbër.” (Abdullah bin Mesud r.a.)

Ja dhe këshilla e Muadh bin Xhebelit, të cilin

profeti Muhamed e pati quajtur mik të ngushtë:

“O bir! Kur të jesh duke falur namaz, mendo sikur ai namaz të jetë i fundit që po fal! Mos shpresoj se do të kesh aq kohë të jetosh sa të mbërrish namazin tjetër! Besimtari duhet të vdesë në një kohë që mbetet mes dy punëve të hajrit. Pra, të jetë i vendosur me zemër që të kryejë një punë tjetër të hajrit, sapo ta ketë përfunduar një të tillë.”

Lexoni këtë bashkëbisedim mes profetit Muhamed dhe Muadh bin Xhebel:

Një ditë shkova tek i Dërguari i Allahut. Më pyeti:

- Si je zgjuar këtë mëngjes o Muadh?

Unë iu përgjigja:

- Jam zgjuar me besim tek Zoti o i Dërguari i Allahut!

Profeti më tha:

- O Muadh! Çdo gjë që thua e argumenton. Po këtë që the si e argumenton?

Unë iu përgjigja:

- O i Dërguari i Allahut! Kur hyn dita, unë nuk shpresoj se do ta mbërrij mbrëmjen. Kur ngryset, nuk shpresoj se do të jetoj aq gjatë sa të kap agimin. Kur hedh një hap, nuk pandeh se do të mund ta hedh hapin e dytë. E di se çdo njeri ka një moment vdekjeje. Të gjithë njerëzit kanë për t’u ringjallur në mahsher. Disa do të bashkohen me profetët që kanë pasur, të tjerët me të adhuruarit e tyre. Çdo gjë e mendoj sikur jam duke pasur para sysh dënimet e njerëzve në xhehenem dhe begatitë e njerëzve në xhenet.

Pas këtyre fjalëve Profeti tha:

- O Muadh! Sa mirë bën që vepron kështu! Vazhdo të mendosh kështu!

Po ky Muadh bin Xhebel (r.a.), që kërkonte paqen e brendshme përherë thoshte:

“Besimtari nuk është asnjë çast i qetë, derisa të kalojë urën e Siratit.”

Nga brezi i sahabëve që u edukuan me vitalitetin e shpirtit të Profetit (s.a.), le të dëgjojmë fjalët e Selman Farisiut:

“Tri gjëra më bëjnë edhe të qesh, edhe të qaj. Njeriu që kërkon këtë botë, megjithëse e thërret ora e vdekjes, njeriu indiferent që nuk i lë të tjerët të tregohen indiferentë me të dhe njeriu që rri e qesh me

të madhe, megjithëse nuk e di nëse Zoti është i kënaqur apo është i zemëruar me të.”

Le t'i plotësojmë fjalët e sahabëve me këtë paralajmërim tronditës, të shprehur nëpërmjet Abdullah bin Abasit:

“O gjynahqar! Mos ji i sigurt se nuk do të kesh një fund të keq. Mëkatin e madh e ndjek një mëkat tjetër më i madh! Sado i madh të jetë mëkati yt, mëkati i paturpësisë sate përpara melekëve që ke në të majtë dhe në të djathtë, është edhe më i madh. Të qeshësh pa e ditur se çfarë ka vendosur Allahu të bëjë me ty, është mëkat i madh. Të gëzohesh për mëkatin që kryen është edhe më shumë mëkat. Të mërzhitesh se nuk ke bërë një mëkat të caktuar është edhe më shumë gjynah. Frika që ke nga era që mund të ngrejë mbulesën e derës teksa je duke bërë një mëkat, është edhe më shumë mëkat nga zemra që nuk dridhet, megjithëse e di se Allahu të sheh se çfarë je duke vepruar.”

Së fundi, le të dëgjojmë disa këshilla nga evlija-të e ushqyer nga damari i sahabeve:

Ja se si na paralajmëron një mik i Zotit:

“O vëlla, ruaje veten që Zoti mos të të shohë në ato vende që të ka ndaluar të gjendesh dhe mos kryej punët që Ai t'i ka bërë haram. Mos i nënvleftëso dhe mos i braktis urdhrat e Tij. Përpiqu të shtosh punët e mira që nuk do t'i vlerësojë tjetërkush përveç Allahut. Gjej një depo ku t'i ruash punët e tua. Bëj punët të mira, që t'i dijë vetëm Allahu. Po veprave kështu, punët dhe veprat e tua janë të mira dhe të sinqerta.” (Muhidin Arabi, Futuhât-i Mekkiye)

Ja çfarë thotë Hasan Basriu (r. a.):

“O njeri! Mos e mashtro veten! Zoti nuk të ka dhënë asnjë siguri, as shkresë, që ke për të shpëtuar nga xhehenemi. Para teje qëndrojnë frika e madhe dhe punë të mëdha. Punët e tua në këtë botë do të bëhen jastëku yt në varr! Në qoftë se ke bërë punë të mira, aty ke për të pasur të mira. Në qoftë se ke bërë punë të këqija, do të përballësh vetëm me punë të sherrit. Prandaj rastin konsideroje pasuri dhe vlerësoje kohën tënde. Mos mendo se ke kohë nesër për punë dhe adhurim. Ti je një rob i ngarkuar me detyra dhe do të japësh llogari për ato që ke bërë. Prandaj bëhu gati që sot për ato pyetje që do të të bëhen.

Tregoni kujdes për zemrat tuaja. Ringjallini ato, sepse zemrat zënë ndryshk shumë shpejt. Vëriini fre nefsit tuaj, sepse ai është shumë i hazdisur. Në qoftë



se ju nuk i pengoni dëshirat e mbrapshta të nefsit, vjen dita dhe ka për t'u teptisur brenda një humnere të frikshme.”

Një ditë Hasan Basriu (r.a.), teksa ecte rrugës, takohet me një person që rrinte duke qeshur. Ai e pyeti atë:

- O vëlla! A e kalove urën e Siratit?

- Jo, - i përgjigjet personi.

- Ku ke për të përfunduar në xhenet apo në xhehenem?

- Nuk e di, - përgjigjet personi.

- Allahu të shpëtoftë, - i thotë atëherë Hasan Basriu personit, - Përse rri e qesh atëherë? Mos e harro se ajo do të jetë dita më e ashpër.

I Dërguari i Allahut ka thënë: “Po të dini ato që di unë, do të kishit qeshur pak dhe do të kishit qarë shumë.”

E fshehta është të marrësh mësim nga lotët që lagnin tokën ku binte në sexhde profeti Muhamed, edhe pse nuk i dimë ato që dinte ai. Në qoftë se ai pyeste: “A të mos jem një rob që e falënderon Zotin?” atëherë ne na takon të mendojmë me mijëra herë për fatin tonë.

O nefsi im! Zgjohu nga indiferenca! Zgjohu nga indiferenca!

Mos e harro Allahun!

Mos e harro vdekjen!

Ndryshim drejt harmonizimit



Ma. Gilman Kazazi

Urdhëresat dhe ndalesat e shariatit islam janë të lidhura me **veprat e jashtme** dhe **ndjenjat e brendshme**. Sheriati urdhëron për agjërim, namaz, këshillim e dashuri mes njerëzve dhe thjeshtësi ndaj tyre, si dhe të ndalon nga vrasja, imoraliteti, thashethemet, mendjemadhësia, urrejtja etj.

Të gjitha veprat e dukshme nuk kanë vlerë, nëse nuk shoqërohen me pastërtinë e njerëtit dhe qëllimit, me pastërtinë e shpirtit dhe zemrës. Lidhja e ndërsjelltë mes anës së jashtme dhe asaj të brendshme, dallon gjeneratat triumfuese të myslimanëve nga gjeneratat e sotme. Harmonizimi mes sipërfaqësore dhe shpirtërore, dallon besimtarin nga hipokriti. Njeriu përbëhet nga dy komponentë, ai **shpirtëror** dhe ai **material**. Për të jetuar me lumturi në këtë botë, ai duhet të ruajë barazpeshën mes tyre dhe sa herë që favorizon njërin prej tyre, do të pësojë tronditje, trazim

dhe humbje. Vetëm përmes bindjes ndaj Zotit dhe zbatimit të Ligjit të Tij, njeriu mund të arrijë paqe të vërtetë me vetveten, shoqërinë, natyrën dhe Krijuesin. Njerëzit e sotëm, në shumicën e rasteve jetojnë në një çekuilibër shpirtëror, për arsye të shkëputjes nga feja dhe për arsye të mëkateve të mëdha që bëjnë si skllëvër të epsheve të tyre.

Kurani orienton njerëzimin që të largohet nga mëkatet e bëra haptazi dhe fshehurazi, nga mëkatet e brendshme dhe të jashtme.

“Dhe mos bëni mëkate as haptas, as fshehtas. Ata që bëjnë mëkatin, do të ndëshkohen për mëkatin e bërë.” (el-En’am: 120)

“...mos iu afroni mëkateve të hapura apo të fshehta...” (el-En’am: 151)

Dispozitat e shariatit përqendrohen në **pastrimin** e zemrës nga veset e liga dhe **stolisjen**

e saj me virtytet e larta. Islami edukon shpirtin, para se të skalitë normat e marrëdhënieve mes njerëzve. Përndryshe, nëse nuk realizohet ky terbijet i shpirtit, atëherë do të jetojmë një dualizëm të rrezikshëm mes sjelljeve me fasadë të bukur dhe qëllimeve apo dëshirave egoiste. Përkujdesja e tepërt për pamjen e jashtme, buron nga rrënimi i botës së brendshme. Feja dhe të qenët fetar nuk duhet të luajë rolin e perçes për të maskuar ligësinë e shpirtit. Besimi, me ndikimin e tij në jetën shpirtërore dhe morale të individit apo shoqërisë dhe me disa ligje me të cilat rregullon raportet shoqërore, i mundëson njerëzimit dhe shoqërive të ndryshme një jetë të lumtur dhe të qetë.

“Ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten (shpirtin) e ka dështuar ai që e poshtëroi (me punë të këqija) vetveten.” (esh-Shems: 9-10)

“Në trupin e njeriut gjendet një organ. Nëse ndreqet dhe rregullohet ai, i gjithë trupi përmirësohet. E nëse prishet, i gjithë trupi shkatërrohet. Ajo është zemra.” (Buhariu dhe Myslimi)

“Me të vërtetë, Allahu nuk shikon fizionominë apo trupin tuaj, por shikon zemrat tuaja.” (Myslimi)

Shoqëritë, sot po ndryshojnë duke iu dorëzuar materiales dhe duke prishur rregullin dhe qetësinë e shpirtit.

- Nuk do të kenë rezultat përpjekjet për ndryshim, nëse nuk harmonizohet bota e brendshme me sjelljet e jashtme.

- Nuk mund të bashkohen myslimanët, nëse gjuha shpreh të kundërtën e asaj që është në zemër.

- Nuk mund të kenë siguri në njeri-tjetrin, sepse gjendja e mjeruar shpirtërore në vetvete, hedh dyshime në qëllimet e të tjerëve.

- Nuk mund të duhen me sinqeritet e as të ndihmohen mes tyre, nëse fytyra buzëqesh, mirëpo zemra digjet dhe flakëron nga zilia e smira.



“Në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”

(esh-Shura: 88-89)



A është e mundur t’ua dorëzosh zemrën pasioneve të shthurura e, në anën tjetër, t’ia nënshtosh trupin Krijuesit? A është e mundur ta robërosh shpirtin tek epshet egoiste e, në të njëjtën kohë, të sakrifikosh për ndihmën a dobinë e të tjerëve? Jo.

Të ftosh në ndryshim që nuk buron nga thellësia e shpirtit, është sikur farat që nuk mbillen, sado të qëndrojnë në sipërfaqen e dheut ato mbesin të njëjtat. Dhe e kundërta, po zuri fill nga toka e shpirtit, ndryshimi është si farat e mbjella, të cilat rriten dhe sjellin me vete lulëzimin e pranverës, aromën e luleve, ëmbëlësinë e frutave dhe bukurinë e natyrës. Pra, ekzistencën sfiduese të së sotmes dhe sigurinë e së ardhmes.

“Në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (esh-Shura: 88-89)



SI TA LUFTOJMË ALKOOLIZMIN

Ismail H. Muçej

Për të luftuar alkoolizmin duhet të njohim përpara shkaqet e këtij vesi. Shkaku i parë i të dhënit pas alkoolit është injorimi i dëmeve që të sjell ky ves. Në të shumtën e rasteve njeriu fillon ta përdorë alkoolin, sepse nuk di çfarë dëmsh i sjell trupit dhe shpirtit të tij, por e bën vetëm për argëtim me shokë. Nëse njeriu do ta dinte e ta parashikonte rënien e tij, duke përdorur alkoolin, do të përdorte të gjitha energjitë e tij për ta luftuar këtë ves, prej të cilit është pushtuar, por ai nuk e di. Nuk e di se gotat e para që pi, do ta bëjnë skllav të alkoolit.

Shkaqet e dhënies pas alkoolit janë të ndryshme, ndër të cilat, papunësia, grykësia, mungesa e argëtimit me metoda të ligjshme etj. Këto e shumë të tjera i krijojnë kushte gjithnjë e më tepër adoleshentit për të frekuentuar kabaretë. Numri i madh i kafeneve, tregtoret e likernve janë tundimet e pamposhtura për të rinjtë e papunë si edhe për disa të punësuar. Dëshira për

lojëra gjen vend në klube dhe, në shumë raste, për t'u çliruar nga problemet e jetës. Megjithatë ka shumë të rinj që bëhen burra e baballarë, por kthehen në alkoolistë. Edhe në këto raste duhet t'i akuzojmë ata për injorancë. Por ka edhe shkaqe të tjera që i çojnë djemtë e rritur dhe burrat e martuar në këtë pellg fatkeqësish. Për shembull, kemi disa gra, nëna fëmijësh që nuk dinë të administrojnë punët shtëpiake, duke filluar që nga kuzhina e me radhë. Ato nuk kanë mësuar artin për të qenë bashkëshorte si duhet, nëna fëmijësh që të parandalojnë vese të tilla si alkooli për bashkëshortët e tyre. Nuk dinë të pajtojnë fëmijët e tyre, kanë humor të keq dhe, me qortimet vend e pavend, nuk sjellin paqe në familje.

Nga këto defekte, bëhen shkaktare që burrat e tyre dhe adoleshentët, të kërkojnë vende të tjera çlodhjeje e argëtimi dhe të përfundojnë në pijetore. Ja disa nga ilaçet me të cilat luftohet alkoolizmi. Në radhë të parë, si në çdo fushë tjetër, duhet të zhvishemi nga injoranca që na shtyn të

jepemi mbas këtij vesi, pra të njohurit e pasoja-ve që shkakton alkooli; ky duhet të jetë objekti kryesor i punës sonë në këtë fushë. Ju nxënës e studentë, mos hezitoni kurrë të thoni me modestë e respekt atë që dini për alkoolin, i cili rrënon shëndetin, i transformon qeniet inteligjente në kafshë e në budallenj dhe përfundimisht, shkatërron familjen e mbarë shoqërinë, brenda së cilës jetojmë. Të jeni ju vetë të sigurtë dhe siguronit të tjerët se, për të qenë njeri si duhet, nuk do të thotë të zbrazësh një gotë, një gotë me helm, por është t'u rezistosh tundimeve të përsëritura njëqind herë për të hyrë në klub e për të pirë me njerëzit që gjen aty. Në anën tjetër, femra duhet të mësojë si ta administrojë familjen, në çdo aspekt. Edhe kur të bëhet nënë, të punojë që ta kthejë vatrën familjare në një gjendje të këndshme e ngushëlluese për të gjithë anëtarët e saj. T'u mësojë fëmijëve dashurinë e dhembshurinë, detyrat e respektin ndaj babait që është i angazhuar gjithë ditën në punë. Duke vepruar kështu, nëna do ta kthejë vatrën familjare në një mjedis paqësor, në mënyrë që bashkëshorti apo fëmija të mos e kërkojnë prehjen e argëtimit nëpër klube të tymosura, plot zhurmë e me pasoja katastrofale për të ardhmen e brezit të ri. Një maksimum gjermane thotë: *"Alkooli është një pasqyrë, që i tregon atij që e përdor se si është në të vërtetë."* Por instruksionet nuk do të mjaftonin për ta përmbajtur njeriun nga dhënia pas pasioneve të tilla. Rëndësi ka edukimi i ndjenjave të dinjitetit të tij, të lirive të ligjshme, të detyrave ndaj njerëzve të tij, të forcimit të vullnetit për të mos iu nënshtruar tundimeve me pasoja të rënda. Pra ta rimëkëmbë ndërgjegjen e zvetënuar, duke lexuar libra me karakter fetar, moral, filozofik e të tjerë si këta, të cilët janë mjete që luftojnë veset e këqija. Në fund është e nevojshme të ndihmohen me mjete efektive masat e njerëzve të pamundur që nuk dinë të shkëputen nga zakone të këqija të marra nga të tjerët, nga një masë e pakontrolluar. T'u mësojnë të rinjve e të papunëve që të dëfrehen gjetiu e jo rreth shishes së tavolinës. T'i bindim ata se një shëtitje nëpër lulishte, një lexim tërheqës, të dëgjuarit e të kënduarit e një fragmenti moralist, e kënaq shpirtin dhe zemrën, shumë më tepër se një mbrëmje ku merren gllënjka pijesh të ndryshme.

**"O ju besimtarë, pijet alkoolike
dhe lojrat e fatit...
janë punët e djallit: largohuni
krejtësisht, nëse doni të shpëtoni
nga pasojat e tyre)..."**



Kurani i lartë e dënon në disa versete këtë ves të rrezikshëm. Ja se ç'thotë në një verset të tij: **"Të pyesin ty (o Profet), për pijet alkoolike e për lojrat e fatit: thuaju se prej tyre vijnë dëme (fizike e shpirtërore)..."** Dhe në një verset tjetër: **"O ju besimtarë, pijet alkoolike dhe lojërat e fatit... janë punët e djallit: largohuni krejtësisht, nëse doni të shpëtoni nga pasojat e tyre)..."** Mendoj se vullneti i mirë i njerëzve do t'i frenojë fatkeqësitë që e shkatërrojnë një shoqëri. Është detyrë edhe për shtetin që të vërë në veprim mjete efektive në fushën e edukimit, ashtu siç kanë vepruar shtetet me një qytetërim sa teknik aq edhe moral, për të korrigjuar sjelljet jokorrekte të një shoqërie. Në SHBA, në çdo kryqëzim rrugësh janë të vendosura parulla të mëdha me këtë përmbajtje: "Bëhuni armiq të alkoolit". Do të ishte e nevojshme që mësuesit të pajiseshin me kulturën e nevojshme që shpjegojnë efektet e tmerrshme që shkaktohen nga përdorimi i alkoolit, në mënyrë që t'i edukojnë nxënësit që në moshën e re për të mos iu afruar kësaj sëmundjeje të rëndë shqërore. Shteti i bie një barrë e madhe të kufizojë liçensat për hapjen e klubeve alkoolike, madje do të ishte me vend të vinte dorë në monopolizimin e këtyre pijeve, siç është vepruar në Zvicër, ku ka ardhur duke u ulur ndjeshëm përqindja e përdorimit të alkoolit. Çdo njëri nga ne, sipas punës që ka e mjeteve që disponon, duhet të luftojë kundër alkoolizmit. Mësuesi në shkollë, oficeri në repart, predikuesi në faltore, drejtori në një shoqatë a institucion, babai e nëna në familje etj. Të gjithë duhet të angazhohemi në këtë fushatë, për ta shpëtuar shoqërinë nga ky ves që është burim i shumë të këqijave. Atëherë mund të themi se kemi një shoqëri të shëndoshë dhe një shtet të konsoliduar.



Mbi marrëdhënien e religjionit me moralin

Edison Çeraj

Na duket sikur morali mund të ketë mbështetje të përhershme vetëm te religjioni¹ dhe, në thelb, ashtu është. Por morali dhe religjioni nuk janë e njëjta gjë. Morali, *si parim*, nuk ekziston pa religjionin. Morali, *si praktikë*, si rast individual i sjelljes, nuk varet drejtpërdrejt nga religjioziteti. Ajo që i lidh është një dëshmi e përbashkët: bota tjetër, që shpërfaqet më e lartë. Meqë kjo botë është tjetër, ajo është religjioze dhe, meqë është më e lartë, ajo është një botë morale, sepse morali, në të gjitha traditat lidhet me të epërmen: morali të lartëson.

Ky raport dëshmon njëherësh varësinë dhe pavarësinë e ndërsjelltë të religjionit dhe të moralit. Bëhet fjalë për një konkurrencë të brendshme, e cila nuk është automatike, matematikore e as lo-

1. Në këtë rast, me religjion nënkuptojmë besimin e thellë, ose gjakimin për të besuar (pikërisht kjo është religjioze te qenia, gjë që na e jep edhe ana etimologjike e kësaj fjale: *religio* = lidhje), pra jo një *modus vivendi*.

gjike, por mirëfilli praktike – me ndoca shmangie të mundshme, por që, herët a vonë, vendoset sërisht: ateizmi më në fund mbaron me mohimin e moralit, ndërkohë që çdo shndërrim i njëmendët nis me përtëritjen religjioze.

Morali është njëfarë religjioni i derdhur, i përkthyer në sjellje dhe marrëdhënie konkrete, i shprehur në synime dhe në rregulla sjelljeje; konkretisht sjellje e vullnetshme e njeriut ose marrëdhënie me të tjerët, e harmonizuar me faktin e pafundësisë së fakteve (ose anashkalimin radikal nihilist të tyre) se Zoti ekziston, sepse në të kundërt, “çdo gjë është e lejuar”. (Dostojevski)

Duhet të bëjmë detyrën tonë duke mos marrë parasysh shumë rreziqe të cilave u ekspozohemi. Kjo pra është ajo që quajmë moralitet, ndryshe nga sjellja e motivuar prej një interesi të caktuar. Një kërkesë e tillë mund të arsyetohet, përveçse nëse kjo botë dhe kjo jetë nuk janë të vetmet. Kjo

është pika ku shfaqet fokusi i përbashkët i moralit dhe i religjionit.

Morali ka lindur nga ndalesa dhe i tillë është edhe sot. Ndërkaq, ndalesa është religjioze, si për nga natyra e saj, ashtu edhe për nga zanafilla. Tetë nga *Dhjetë Urdhrrat* që iu shpallën Moisiut janë ndalesa. E moralshmja shfaqet gjithnjë si parim kufizues dhe frenues në raport me instinktet kafshërore të natyrës së njeriut. Shembulli më tipik dhe më i njohur në këtë drejtim është etika e krishtërit.

Historia e besimeve të lashta shënon shumë modele ndalesash të ndryshme që mund të na duken absurde. Mirëpo, duke i parë nga aspekti etik, asnjë ndalesë nuk është absurde. Është e natyrshme që ndalesa të ketë një kuptim racional, porse dobia nuk është asnjëherë kuptimi i saj parësor.

Me sa duket, morali nuk është "jeta në harmoni me natyrën", sikurse e përkufizonin me ngazëllim stoikët. Nëse fjala *natyrë* merret në kuptimin e saj të vërtetë e të drejtpërdrejtë, së pari, mund të thuhet se morali është jeta kundër natyrës. Ashtu si vetë njeriu, edhe morali është irracional, i panatyrshëm, i mbinatyrshëm. Njeriu i natyrshëm dhe morali i natyrshëm nuk ekzistojnë.

Në kushtet e natyrës njeriu nuk është njeri, por, në rastin më të mirë, kafshë e pajisur me mendje. Ndërsa morali në kushtet e natyrës, është një trajtë egoizmi, një egoizëm mendor i qytetëruar.

Ekzistojnë rreth pesëdhjetë e dy kuptime të ndryshme të fjalës *natyrë*. Në këtë rast, fjala *natyrë* shënon të gjithë realitetin jashtë thelbit të njeriut, pra edhe njeriun në pjesën kur ai i përket botës; trupin e tij, dëshirat, instinktet dhe intelektin. Kështu, natyra është pikërisht trualli ku ai u hodh (u flak, sipas Sartrit) me dëshirën e tij (pasi hëngri frutin e ndaluar). Të tillë e paraqet edhe Heidegger-i përmes neologjizmit bosht të filozofisë së tij – *Dasein*.

Në "luftën për ekzistencë" të Darwin-it nuk fiton më i miri në kuptimin moral, por më i forti, ai që përshtatet më shumë. Përparimi biologjik nuk na shpie te dinjiteti njerëzor dhe, si rrjedhojë, as te morali (nëse dinjiteti njerëzor është një nga burimet e moralit). Njeriu, sipas Darwin-it, mund të arrijë shkallën më të lartë të përsosmërisë biologjike (mund të bëhet "mbinjeri"), mirë-



po do mbetet pa cilësinë njerëzore. Kësisoj edhe pa dinjitetin njerëzor. Këtë të fundit mund ta ketë dhunti vetëm nga Zoti, ose nga Qenia në kuptimin heidegger-ian: për aq sa Qenia i zbulohet përmes Zbulesës (*Aletheia*)

Në këtë kuptim edhe progresi shoqëror, si "vazhdim" i progresit biologjik, qëndron në të njëjtin raport ndaj moralit.

Studiuesi i etikës Mandeville, shtronte këtë pyetje:

"Ç'domethënie ka morali për përparimin e shoqërisë dhe për zhvillimin e qytetërimit?" Përgjigjja ishte e thjeshtë: "Asnjë kuptim". Madje është e dëmshme nëse realizohet e moralshmja. Sipas tij, mjetet zakonisht mendohet se u përkasin veseve; i japin përparim të fuqishëm progresit shoqëror, sepse "zhvillimin e njeriut e ndihmon më shumë ajo që shton nevojat e tij". Ose më qartë, ai thotë: "E ashtuquajtura e keqe morale dhe fizike e kësaj bote, është forca kryesore që shkakton lëvizje dhe na bën qenie shoqërore."

Në qoftë se i gjithë progresi – së pari biologjik dhe pastaj teknik – përkon me seleksionimin, me përjashtimin ose madje me zhdukjen e të pafuqishmit nga i fuqishmi, atëherë morali do të duhej të ndodhej në opozitë ndaj kësaj pike thelbësore të progresit. Morali ka kërkuar gjithmonë mbrojtjen e atyre që janë të pafuqishëm, mëshirën, konsideratën, me një fjalë, ruajtjen e atyre që janë të pafuqishëm dhe më pak të aftë.

Në këtë pikë, natyra dhe morali gjenden në anë



të kundërta, ku kanë qenë që në krye të herës.

“Lirohuni nga ndërgjegjja, nga mëshira, përdëllimi – nga këta tiranë të brendshëm njerëzorë. Shtyni të pafuqishmit. Mbi trupat e tyre ngjituni më lart... etj.” (Nietzsche) Shmangia nga morali është tejet e qartë. Dhe si antipod të kësaj mund të themi: dobësoni të fuqishmit dhe mbroni të pafuqishmit. Këto janë dy kërkesa të drejtuara kundër njëra-tjetrës, që ndajnë biologjiken dhe shpirtëroren, zoologjiken dhe njerëzoren, natyrën, qytetërimin dhe kulturën, shkencën dhe religjionin.

Aplikimin e ligjeve biologjike në shoqërinë njerëzore, vetëm Nietzsche e bëri me konsekuencë dhe deri në fund, sepse Nietzsche në një farë mënyre ishte vazhdimi filozofik i darvinizmit.

Rezultati: flakja e dashurisë dhe arsytimi i dhunës.

Për Nietzsche-n, krishtërimi, sidomos etika e tij, “ishte helmi më helmues që u shartua ndonjëherë në trupin e fuqishëm të njerëzimit të vrullshëm”.

Te *Fedoni*, Platoni shtroi me konsekuencë konceptin e një etike autentike: trimëria përgjatë ditës mbetet një lloj frike. Përkorja e përditshme është vetëm gjakimi i fshehur për t’u kënaqur. Ky lloj virtyti është si puna e tregtarit; është një hije e virtytit, një virtyt robëresh.

Për njeriun me një moralitet të qenësishëm, ekziston vetëm një synim: sa më larg trupit, aq më afër shpirtërores së pastër. Siç bënte thirrje

edhe Kandisky për sa i përket artit të pikturës: për një pikturë me kumbim të pastër shpirtëror, larg idhujtarisë së sendores.

Në njëfarë kuptimi, trupi mbetet varri i shpirtit.

Gjatë ekzistencës tokësore shpirti nuk e arrin asnjëherë cakun e vet. Njohja e vërtetë vjen pas vdekjes. Në fund të filmit *Inception*, ndër të tjera dëgjojmë edhe këtë thënie: “Jeta është një ëndërr, vetëm kur të vdesim do zgjohemi prej saj”, që sigurisht është një urtësi e trashëguar sa nga njëra traditë, aq edhe nga tjetra, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim.

Prandaj njeriu me etikë nuk i frikësohet vdekjes. Të filozofosh dhe të jetosh vërtetësisht, do të thotë të përgatitesh për vdekjen. E keqja është forca që “sundon” botën, ndërsa morali nuk është mundësia natyrore e njeriut dhe nuk mund të themelohet përmes mendjes dhe të të menduarit.

Një etikë e themeluar në këtë mënyrë nuk gjen dot një argument racional për të dëshmuar vërtetësi. Platoni, në vend të provave antropologjike, u detyrua të gjente prova metafizike, për t’u bërë kështu pararendësi i etikës së bazuar në teologji. Kjo ecuri është e pashmangshme. Siç dihet, Platoni paraqiti doktrinën për paraekzistencën, sipas së cilës, çdo njohje është vetëm përmendje/përkujtim. Pjesa përbërëse ose reflektimi i domosdoshëm i kësaj doktrine apo i ndonjë tjetre, mbetet besimi te pavdekësia.

Meditimi rreth etikës e shpuri Platonin drejt një gjendjeje religjioze. Ky meditim i çoi dy filozofë të tjerë të antikitetit, Epiktetin dhe Senekën, drejt një religjioni konkret – te krishtërimi.

Për Epiktetin ka shenja bindëse se ishte i krishterë i fshehur, kurse Seneka dihet që kishte letërkëmbime me Shën Palin.

Krishtërimi mbetet një shembull i veçantë i ngjizjes së përkryer, për afrinë e fortë e të ndërsjelltë dhe për një lloj njësie ndërmjet religjiozitetit të skajshëm dhe etikës së skajshme.

Arti i Rilindjes, i frymëzuar nga temat religjioze, mund të merret si një rast ku, bashkë me religjionin dhe etikën e skajshme, bashkëjeton mrekullisht edhe arti i skajshëm.

Parë nga aspekti historik, mendimi moral është një nga mendimet më të vjetra thjesht “njerëzore”. I paraprin vetëm ideja e hyjnores që është

e vjetër po aq sa vetë njeriu. Këto dy mendime mbeten të lidhura ngushtë përgjatë gjithë historisë, por edhe deri në ditët tona.

Në historinë e etikës është e vështirë të gjesh një filozof a mendimtar të etikës që t'i jetë shmangur religjionit, qoftë në rastet kur ka dëshmuar domosdoshmërinë e religjionit për parimet morale, qoftë kur me të njëjtin zell ka dashur të provojë të kundërtën. E gjithë historia e etikës është një rrëfim i vazhdueshëm për ndërthurjen reciproke të mendimit religjioz dhe etik.

Pavarësisht se statistikat nuk përbëjnë ndonjë provë për çështjen që po diskutojmë, mbase ia vlen të përmendet se filozofët religjiozë të etikës mbizotërojnë kudo, ndërsa ateistët janë përrjash-time të rralla.

Përvoja e të ashtuquajturave lëvizje laike etike (lëvizjet që theksonin pavarësinë e etikës nga religjioni) në Francë, Angli, Amerikë, Gjermani dhe në Itali në shekullin e njëzetë (në botën anglosaksone të njohura me emërtime si: *Societies for Ethical Culture, Settlements, Ethical Societies* etj.), tregoi se çdo përpjekje dhe veprimtari në sferën e moralit, synon vetvetiu të shndërrohet në religjion ose t'i afrohet atij. Për tematikën që po shqyrtojmë, kjo periudhë në historinë e etikës praktike ka një rëndësi të madhe.

Edhe librat shkollorë në shkollat shtetërore franceze, ku mësimi fetar zëvendësohej me të ashtuquajturin mësim moral, kishin skemën e jashtme të katekizmit të praktikuar në mësimin e besimit të krishterë.

Zhvillimi i këtyre ideve, rrjedha e tyre kontradiktore, lëkundja e tyre e vazhdueshme ndërmjet religjionit dhe shkencës, duhet thënë se është e pamundur të trajtohen këtu. Por gjithsesi, mund të konstatohet përpjekja e pandërprerë e tyre për të mbajtur një qëndrim të pavarur ndaj religjionit. Nga ana tjetër duket qartë afria e tyre e vazhdueshme dhe e pavetëdijshe drejt religjionit. Pra, këto janë ato dy dukuri mjaftueshëm treguese për subjektin e zgjedhur për trajtesë.

Është e pamundur të përfytyrojmë një njeri çiltërsisht religjioz dhe njëkohësisht amoral, por edhe anasjelltas mbetet e pamundur.

Religjioni është njohje (pohim), ndërsa morali është jetë, përvojë e harmonizuar me këtë njohje. Edhe gjetiu, ndërmjet njohjes dhe përvojës ka

Është e pamundur
të përfytyrojmë një njeri
çiltërsisht religjioz
dhe njëkohësisht amoral,
por edhe anasjelltas mbetet
e pamundur.



ndarje dhe jo renditje.

Religjioni na jep përgjigje për dilemën se si duhet menduar dhe besuar, kurse morali përgjigjet mbi atë se çfarë duhet synuar ose si duhet të jetojmë dhe të veprojmë.

Kumti për botën tjetër përmban gjithnjë edhe kërkesën për të jetuar në harmoni me atë vizion të gjerë, të pakufishëm, por vetë kjo kërkesë nuk është identike me atë vizion.

Një etikë aq sublime si ajo e Jezuit, është pasojë e drejtpërdrejtë e një vetëdijeje po aq të fuqishme dhe të kthjellët, porse edhe religjioni i inkuizitorëve ishte tërësisht i çiltër, pavarësisht tingullit paradoksal të këtij pohimi.

“Besoni dhe bëni vepra të mira”, është një ndër ato porosi që përsëriten shpesh në Kuran (mund të haset rreth pesëdhjetë herë), porosi e cila vë theksin për të bashkuar në praktikë një gjë që njerëzit priren ta ndajnë.

Kjo porosi ose ky parim, shpreh dallimin mes religjionit (“të besosh”) dhe moralit (“të bësh vepra të mira”), por edhe imperativin që ato të ecin së toku.

Kurani zbulon edhe lidhjen e kundërt, prandaj tregon se si religjioni mund të motivohet fuqishëm nga morali: “Nuk do të besoni gjersa të jepni atë që është më e dashur për ju.” (Profeti Muhamed)

Tanimë kjo nuk është ajo: beso, dhe do bëhesh njeri i mirë. Tani është anasjelltas: bëhu njeri i mirë, dhe kështu do të besosh.

Pikëpyetjes se si të filloj të besoj, si ta forcoj besimin? – i përgjigjemi: bëj punë të mira. Zotin do ta gjesh më parë duke vepruar sesa duke medituar.



Besimi islam në dritën e njohjes racionale

Nexhat Ibrahim

ZOTI I MADHËRISHËM – PERCEPTIMET NËPËR KOHË

Ateisti ka menduar në kokën e tij se Zoti është fryt i frikës dhe i imagjinatës njerëzore, por është i verbër të shohë që, në fakt, për pohimin e tij nevojitet imagjinatë shumë më e madhe. Nëse njeriu pohon se Zoti është prodhim i imagjinatës njerëzore, atëherë kush e krijoi mundësinë e vetë përsiatjes dhe meditimit dhe këtë univers të rregulluar përsosmërisht me të gjitha ligjet që dominojnë në të? Ateisti do të thotë se kjo është çështje rasti. Po vallë, të gjithë ne dhe shumë mrekulli e fenomene në këtë gjithësi janë çështje rasti? Vallë, vetvetiu ndodhi tërë kjo që e shohim? Të meditojmë për këtë më seriozisht

Sikur të frynte tornado dhe nga moria e hekurishteve me hekur të vjetër e të ndryshkur të ndërtohej një aeroplan bashkëkohor supersonik, kjo i ngjan rastësisë. Apo sikur të hedhim shumë argji-

lë, rërë, çimento e hekur në det dhe të presim të bëhen tullat e të palosen njëra mbi tjetrën, duke ndërtuar kështu një objekt të bukur me të gjitha karakteristikat e veta, me instalimin e sistemit të energjisë elektrike, ujësjellësit dhe tërë infrastrukturës tjetër që kërkohet për një objekt bashkëkohor. Edhe vetë qeliza e vogël përmban një sistem të tërë kompleks për të funksionuar. Mosfunksionimi vetëm i një elementi do ta degradonte krejt qelizën. Vallë, ky sistem shumë efikas funksionon rastësisht? Edhe në laboratorët më të zhvilluar, më të automatizuar, më të robotizuar, qeliza nuk mund të prodhohet rastësisht apo në bazë të elementeve të vdekura.¹ Vallë, a mund të pohohet edhe më tej, se gjithësia është prodhim rasti e jo prodhim i një plani të përkryer nga Krijuesi Suprem, i cili e ndërtoi këtë? Nuk duhet harruar se edhe nëpër-

1. Të dhënat për qelizën janë marrë nga: Harun Yahya, Gjunjëzimi i teorisë së evolucionit, në: <http://www.harunyahya.com/albanian/liber/evolucionit/evolucionit.php>.

mjet arsyes, në të cilën thirren së tepërmi ateistët, mund të vijmë deri te përfundimi se Zoti ekziston dhe për këtë, do të flitet kalimthi në pjesë të tjera të shkrimit.²

HARMONIA E PËRKRYER NË UNIVERS, ARGUMENT PËR BESIM

A mund ta njohim e të mësojmë ç'është gravitacioni, ç'është magnetizmi apo edhe ç'janë fenomenet e tjera në univers? E qartë, ato nuk mund t'i njohim, as nuk mund ta mësojmë thelbin e tyre, por mund t'i mësojmë nëpërmjet shqisave, efektet e veprimit të tyre, të cilat ekzistojnë në mënyrë të përsosur në univers. Çdo gjë e krijuar u nënshtrohet këtyre ligjeve. Ato do të jenë gjithnjë aktive, sepse aktive janë edhe atributet e Allahut, të Përkryer, të Përsosur dhe të pakufizuar në kohë dhe hapësirë. Bota bimore dhe shtazore ekziston aq mirë, aq mrekullueshëm, sa çdo studim shkencor do të na mahnisë. Universi gjithnjë lëviz me saktësinë më të madhe. Miliarda trupa qiellorë lëvizin në rrugëtimin e tyre pa kapriçot e teket e zakonshme njerëzore. Çdo gjë lind, zhvillohet dhe vdes. Nga shpërthimi i një ylli lindin yje të rinj në harmoni të përkryer. Shpërthimi zakonisht krijon rrëmujë, por këtu çdo gjë duket dhe është e përkryer. Normalisht, ky rend kozmik e ka krijuesin e tij absolut. Nëse do të thoshim se ky krijim i kozmosit, i botës bimore dhe shtazore është punë rasti, do të habiteshim, kur, duke shëtitur nëpër natyrë, atje në largësi, shohim diçka interesante. Afrohemi dhe shohim një shtëpizë kompjuteri dhe monitori. E hapim. Miliona informacione. Vallë, janë punë rasti apo punë miliona njerëzish me dije dhe planifikim. Nëse për një kompjuter u dashka shumë punë e energji, shumë mjete e planifikim, si marrim guximin ta quajmë ekzistencën çështje rasti. Kjo hipotezë mediokre ndoshta edhe ka mundur të mashtrojë dikë në të kaluarën, por tani, kur edhe vetë shkenca materialiste po e kërkon fillin e ekzistencës, madje po bëhen prova të shumta për ta zbuluar fillimin (bumin!) e parë, do të ishte marrëzi të mendohej diçka e tillë.

Vetë njeriu është një fenomen, një enigmë që mahnit. Nuk do t'i shfrytëzojmë të dhënat e shumta të ekspertëve, sepse këtë ju do ta bëni sipas dëshirës dhe prirjes suaj, por do të theksojmë çuditë e ekuilibrit matematikor, në kohën kur u krijua

2. Ersan Grahovac, po aty.

**Nga shpërthimi i një ylli lindin
yje të rinj në harmoni të përkryer.**

**Shpërthimi zakonisht krijon
rrëmujë, por këtu çdo gjë duket
dhe është e përkryer.**

**Normalisht, ky rend kozmik e ka
krijuesin e tij absolut.**



njeriu, para miliona e miliarda vitesh, në kohën e Ademit. Ju e dini se çdo qenie ka sasinë e përcaktuar të elementeve kimike, si natriumi, kaliumi, kalciumi, fosfori, sheqeri, kolesteroli, hekuri, jodi, etj. Çdo prishje e këtij ekuilibri do të shkaktonte sëmundje dhe vdekje. Kjo ndodh edhe me temperaturën 37 gradë të trupit, edhe me shtypjen e gjakut 120/80 etj. Trupi i njeriut paraqet çudi teknike që edhe përkundër zhvillimit të madh teknologjik, njeriu ende nuk është në gjendje ta kopjojë këtë ligj madhështor primordial dhe të ofrojë sqarimet kryesore.

A nuk keni menduar se për të bërë një krijesë do të duhej parapërgatitje shkencore, materiale etj.? A nuk flet vetë fakti se njeriu është i paaftë edhe në shekullin XXI të krijojë diçka? E kjo është bërë para miliona apo miliarda vitesh. Apo këtë proces e arsyetojmë me teorinë e rastit?

E pranojmë sfidën e rastit. Do të marrin një sasi të madhe shkronjash dhe, pas një përzierjeje të tyre, do t'i hedhim në fushën e një stadiumi. Papritmas, nga ato shkronja të derdhura, u shkrua emri i Shekspirit, apo i Bethovenit. Na besohet kjo? Jo! Natyrisht që jo. Por ta zëmë se kjo ndodhi rastësisht. Të shkojmë më tej. T'i marrim ato shkronja, t'i përziejmë mirë dhe t'i hedhim sërish po aty. Papritmas na u shkrua një kapitull i librit të Shekspirit apo një krijim i vogël i Bethovenit. Na besohet kjo? Natyrisht që jo! Madje, do të reagonim më ashpër ndaj atij që e rrëfen këtë tregim nga fusha e fantastikes. Por nejse. Ta zëmë se edhe kjo ndodhi. I marrim sërish shkronjat, i përziejmë mirë dhe, për së treti i hedhim në stadiumin e përmendur. Por tash, habia është edhe më e madhe. Në vend të një fjale apo të një kapitulli, na u shkrua vetvetiu vepra *Hamleti* apo *Mbreti Lir* ose një simfoni e Bethovenit apo një krijim muzikor i Moxar-



tit! Na besohet kjo? Natyrisht se jo. Është e qartë se asgjë nuk krijohet rastësisht. Çdo gjë ka qëllimin e vet dhe i shërben qëllimit të caktuar. Mosdija jonë nuk mund ta mohojë krijimin perfekt të Krijuesit, por dëshmon paaftësinë tonë për të kuptuar edhe gjërat më të vogla e lëre ato më të ndërlikuarat.³

Do të themi se mendimet e jobsimtarëve po rrenohen çdo ditë nga vetë ata. Evolucionistët theksojnë se, me kalimin e kohës, krijesat ecin drejt përsosurisë së tyre, për të arritur deri te më të përsosurat, të cilat funksionojnë në sistemin e më të fortit etj. Në anën tjetër, fizika e njeh Ligjin e Dytë të Termodinamikës, i cili, i eksperimentuar praktikisht dhe teorikisht, pohon se me kalimin e kohës, kushtet natyrore çojnë drejt kaosit, rrëmujës. Si do t'i pajtojmë këto dy ligje, kur i pari, ai i evolucionit materialist është totalisht i papranueshëm për shkencën moderne dhe logjikën, e në anën tjetër Ligji i Dytë i Termodinamikës është i provuar dhe i arsyeshëm.⁴ Natyrisht, se shpjegimi materialist i krijimit nga rasti është i papranueshëm, i pamundshëm dhe i refuzueshëm si nga aspekti shkencor ashtu edhe nga ai logjik.⁵

RASTËSIA E KRIJIMIT, ABSURD

Teoria e rastit është mbështetja kryesore e materialistëve. Pa u thelluar më tepër, do të themi: mos vallë shtegtojnë rastësisht shpendët dhe peshqit me mijëra kilometra nëpër dete e shkretëtira?

3. Lexo: Mustafa Mahmud, Prej dyshimit deri në besim. Disa botime.

4. Shih: Harun Yahya, Gjunjëzimi i teorisë së evolucionit, në: <http://www.harunyahya.com/albanian/liber/evolucionit/evolucionit.php>.

5. Ersan Grahovac, po aty.

Vallë, rastësisht zogthi i vogël brenda në gëzhojë thyen gëzhojën dhe del prej saj? Rastësisht ngjizet (koagullohet) gjaku në lëndimet tona trupore dhe varra qepet pa mjek kirurg? Rastësisht bima e lulediellit e kupton se Dielli është burimi i jetës së saj dhe i rrotullohet atij pa asnjë hamendje e gabim? Ka edhe shumë shembuj të tjerë që nuk do t'i cekim për arsye të kohës së kufizuar dhe monotonisë së lexuesit të arsyeshëm.

E gjithë kjo barazpeshë madhështore, i gjithë ky univers i jashtëzakonshëm, i ndërtuar nga miliona hollësi bërtet, klith dhe flet qartë se arkitekti dhe ndërtuesi i kësaj ekzistence është Allahu, Krijuesi, ngaqë krijon çdo gjë pa model e shembull prej hiçit. Ai zotëron të gjitha atributet absolute dhe nuk u përngjan ligjeve memece të materializmit, as Lëvizësit të Palëvizshëm të Aristotelit, as Zotit idealist nga bota e Platonit, as nuk është Zoti, siç e imagjinon Baruh de Spinoza etj. Ai është i pastër nga këto imputime, jashtë të gjitha gjendjeve, formave dhe trajtave, kohës dhe hapësirës. Ai vërehet sipas veprimeve të tij, sepse është i padukshëm. Sytë tanë nuk e shohin, kurse Ai na sheh ne.

Materializmi shkencor nuk e beson Zotin dhe që ta besojë, ai dëshiron ta shohë Atë. Ata nuk e pranojnë pakufizueshmërinë e Tij, transhendentën e Tij dhe dëshirojnë t'ua nënshtrojnë eksperimenteve empirike. Harrojnë se gjysma e vetë shkencës së tyre është transhendente. A nuk është transhendent nocioni i gravitacionit? A nuk ka thënë vetë Isak Njutoni se: "Njëmend është e pakuptueshme që ta kemi materien, e cila është e pajetë dhe e pandjenja, kurse vepron mbi materiet e tjera dhe i tërheq, edhe pse ndërmjet tyre nuk ka kurrfarë lidhjeje dhe raportesh."⁶ Ja, kjo është shkenca në të cilën thirremi, por harrojmë se vetë ajo është e panjohshme, transhendente dhe e pakuptueshme me mendje. Vallë, mos janë elektronet, apo radiovalët diçka tjetër? Të gjitha këto ekzistojnë edhe pa i parë, duke u kënaqur me gjurmët e tyre dhe pasojat e veprimit të tyre. Njeriu nuk mund të depërtojë në esencë të tyre, t'ua dijë kuptimet, por ai u di vetëm emërtimet. Kjo është pengesa, kufiri i shkencës, sepse ajo hulumton lashtësinë, por jo esencën e tyre. Jo pse nuk do, por pse nuk mundet. Në vend të përmbytjes në kotësira e absurde të shkencës materialiste, do të ishte më mirë

6. Shih: Mustafa Mahmud, Prej dyshimit deri në besim, Prishtinë, 1987, fq. 90.

të besonim në këtë transhëndencë të Mirëbërësit fisnik, gjurmët e të cilit i shohim në çdo lëvizje të gjymtyrëve, në çdo të rrahur të zemrës, në çdo lëvizje të qerpikut të syrit. Kudo dhe gjithmonë.

SHPIRTI NJERËZOR

Sipas shpjegimeve materialiste, njeriu është nga materia dhe paraqet krijesën më inteligjente, së cilës i janë nënshtruar ndjenjat, ndërgjegjja, egoja etj. Ata harrojnë se njeriu ka edhe një komponent, shpirtin, që është edhe kryesori. A nuk është kështu kur vendosim të bëjmë një veprim të caktuar, por njëkohësisht na kujtohet se kemi vendosur edhe diçka dhe e braktisim këtë veprim. A nuk është kështu, kur gjatë ditës së ramazanit jemi të uritur e të etur, por për shkak të agjërimin ne nuk e plotësojmë këtë nevojë biologjike. A nuk është kështu, kur në vend që të kënaqemi me familjen e ngrohtësinë e shtëpisë, ne vendosim të shkojmë në luftë për ideale më të larta dhe të sakrifikojmë pasurinë apo edhe jetën. Do të thotë se shpjegimet materialiste janë të gabuara, sepse trupi është në shërbim të shpirtit e jo shpirti në shërbim të materies. Kjo ndjenjë për vdekje në emër të së mirës, kjo dashuri për të ardhmen duke sakrifikuar veten, a është materie? Jo, e qartë se jo. Ajo është diçka që nuk lejon të shihet, të kapet, të shijohet, por që ekziston. Këtë ekzistim ne e ndjejmë nga efektet që i vërejmë. Sigurisht se nuk është materie, por një gjendje e shpirtit që manifestohet në forma të jashtme.⁷

Këtë na e shpjegon qartë mjekësia. Për shkaqe të caktuara ndodh që këmba të amputohet, apo zemra e veshka të transplantohet, etj. Gjatë gjithë kësaj rrjedhe, mjekësia nuk ka problem me personalitetin e njeriut. Po të ishte prioritare materia, transplantimi apo amputimi do të prekte në tërësinë e asaj që quhet njeri. Mirëpo, shohim se, përkundër ndryshimeve biologjike, njeriu mbetet njeri, sepse shpirti është timonieri që drejton anijen që quhet njeri.

Nuk do të gabojmë nëse themi se shpirti është liria, vigjilenca jonë, drita jonë e brendshme e pa dukshme, e cila na ndriçon rrugën tonë drejt dallimit të së mirës dhe së keqes, të së bukurës dhe të shëmtuarës, të së drejtës dhe të padrejtës.⁸

7. Po aty, fq. 24.

8. Ersan Grahovac, po aty.

Vdekja është kalim nga shtëpia e përkohshme në shtëpinë e amshueshme. Kjo nuk është zhdukje, por lindje e re, sikurse ndërrimi i rrobave për sezonin e ri.



VDEKJA ËSHTË RILINDJE

Pjesërisht jemi përgjigjur këtu, kurse pjesërisht do të përgjigjemi me fjalët e shkrimtarit boshnjak Mesha Selimoviq, cili thotë se "vdekja është *jekin* (njohuri e sigurtë), e vetmja që e dimë se do të na arrijë. Përrjashtim nuk ka, as befasi, të gjitha rrugët shpien deri te ajo, çdo gjë që bëjmë e bëjmë për të ... dhe, nëse është dije e sigurtë, përse habitemi kur vjen? Nëse kjo jetë është kalim i shkurtër që zgjat vetëm një çast ose një ditë, përse luftojmë ta vazhdojmë edhe një ditë ose një çast? Kjo botë është mashtruese, kurse ajo tjetra është më e mirë"⁹

Kjo botë është dhuratë e Zotit dhe duhet shfrytëzuar për qëllime të mira. Kjo dhuratë nuk i kthehet Zotit, sepse ai nuk ka nevojë për krijesat, por për këtë duhet t'i jemi mirënjohës. Ai është i pavarur, kurse ne të varur prej Tij. Vdekja është kufiri deri kur mundemi të bëjmë mirë, sepse vepra e mirë do të mbetet për ne edhe pas vdekjes. Meqë nuk e dimë datën e vdekjes, atëherë të bëjmë sa më shumë, që të sigurojmë furnizim për jetën e ardhshme.

Vdekja është kalim nga shtëpia e përkohshme në shtëpinë e amshueshme. Kjo nuk është zhdukje, por lindje e re, sikurse ndërrimi i rrobave për sezonin e ri. Fryti i pemës, kur piqet, vilet. Lëvozhga e vezës së shpendit, kur vjen koha e lindjes, pëllet. Po kështu vjen edhe koha kur trupi dhe shpirti duhet të ndahen. Vdekja është domosdoshmëri e pashmangshme për të kaluar në botën tjetër, ku njeriu ose ngrihet lart ose bie poshtë. Vdekja është ndryshimi i gjendjes dhe çasti i së vërtetës absolute.¹⁰

9. Mehmed Selimovic, Dervis i smrt, Sarajevë, pa vit dhe vend botimi.

10. Ersan Grahovac, po aty.

KOPRACIA

Sadik Dana

Allahu i Lartësuar urdhëron:

"Ata që, kur shpenzojnë, nuk shpërdorojnë, por edhe nuk tregohen kopracë, mbeten në një pozitë të ndërmjetme." (Furkan, 6)

"Allahu nuk e shpëton prej dënimit as atë që rri e mbledh pasuri për ta ruajtur fshehurazi, sepse xhehemi është një zjarr përvëlues." (Mearixh, 15-18)

Ashtu sikurse bujaria është cilësia më e lartë morale edhe koprracia është cilësia më e keqe. Mendjemadhësia dhe koprracia janë nëna e të gjitha të këqijave.

Gazaliu thotë:

"Disa thonë se koprraci është më i mirë dhe më i kup-tueshëm se zullumqari. A ka padrejtësi më të madhe se koprracia? Allahu na ka bërë të ditur, duke u betuar në madhështinë e Tij se koprracët me veten dhe të tjerët nuk kanë për të hyrë në xhenet."

Jahja bin Muadh ka thënë:

"Bujarët, sado të këqinj që të jenë, prapë se prapë në zemrat e tyre ka pak dashuri. Koprracët, sado të mirë që të jenë, prapë se prapë të gjithë i urrejnë."

Jahja bin Zekerija u takua me shejtanin dhe e pyeti se kë donte dhe kë urrente më shumë nga të gjithë. Shejtani i tha:

"Ata që dua më shumë janë koprracët, ndërsa ata që urrej më shumë janë bujarët, edhe nëse janë mëkatarë. Koprracia më mjafton mua, ndërsa bujari, sado mëkatar që të jetë, kam frikë se mos Allahu e fal për shkak të të mirave që u shpërndan njerëzve."

Ibn Abasi ka thënë:

"Kur Allahu e krijoi xhenetin e Adnit e urdhëroi atë dhe i tha:

- Stolis.

Xheneti u stolis.

-Lëshoji përrënjtë,- i tha Zoti.

Dhe xheneti i lëshoi përrënjtë me verë, mjaltë dhe qumësht.

-Nxirri në shesh rehatinë, rrobat prej pambuku dhe huritë,- i tha Zoti.

Pastaj Zoti i tha xhenetit të fliste dhe, me këtë rast, ai tha:

-Lum ata që do të hyjnë tek unë.

-Me përjashtim të koprracëve që nuk kam për t'i futur tek ti, - tha Allahu."

- Çfarë është ajo gjë që nuk i ka hije besimtarit nga gjithë shprehitë e këqija? - patën pyetur.

- Koprracia, - qenë përgjigjur.

I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Tri gjëra të shpëtojnë dhe tri gjëra të shkatërrojnë. Ato që të shpëtojnë janë abdesti me ujë të ftohtë, falja e namazeve me xhemat në xhami dhe të presësh me padurim që të falësh namazin e radhës. Tri gjërat shkatërruese janë koprracia, të pasosh dëshirat tuaja, duke mos dhënë zekat dhe të të hyjë vetja në qejf."

Në veprën Rijadu'n-nasihin thuhet:

"Robërit e Zotit janë përherë në sprovë."

Abdulkadir Gejlani, kuddise sirruhu, ka thënë:

Sufiu nuk mund të jetë kurrë koprrac, sepse nuk i ka mbetur gjë që të tregohet koprrac. Ai e ka braktisur dhe hedhur poshtë çdo gjë, për hir të dashurisë së Allahut, miqësisë me Allahun dhe shkrirjes në Të. Ai e zotëron vetëm në dukje mallin dhe pasurinë që zotëron. Gjërat e botës që i fiton, nuk i fiton për vete, por për të tjerët, në mënyrë që të tjerët të përfitojnë. Zemra e sufiut është pastruar nga të gjitha krijesat, format dhe trajtat, me përjashtim të dashurisë së Allahut. Dihet se, vetëm ata që e kanë në zemër dashurinë e pasurisë bëhen koprracë.

Jeta nuk e bën të lumtur, vdekja nuk e të trishton. Kur ndodhet mes njerëzish, ndihet i frikësuar, ndërsa kur gjendet vetëm, ai kërkon të shkrihet me Zotin. Ushqimi i tij është dhikri.

Nuk ka dyshim se një sufi në këtë shkallë nuk tregohet koprrac me pasuritë dhe të mirat e kësaj bote, sepse ai është i zhveshur nga të gjitha këto përpara Allahut. Ai nuk ia ka nevojën asnjërës prej begative të kësaj bote. (Abdulkadir Gejlani – Kuvendimi i pesëdhjetë e shtatë)



Ekрани i lirë dhe shpërdorimi i lirisë

Zimo Krutaj

Diskutimet për lirinë e medias, në thelb, kanë përfshirë gjithnjë edhe kufizimet e domosdoshme përkatëse. E lidhur drejtpërdrejt me lirinë e shprehjes, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, liria e medias është e sanksionuar ligjërisht dhe përbën një nga shtyllat e veprimtarisë radiotelevizive në vendin tonë. Por kjo përmasë shumë e rëndësishme e lirisë, e siguruar tashmë realisht, nuk duhet të tejkalohet e të shpërdorohet, duke hyrë në konflikt me të drejta, përmasa lirie e detyrime të tjera të mediave të shkruara dhe elektronike. Të tilla janë ruajtja dhe mbrojtja e së vërtetës, shëndetit dhe moralit, respektimi i dinjitetit dhe privatësisë së individit, mbrojtja e të drejtave të të miturve, të personave me aftësi të kufizuara etj.

Pavarësisht përkufizimeve detyruese të ligjeve shqiptare apo të konventave ndërkombëtare në këtë fushë, mendoj se duhet ta trajtojmë gjendjen e medias shqiptare në raport me lirinë dhe vlerat morale, si detyrim profesional e qytetar, si vlerë shpirtërore, jo rrallë e munguar në ekranin e vogël. Shpërdorimi i lirisë, nëpërkëmbja e vlerave njerëzore e qytetare të etikës e kulturës së komunikimit, janë dukuri që kanë shoqëruar zhvillimin e vrullshëm të medias sonë elektronike në dekadën e fundit, duke ndikuar negativisht në cilësinë e programeve të saj.

Në panoramën mediatike shqiptare ka disa ope-

ratorë radiotelevizivë, veçanërisht televizionet tona kombëtare, që tashmë janë një vlerë e padiskutueshme e lirisë, e pluralizmit, e shoqërisë dhe e kulturës shqiptare. Niveli, përvoja, por edhe fuqia e tyre investuese, tashmë është e tillë, sa që nuk mund ta nënvleftësojë e ta lërë pas dore cilësinë e programacionit, afirmimin në media të vlerave morale që edukojnë e formojnë qytetarët e ardhshëm të këtij vendi përmes respektimit të lirisë dhe shmangies së shpërdorimit të saj. Një shembull të qartë të keqpërdorimit e shpërdorimit të lirisë, të keqinformimit e të dëmtimit, në radhë të parë, të ekuilibrave formues e edukues të fëmijëve e adoleshentëve të sotëm, përbën transmetimi integral i prodhimeve të Kinostudios "Shqipëria e re", apo realizimeve filmike të Televizionit Shqiptar të kohës së diktaturës komuniste. Themi "në radhë të parë", se kjo pjesë e shoqërisë së sotme është e pambrojtur ndaj ideve, mesazheve antihumane e estetike që rrjedhin prej këtyre realizimeve që i thurin lavde e hosanara një regjimi diktatorial.

Qëndrimi ndaj regjimit komunist, ndaj diktaturës së proletariatit, ka vite që është bashkëshoqërues i tranzicionit të zgjatur të shoqërisë së sotme shqiptare. Pjesë e rëndësishme e këtij qëndrimi janë ra-



portet me trashëgiminë letrare e artistike të kohës së diktaturës, sidomos me atë pjesë të filmografisë së kohës, e cila, qartas e pa asnjë ekuivok, glorifikon deri në absurd regjimin komunist, figurat politike të saj, luftën e klasave etj. Prej shumë vitesh media shqiptare, veçanërisht shtypi i shkruar, por edhe media elektronike, përmes rubrikave të shumta si dosierët, intervistat, portretet, emisionet, filmat, dokumentarët, ditarët, etj., i kanë servitur publikut prodhime të pjesshme ose të plota, të realizuara në kohën e diktaturës komuniste. Kemi mendimin se kjo nxitet e bëhet më shumë për arsye që “diktohen” nga një lloj nostalgjie e tregut për këto lloj prodhimesh, sesa me qëllime njohjeje, analize apo studimesh të zhvillimeve shoqërore e historike. Të ndikuar nga ky “sukses”, kohët e fundit, ka kanale televizive që transmetojnë në mënyrë të përsëritur, të plotë, pa asnjë lloj komenti, madje duke i paralajmëruar përmes spoteve joshëse, shumë prodhime kinematografike e televizive të diktaturës komuniste.

Transmetimi i plotë i këtyre prodhimeve të Kinostudios “Shqipëria e re” apo Televizionit Shqiptar, përveçse një shembull i shpërdorimit të lirisë dhe të së vërtetës, është keqpërdorim i dhunës, informim i dëmshëm e i gabuar, shtrembërim e deformim i historisë etj. Përmbajtja e këtyre prodhim-realizimeve është e njohur. Le të kujtojmë vetëm shkarazi mjaft realizime të dobëta filmike, sidomos dokumentarët që kanë në qendër terrorin e kuq të luftës së klasave, gjyqet, luftën kundër fesë, shpërftyrimin e njeriut si qenie individuale, urrejtjen ndaj pronës, kapitalit, adhurimin deri në flijim për idealin komunist e udhëheqësit komunistë etj. Në thelb ato godasin shtyllat më të rëndësishme mbi të cilat mbështetet zhvillimi i shoqërisë së sotme njerëzore: liritë dhe të drejtat

themelore të njeriut. E gjithë shoqëria shqiptare sot, përmes aksesorëve të ndryshëm të saj, sidomos përmes shkollës dhe familjes, e mbështet edukimin dhe formimin e fëmijëve e të rinjve në shtyllat e mësipërme. Po çfarë u ofrojnë teleshikuesve të mitur, adoleshentë e të rinj transmetimet e ritransmetimet e panumërta të programeve të sipërpërmendura? Pasdite e, më shpesh në mbrëmje, në një nga orët më të ndjekura, fëmija përpara ekranit, sheh e dëgjon në televizor, nga fillimi në fund, fjalimin e Enver Hoxhës “Demokracia proletare –demokraci e vërtetë”. Ndjek me kureshtje moshatarët e vet të dikurshëm dhe turmat në delir para udhëheqësit, apo adoleshentë me kasma e lopata në duar teksa shkatërrojnë institucionet e kultit, faltore, kisha, xhami e tyrbe të vjetra, duke kënduar për Partinë. Sheh edhe një radhë kriminelësh të dënuar nga “gjyqet e popullit”... Për disa prej tyre, paradite, në shkollë, ka mësuar se janë martirë të kombit e shembuj për t’u ndjekur. Më tej dëgjon se Amerika qenkësh “xhandar ndërkombëtar e armiku më i madh i popullit shqiptar,” kur sapo ka parë pritjen për ambasadorin amerikan në Tiranë... Dhuna që buron nga ekrani, këtu nuk është më e tërthortë, por e drejtpërdrejtë. Ajo dëmton e deformon koncepte të marra rishtas, krijon koncepte të shtrembra, prish ekuilibra që në vetvete janë të brishtë, por bëhen edhe më të dobët nga përplasja e informacioneve të marra nga burime të ndryshme, për dikë që nuk është ende në gjendje të gjykojë në mënyrë të pavarur. Atij i është dhunuar pikërisht e drejta për të vërtetën, dhe keqinformimi i moshave të reja, në këtë rast, nuk mbaron këtu. Ai përzihet me një dhunim e persekutim të ri, kësaj here mediatik (por që nuk mbetet vetëm i tillë) të të gjithë atyre që ishin viktimat të drejtpërdrejta të terrorit komunist, të fëmijëve e të të afërmeve të tyre.

Nga ana tjetër, transmetimi i plotë i një dokumentari që glorifikon diktaturën komuniste, zhvlerëson në mendjen e fëmijës, por edhe në ndërgjegjen e tij, për shkak të ndikimit të madh të medias dhe të ndjeshmërisë së moshës, mjaft nocione, përcaktime e parime morale të rëndësishme. Natyra e tyre është e tillë, që, për shkak të specifikave që lidhen me mjedisin, formimin, moshën, personalitetin e karakterin e individit në formim e sipër, nguliten më pas e ndikojnë në gjithë jetën e individit, qytetarit të ardhshëm. Nocionet mik – armik, liri - demokraci, lider – qytetar, i pasur - i varfër, i mirë - i keq e të tjera, përqasen e ngatërrohen me përcaktimet kriminel – hero, spiun – diversant, anarki – diktaturë, udhëheqës – proletar, besnik – tradhtar, religjion – ideologji, etj.

Një rrezik më pak i dukshëm, jo dhe aq i drejtpërdrejtë, me një veprim të ngadaltë por të sigurt, është ngulitja te fëmijët dhe moshat e reja e disa kategorie estetike në mënyrë të shtrembër, shpesh të përçudnuar, që më pas është shumë e vështirë të riformohen e të zëvendësohen. Kjo lidhet me të ashtuquajturën estetikë socrealite. Glorifilimi i lejfenizmit, i *homus novus* të kohës së diktaturës, veç të tjerash, është një nga krimet e para estetike të arteve e sidomos të filmografisë komuniste në vendin tonë. Parulla e njohur për "... ndihmësit e Partisë në edukimin komunist të masave", nuk ishte një slogan dhe aq. Ishte një parim themelor i diktaturës së proletarietit në veprim, ishte filli i kuq i ideologjisë komuniste që përshkonte veprat artistike. Forma dhe figurat artistike, të përdorura në krijimet e asaj kohe, i nënshtrohen këtij qëllimi dhe parë nga këndvështrimi i sotëm, kategoritë estetike lëvizin nga shtrati i tyre i mëvetësishëm dhe nga funksioni normal, duke krijuar deformime e keqkuptime të mëdha. Shtrembërimi i të vërtetave historike shoqërohet me deformimin e të vërtetave apo parimeve estetike e artistike. Këtyre u shtohen edhe situatat e stisura, trajtimet skematike bardhë e zi, varfëria e shprehjes, loja patetike dhe emfatike në shumicën e filmave artistikë, si dhe gjuha e thatë, skeletike, në stilin e raporteve e fjalimeve në kongreset famëkeqe të partisë. Kategori të njohura estetike si e bukura, e shëmtuara, e madhërishmja e ulëta e të tjera, në këto krijime e çorientojnë krejtësisht një personalitet në formim e sipër. Gjithashtu, fëmija apo adoleshenti i sotëm shqiptar të cilit i serviren kino-ditarët, dokumentarët apo filmat e llojit të sipërpërmendur, pa sqarime e koment shoqëruar, ndjehet i pambrojtur dhe i dëmtohen seriozisht formimi, aftësia për gjykim të pavarur dhe shijet. Sepse i duhet të pranojë të mirëqena klishe të tilla (a)estetike si "klerikët armiq e spiunë, gjithnjë të këqij", "Komisari e sekretari i partisë i mirë..." "Mbreti Zog-satrap", "Beljerët – tradhtarë e anadollakë" e kështu me radhë... Por teksti i sotëm i historisë së Shqipërisë, që fëmijët bëjnë në shkollë, thotë të kundërtën: Klerikë shqiptarë, të të tri feve, ishin atdhetarë të shquar, gjyqet komuniste shfarosën intelektualë të mirëfilltë, Ahmet Zogu ishte burrë shteti, që themeloi e konsolidoi shtetin shqiptar, dhe bejlerët, përveçse etërit e kombit si Ismail bej Qemali, ishin mendjendritur si fjala vjen bejlerët e Frashërit, Eqrem bej Vlora apo Faik bej Konica, të cilin bota e qytetëruar e quante "enciklopedi shëtitëse"... Filmat e kohës së diktaturës që denigrojnë figura të tilla, të cilat janë ajka e patriotizmit, maja e lëvrimin të gjuhës e të vlerave estetike e artistike,

Respektimi i lirisë dhe jo shpërdorimi i saj, zbatimi i ligjit dhe parimeve e normave të etikës dhe jo nëpërkëmbja e tyre, do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në vlerat dhe cilësinë e asaj që na "mbërthen" para ekranit të vogël



edukojnë shije të këqija edhe për krijimtarinë si vlerë e mirëfilltë në vetvete. Ato i nivelojnë shijet, i shtyjnë drejt mediokritetit kërkesat estetike, pengojnë gjykimin e shëndoshë të shikuesve që, në këtë rast, janë nxënës, si dhe çorientojnë dhe prishin ekuilibrat e domosdoshëm të edukimit e të formimit. Siç thotë Marshall McLuhan, në veprën *Instrumentat e komunikimit – Media si një zgjatim i njeriut*, dukuria e sines-tezisë, "bashkimi i shqisave dhe jetës imagjinare" që u realizua "në jetën e përditshme me anë të veprimit estetik të radios dhe televizionit", duhet konsideruar jo vetëm si mundësi, por edhe si përparësi e medias. Ndaj duhet vlerësuar gjithnjë si e tillë.

Respektimi i lirisë dhe jo shpërdorimi i saj, zbatimi i ligjit dhe parimeve e normave të etikës dhe jo nëpërkëmbja e tyre, do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në vlerat dhe cilësinë e asaj që na "mbërthen" para ekranit të vogël. Dënimi i krimeve të komunizmit mund të bëhet me rezolutë, por të gjitha gjymtyrët e shoqërisë, sidomos media televizive, duhet të bëhen pjesë e këtij vlerësimi, që të kemi sa më pak raste të shpërdorimit të lirisë së ekranit të vogël. Transmetimi me koment, për qëllime ilustruese, është një akt dhe detyrim profesional, pasi ajo që mbetet përtej përmbajtjes së programeve a emisioneve të këtij lloji, është mosrespektimi i kodeve e raporteve etike e profesionale, dëmtimi e keqformimi i shijeve dhe, ç'është më e rëndësishme, cënimi i dinjitetit të publikut. Nuk e kemi fjalën për ndalimin, por për transmetimin kritik të filmografisë për diktaturën, të shoqëruar me analiza e komentet përkatëse, në fasha orare të përshtatshme. Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, një minimum i përgjegjësisë shoqërore, morale e profesionale të medias kërkon të mbahet parasysh se dëmtohet edhe vetë ekrani që transmeton programe të kësaj natyre, të cilat nëpërkëmbin etikën televizive dhe ulin nivelin e cilësinë e komunikimit me shikuesit.



Vorbulla e indiferencës

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Raporti i njeriut me Zotin është mes përmendjes së Tij (*dhikrit*) dhe indiferencës ndaj Tij (*gafletit*). Indiferenca është harresa, ndërsa përmendja është mos'harresa. Ajo që kërkohet nga njeriu është mos'harresa e Zotit dhe e betimit që kemi bërë para Tij. Mirëpo, për arsye të dy lloj harresave që ka natyra njerëzore, *nisjan-it* dhe *sehv-it*, njeriu i jep mundësinë e lindjes së indiferencës. Kështu ai, shpeshherë largohet nga Zoti dhe nga fjala që i ka dhënë Atij.

Indiferenca, si një veti njerëzore, përmban në vetvete shkujdesjen e qëllimshme dhe të vullnetshme. Krahas këtyre, fjala "gaflet" në arabisht, (indiferencë, në shqip) përmban në vetvete edhe kuptimin e të qenit i painformuar. Prandaj dhe në fundin e ajeteve që rrëfehen për popujt e mëparshëm, ndeshet kjo shprehje, "**...ndonëse ti, me të vërtetë, nuk ke qenë në dijeni (gafil) më parë**" (Jusuf, 3). Natyrisht, këtu Profeti nuk akuzohet për indiferencë, por thjesht ishte i painformuar.

Harresa e pavullnetshme është *nisjan-i*, ndërsa e vullnetshme është *gaflet-i*. Ata që kanë dozë të rëndë të *nisjan-it*, i pret një rrezik i tillë: shkëputja e lidhjes me Zotin, rënia në pozitën e atyre që harrojnë veten dhe që Zoti i harron ata. Për të shpëtuar nga *nisjan-i*, duhet bërë shumë *dhikër*. Andaj dhe Allahu i Madhëruar thotë: "**Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, e për këtë shkak Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).**" (Hashr, 19)

Indiferencë (*gaflet*) ka kuptimin edhe të një neglizhence për arsye të hallakatjes së kotë, moskuptimit dhe mosvlerësimit të disa gjërave që kanë rëndësi për kuptimin e kësaj bote dhe tjetrës. Mosperceptimi i asaj që është e rëndësishme, për arsye të ndikimit që bën epshi, e shtyn njeriun në gabime gjatë jetës së tij fetare. Ilaçi i të gjithave është përmendja e Zotit (*dhikri*). Njerëzit e *dhikrit* dallojnë të mirën nga e keqja përmes dijes së tyre. Po ashtu përqafojnë me kënaqësi veprat që do t'i shpëtojnë në botën tjetër.

Indiferenca fetare është mosnjohja e Zotit,

mosnjohja e vetvetes dhe pakujdesia në njohjen e gjithësisë, si një pasqyrë e manifestimit hyjnor. Të mos përdorësh veçorinë e të reflektuarit të gjithësisë, duke u zhytur në dynja, është indiferencë. Të mos i shohësh detajet dhe cilësitë e urta të gjithësisë, është indiferencë. Të mos mund të shikosh *enfus*/brenda dhe *eflak*/jash-të me syrin mirënjohës, është indiferencë. Indiferenca që gjendet në syrin e njeriut është një perde e madhe edhe në syrin e zemrës. Prandaj ky njeri, ashtu sikur nuk është i vetëdijshëm për atë çfarë kërkon, nuk është i vetëdijshëm as për atë që gjen.

Indiferenca është një prej kurtheve të gabimeve dhe dëshirave epshore. Ata që ambicien e kanë të madhe dhe veprën të mangët, janë në *gaflet* të ardhjes së çastit të fundit. Sipas qasjes sufiste, në shpëtim arrihet duke lënë mënjanë ambiciet dhe duke përqaftuar veprën. Heqja dorë nga ambiciet ka kuptim vetëm kur përqafton veprat me kujdesin për çastin e fundit. Kështu, tek individ, krijohet vetëdija e të qenit me Zotin, pra ndërgjegjja e *dhikrit*.

Egoja njerëzore përherë kërkon qetësi, gëzim e hare. Këto janë produktet e indiferencës ndaj fesë. Egoja që është me perde, këtë botë të vdekshme e shikon si të pafundme. Njeriu indiferent mendon të jetojë me plot hare dhe përpiket ta shijojë pafundësisht jetën. Po nuk u the "ndall!", këto ndjenja zhvillohen gjithnjë duke ushqyer njëra – tjetrën. Rruga për të shpëtuar nga këto ndjenja që kanë zënë rob egon me *gaflet*, është të respektosh urdhëresat hyjnore.

Njerëzit që i ka zënë sëmundja e indiferencës ndaj fesë dhe që Zoti i ka dënuar me këtë indiferencë, është e vështirë t'i drejtohen jetës fetare. Andaj dhe Allahu i Madhëruar në Kuran shpjegon në këtë mënyrë se përse nuk duhen gjëmuar këta njerëz: **"Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit e kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e që shkon pas dëshirave të veta, duke shkelur çdo kufi në veprimet e tij."** (Kehf, 28)

Në hadithet profetike përmendet raporti mes



"Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, e për këtë shkak Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut)"

(Hashr, 19)



gafletit dhe *dhikrit*. Thuhet se nuk duhet qëndruar indiferent ndaj Zotit, përmendjes së Tij dhe Kuranit. Gjithashtu përmendet edhe se nuk pranohen lutjet që bëhen nga një zemër mospërfillëse. Para se të përdorë fjalën *gaflet*, i Dërguari i Allahut shpjegon për një tym që do të kaplojë zemrën dhe, për të shpëtuar nga kjo gjendje, ai bënte 70 herë në ditë *istigfar*. (Myslim, Dhikr, 41) Me këto shpjegime, ai tregon rëndësinë e *istigfarit* për të shpëtuar nga dhuna shpirtërore që të jep në zemër ndikimi i indiferencës.

Për arsye se sufite e kanë vlerësuar indiferencën si fatëkeqësia më e madhe dhe si shkak kryesor i nxirjes së zemrës, përgjumjen nga indiferenca e shikojnë si gjumi më i rëndë. Sepse, sikur të mos ishte indiferenca, njeriu nuk do të bëhej rob i dëshirave të epshit. Mënyra më efikase për ta dëbuar atë nga zemra, është frika ndaj Zotit.

Sipas sufive, ka një raport edhe mes indiferencës dhe injorancës. Injoranca ndërton themelet e indiferencës, kurse dituria dhe njohja e së vërtetës janë shkak për t'u shkatërruar indiferenca.

Perdja më e trashë mes njeriut dhe Zotit është

“Allahu im, mos më lër me veten time as sa të hapen e të mbyllen qepallat dhe as për një kohë më të shkurtër se kaq”.

(Ebû Dâvud, Edeb, 100-101)

perdja që lind dashurinë për këtë botë. Shijet e përkohshme të kësaj bote e mashtrojnë njeriun dhe e bëjnë të harrojë botën tjetër.

Perdja e indiferencës nuk është e mundur të asgjësohet tërësisht dhe nuk është e nevojshme një përpjekje e tillë, pasi harresa dhe indiferenca tek njeriu nganjëherë janë mëshirë e Zotit. Sikur Allahu i Madhëruar t’u jepte njerëzve të sinqertë frikë në proporcion të njohjes së Zotit që ata kanë, do të ishte e pamundur që njerëzit të vazhdonin jetën me këto ndjenja. Madje, disa ashikë dhe besimtarë të sinqertë që nuk kanë aftësi të shohin manifestimet *Xhemal* dhe *Xhelal* të Allahut, kanë nevojë për indiferencë. Sipas disa sufive, nëse indiferenca nuk do të shfaqej aspak, besimtarët e sinqertë do të shkatërroheshin nga kënaqësia që do t’u jepte *dhikri*. Sikur Allahu të mos ua harronte njerëzve vdekjen përmes *gafletit*, njerëzit nuk do t’i drejtoheshin botës për ta ndërtuar. Prandaj kjo lloj indiference dhe harrese është mëshirë.

Në një rast shkëputjeje momentale nga intensiteti shpirtëror, i Dërguari i Allahut, (a.s.) iu drejtua **Hz. Aishes**: “Folmë, o Aishe!”. Kjo tregon se intensiteti shpirtëror nuk është gjithnjë i vazhdueshëm. Sikur të ishte kusht apo e mundur një gjë e tillë, i Dërguar i Allahut nuk do shprehej në këtë mënyrë. Mirëpo, i njëjti profet, për të shtuar atmosferën dhe prehjen shpirtërore, iu drejtua **Hz. Bilalit**: “Qetësona, duke na ftuar në namaz, o Bilal!”. Të dy këto gjendje janë një argument, se njeriu nuk mund të ketë një *dhikër* dhe prehje shpirtërore të vazhdueshme.

Lloji katastrofik i indiferencës dhe harresës është ai që e largon njeriun nga praktika fetare. Ky është lloji i indiferencës që njeriu duhet ta luftojë dhe që e fut atë në vështirësi. Kjo lloj indiference i jep plagë botës shpirtërore të njeriut dhe nuk i jep mundësi të marrë kënaqësi nga adhurimet.

Ashtu sikurse një i dehur me alkool nuk ka lidhje me namazin, po ashtu edhe një të dehuri me *gaflet* i bëhet pengesë arritja tek Zoti.

Si të gjitha ndjenjat psikologjike, ashtu edhe indiferenca është si një sëmundje ngjitëse. Ai që qëndron me njerëz indiferentë, ngjyrosset me ngjyrën e tyre. Ata që qëndrojnë me besimtarë dhe me njerëz që përmendin Zotin, ndjejnë aromën e ndjenjave të bukura.

Mesazhin më të madh për zemrat besimtare e jep vdekja dhe të vdekurit. Në fakt, i vdekuri, në qetësi të plotë, mes thirrjesh të pazë, u thotë atyre që marrin pjesë në faljen e xhenazes: “Mos i mbyllni buzët si të vdekur, hapni për *dhikër*. Ne kaluam kohën me *gaflet*. Të paktën, ju vlerësojini ato frymë të fundit që ju kanë mbetur. Ne jetuam me *gaflet* duke menduar dobinë e materies. E konsumuam jetën me injorancë. Bëni kujdes, mos e bëni edhe ju këtë gabim.”

Pas vdekjes së të afërmve, njerëzit i kuptojnë mirë këto mesazhe. Madje në vetvete, marrin vendime dhe objektiva të reja. Por nuk kalon shumë dhe harrohen të gjitha. Sërish gjithçka bëhet kurban i *gafletit*. Prishet pendimi dhe harrohen fjalët e dhëna në vetvete. Duke vazhduar jeta në këtë mënyrë, papritur troket Azraili. Vjen koha e takimit me të. Një takim që nuk mund të neglizhohet apo ndryshohet. Dalja faqebardhë nga ky takim është e lidhur me atë sesa e rrëzon perden e indiferencës. Ai që ka rënë në kurthin e indiferencës, do të shokohet nga vdekja që vjen papritmas, por përfundimi nuk do të ndryshojë. Prandaj gjatë jetës, duhet të përpiqemi t’i japim një kuptim dhe rëndësi të veçantë përmendjes së Zotit dhe të mundohemi të jemi prej atyre që gjithnjë kujtojnë Allahun dhe t’i lutemi Atij që të mos jemi prej indiferentëve.

Bruga për të shpëtuar nga indiferenca arrihet duke u mbështetur tek Allahu. I Dërguari i Allahut ka kërkuar mbështetje tek Zoti për ta shpëtuar nga vorbulla e *nefsit* dhe e indiferencës, duke thënë: “Allahu im, mos më lër me veten time as sa të hapen e të mbyllen qepallat dhe as për një kohë më të shkurtër se kaq”. (Ebû Dâvud, Edeb, 100-101) Gjithashtu edhe ne i mbështetemi Atij.

Rëndësia e shkencave fetare në jetën tonë



Ali Byjyqçapar

Dija është prej gjërave nga të cilat nuk mund të heqim dorë në jetën që jetojmë. Në Librin tonë të Lartë ka ajete të panumërta në lidhje me dijen, e cila u jep dritë mendjeve dhe jetë zemrave. Edhe Pejgamberi ynë i dashur, në lidhje me këtë temë ka thënë fjalë të pavdekshme.

Dija është mirësi.

Ndërsa jetojmë, kemi nevojë për klasifikime të ndryshme si nevojë e krijimit dhe bëjmë emërtime, si jeta e kësaj bote dhe jeta e botës tjetër. Në këtë botë duhet të bëjmë një ndarje të tillë për ta kuptuar dhe për t'ua shpjeguar të tjerëve. Nuk ka ndonjë problem që, të njëjtën metodë mendimi, ta ndajmë në shkencat fetare dhe shkencat e kësaj bote.

Atëherë, cili do të jetë kufiri i kësaj teme?

“Kur popujve të kaluar u erdhën pejgamberët me mrekulli dhe drita hyjnore që tregonin të vërtetën, ata u mbështetën te shkencat që kishin dhe u mburrën kundrejt atyre udhëzuesve. Nuk i pranuan dijet që sollën ata nga fronet e gajbit dhe u tallën me argumentet e Allahut, por këto tallje të errëta që i bënin për shkak të injorancës së tyre, i rrethuan ata në një formë ndëshkimi.” (Mu'minun, 83)

Për përfundimet e dhembshme që pësojnë njerëzit, kur nuk i përfillin dituritë hyjnore, tregon historia e njerëzimit qysh në zanafillën e saj.

Dituritë shkencore që përftojmë në lidhje

me këtë botë, na ndriçojnë jetën duke na ndihmuar të kuptojmë ngjarjet e ndryshme të ditës. Ndërsa një mendje që nuk ngopet nga mendimet e pjesshme, e zgjeron gamën e pyetjeve. Ajo pyet në lidhje me pasvdekjen dhe me të përtejmen.

Shkencat fetare hyjnë në funksion pikërisht në këtë fushë. I japin fuqi shpirtit e trupit dhe i shpien ata te e vërteta dhe te e bukura. E zhvillojnë mendjen duke i treguar asaj argumente që e ndajnë të vërtetën nga e pavërteta. E ndriçojnë botën e brendshme të njeriut me shpallje e frymëzim dhe e mbajnë gjallë shkencën dhe ndjeshmërinë e artit.

Shkencat fetare e kapin jetën duke përdorur litarin e urtësisë.

Pejgamberi ynë thotë: *“Vetëm ndaj dy njerëzve mund të ndjehet zili. Ndaj atij që Allahu i ka dhënë urtësi, vepron sipas kësaj urtësie e ua mëson këtë të tjerëve dhe ndaj atij që Allahu i ka dhënë pasuri e ai e harxhon atë në rrugë të drejtë.”*

Dituria na ndihmon të përparojmë në rrugë të urtësisë për t'u bërë myslimanë më të mirë. Atëherë, le të ecim së bashku në rrugën e saj.



TOTALITARIZMI DHE TIPARET E TOTALITARIZMIT KOMUNIST E FASHIST

Nuro Nazarko

Historia njerëzore është e mbushur plot ravgime të njeriut për t'i dhënë zgjidhje shqetësimit për zbulimin e kuptimit të ekzistencës dhe njëkohësisht për t'u dhënë zgjidhje edhe problemeve të jetës tokësore, qofshin këto politike, ekonomike, sociale, kulturore etj. Njeriut, si qenie e lirë, i është dashur të zgjedhë mes feve të ndryshme, ideologjive të ndryshme, rrymave filozofike të ndryshme, gjithmonë me shpresën se e ardhmja, që *de facto* nuk mund të njihet empirikisht, do të jetë më e mirë, më e paqtë, më e begatë. Prej zgjedhjeve që ka bërë njeriu, meqënëse është qenie e lirë për të zgjedhur, është edhe totalitarizmi, i shpërfaqur në dy forma, komunist dhe fashist, gjatë shekullit XX. Totalitarizmi, edhe pse u shpërfaq dhe u konsolidua në këto dy forma, nuk është dukuri vetëm e këtij shekulli, nuk është produkt vetëm i rrethanave të caktuara historike në shtete të caktuara. Tendencat totalitaris-

te ishin shfaqur edhe në shekujt e mëhershëm, ku mund të përmendim si shembull Luigjin XIV, me deklarin e tij se "shteti jam unë", vetëm se aso kohe mungonte teknologjia që do t'i mundësonte kontrollin e plotë mbi provincat, një-lloj si në qendër. Totalitarizmi është tendencë e çdo lloj sistemi qeverisës, bazuar në çfarëdolloj legjitimiteti, si në kohë ashtu dhe në hapësirë. Ndryshimi thelbësor qëndron në mënyrën se si realizohet totalitarizimi nga sistemet dhe mbi të gjitha për çfarë qëllimi realizohet. Totalitarizmi ka si qëllim kontrollin e tërësishëm, jo vetëm të një hapësire gjeografike të caktuar, por edhe kontroll të tërësishëm të qenieve që jetojnë në këtë hapësirë gjeografike. Asnjë detaj jetësor, brenda hapësirës që mëton të kontrollojë totalitarizmi, qoftë ky edhe "i parëndësishëm", nuk duhet t'i shpëtojë survejimit dhe kontrollit. Ky kontroll dhe survejim nuk mund të realizohet vetëm me ushtrinë e bindur të besnikëve dhe

bijve ideologjikë. Totalitarizmi, përveç të sipër-përmendurve gjen aleatin më të ngushtë, më dobiprurës dhe të pafjalë tek teknologjia moderne. Përmes shfrytëzimit të teknologjisë moderne, mundësive që ofron në përcimin e ideve dhe propagandës, realizohet kontrolli dhe survejimi edhe i pikave më të thella të hapësirës gjeografiko – politike që synohet të kontrollohet. Kështu totalitarizmi është pashmangshmërisht i lidhur me teknologjinë moderne dhe, për shkak të dobiprurjes, përpiqet ta zhvillojë e përsosë më tej, duke e instrumentalizuar në funksion të qëllimit të tij. Totalitarizmi i shfaqur në të dy format, komunist dhe fashist, shpërfaqet në një sërë tiparësh të përbashkëta, përgjatë përpjekjeve për jetësimin e ideologjive përkatëse. Këto dy rryma përbashkohen në këto tipare:

1) IDEOLOGJIA TOTALITARE¹

Ekziston vetëm një ideologji sunduese, komuniste apo fashiste. Nuk njihen si legjitime ideologji të tjera apo alternativa të kundërta me ideologjinë e vetme sunduese. Çdo alternativë e ndryshme nga ideologjia sunduese jo vetëm që nuk pranohet si konkurente, por luftohet me çdo lloj mjeti. Ideologjia komuniste apo fashiste konsiderohet gjithpërfshirëse, tërësore, pasi udhëheq e vetme dhe në kontroll të plotë, jo vetëm sferën publike, por edhe atë private. Në jetën e vet, individi ka busull ideologjinë sunduese. Referimi tek ideologjia sunduese për orientimin e *modus vivendi*-t, nënkuptonte se kjo ideologji ishte shpjeguese, orientuese, qartësuese edhe për detajet më imtësore të *modus vivendi*-t. Ideologjia “qartësonte” edhe thelbin mbi të cilin ngrihej mënyra e të jetuarit, botëkuptimi. Njeriu duhej ta ndërtonte jetën mbi themelet e botëkuptimit që ideologjia ia ofronte të gatshëm, duke eliminuar mendimin e njeriut si personalitet, pasi ky ishte botëkuptimi i vetëm dhe i vërtetë që duhej pranuar pa kushte. Ideologjia sunduese ishte edhe parashikuese e së ardhmes, e cila do të ishte e ndritur, e paqte, e begatë, e ngritur mbi një rend të ri botëror, i dominuar nga ideologjia e vetme sunduese,

1. Historia e sistemeve të qeverisjes, Llambro Filo, Tiranë 2000, fq. 193.

përrjashtuese e çdo mendimi alternativ, përrjashtuese e çdo besimi fetar.

2) PARTIA - SHTET²

Në totalitarizmin komunist apo fashist ka vend vetëm për partinë komuniste apo fashiste. Në qoftë se kanë ekzistuar parti të tjera politike, para se këto ideologji të ngjiteshin në pushtet, pas ngjitjes në pushtet eliminohen të gjitha forcat rivale politike. Eliminimi i pluralizmit zhduk konkurrencën politike, zhduk mendimin alternativ për zgjidhjen e problemeve jetësore, pasi besohet se ideologjia e vetme sunduese e mishëruar në strukturat e partisë drejtuese, i jep përgjigje çdo problemi i çfarëdo sferë qoftë. Eliminimi i mendimit alternativ sjell monopolizimin e pushtetit në të gjithë sektorët e qeverisjes, nga partia komuniste apo fashiste, duke e kthyer sistemin e qeverisjes në sistem monist. Monizimi i sistemit qeverisës godet çdo kundërshtar që përpiqet qoftë edhe ta gërvishë këtë strukturë monolite edhe përmes më të thjeshtës dhe më të rëndësishmes njëkohësisht, fjalës. Monopolizimi i sistemit të qeverisjes vetëm nga një parti e kthen këtë në parti – shtet. Partia – shtet shpreh dhe mbron interesat e grupit në fuqi, komunist apo fashist, duke goditur pamëshirshëm dhe me egërsi interesat e çfarëdo grupi interesi, madje edhe interesat e grupeve të caktuara brenda vetë partisë – shtet, kur këto interesa bien ndesh me ato të grupit më të fuqishëm brenda partisë. Partia – shtet synon ruajtjen dhe vazhdimësinë e pushtetit në të gjitha hallkat e qeverisjes. Për këtë qëllim, gjithë aparati i nomenklaturës burokratike, ndërtohet mbi sistemin e patronazhit, nepotizmit, prej të cilit përfitojnë të gjithë ata që janë të lidhur me njëmijë e një fije me partinë – shtet dhe që i nënshtrohen në mënyrë të padiskutueshme çdo direktive të dalë nga strukturat e saj.

3) KULTI I UDHËHEQËSIT³

Udhëheqësi është një, i vetëm, i parival. Ai ka autoritet të padiskutueshëm, jo vetëm brenda radhëve të partisë – shtet, por edhe mbi masat e gjera të popullsisë. Udhëheqësi çilësohet me

2. Ibid, fq. 193.

3. Ibid, fq. 193.

atribute të jashtëzakonshme, që dallohen prej cilësive të njerëzve të zakonshëm. Ai cilësohet si mendjendritur, mendjemprehtë, i pagabueshëm, largpamës, vizionar. Ai është njeriu që di gjithçka mbi atë se çfarë është apo nuk është e drejtë, se çfarë është apo nuk është e mirë, se çfarë është apo nuk është e keqe, e gabuar, se çfarë është apo nuk është e moralshme për nënshtetasit e vet, për të sunduarit e vet. "Zotërimi" i të tilla cilësive shërben si burim i përcaktimit të të gjitha politikave të zhvillimit politik, ekonomik, kulturor nga udhëheqësi. Çfarëdolloj arritjeje i blatohet vetëm udhëheqësit. Vetëm ai është gjenialiteti që i kupton siç duhet situatat, problematikat e jetës dhe zhvillimit. Vetëm ai është gjenialiteti që ka aftësitë dhe mundësitë për të përcaktuar zgjidhje origjinale, gjeniale, të drejta, të duhura, të pagabueshme që do t'u shërbejnë masave, si fanar ndriçues dhe garanci për mirëqenien e tyre dhe ngritjen e rendit të ri, me triumfin e komunizmit apo fashizmit. Ai është gjithmonë në kohën dhe vendin e duhur për t'u dhënë zgjidhje problemeve dhe situatave të turbullta e të paqarta, të rrezikshme për pushtetin e tij. Fjala e udhëheqësit duhet të zbatohet pa hezitimin më të vogël. Askush nuk duhet të vendosë në peshoren e mendimit vërtetësinë e fjalës së tij, pasi fjala e tij është vetë "e vërteta". Fjala e udhëheqësit është e kudondodhur nëpër vepra masive apo parrulla e pllakata të ekspozuara publikisht, për t'u "ndriçuar" mendjen masava me zgjidhjet dhe direktivat gjeniale të tij. Cilësuar me të tilla attribute, padyshim që kthehen në zotër të popullit, në faraonë. Mund të veprojnë siç ua ka ënda, jo vetëm përmes indoktrinimit ideologjik, por edhe terrorit të ushtruar direkt apo indirekt nga strukturat e posaçme të organeve të sigurimit, edhe pse e cilësojnë veten e tyre si bij të dalë nga gjiri i veçjelisë popullore dhe që mendojnë e punojnë pareshtur për popullin, për të ashtuquajturin interes të përgjithshëm që, parë hollë, është interes i kulluar vetjak.

4) EKSPOZITI I MADHËSHTISË SË KOMB – SHTETIT DHE I KONTROLLIT TOTAL TË SHTETIT⁴

4. Ibid, fq. 193.

Deklamimi i madhështisë së komb – shtetit synonte që individi të ishte fund e krye i nënshtruar ndaj shtetit. Individi, jo vetëm që nuk mund të shprehte lirshëm mendimin e tij, por as që duhej të mendonte lirshëm, pasi çdo mendim apo ide që përshkonte mendjen e tij, do të duhej të ishte domosdoshmërisht në përputhje me fjalët dhe mendimet e udhëheqësit. Varësia tërësore e individit ndaj shtetit manifestohej përmes depersonalizimit të njeriut, jo vetëm për të mos qenë personalitet, por që të ishte levë në duart e shtetit. I ashtuquajturit shoqërizim i njeriut e nënshtroi këtë të fundit ndaj kolektivit, që gjithmonë ishte nën varësinë dhe kontrollin tërësor të shtetit. Çfarëdolloj forme mosbindjeje ndëshkohej. Frika nga ndëshkimet për hiçmosgjë, qoftë edhe për ndonjë shikim që drejtuesit mund t'i dukej i dyshimtë apo dhe për ndonjë ëndërr "kundërrevolucionare", e dëzoi njeriun, që groposi në thellësitë shpirtërore çdo mendim dhe ide që i binte ndesh ideologjisë sunduese. Njeriu, tjetër ishte dhe tjetër duhej të ishte, aq sa shpeshherë nuk arrinte të kuptonte se çfarë ishte në të vërtetë. Varësia dhe nënshtrimi tërësor i njeriut përkundrejt shtetit dhe të të ashtuquajturit interes i përgjithshëm synohej të arrihej përmes formimit të njeriut të ri, të rritur dhe edukuar jashtë vatrës familjare. Fillimisht çerdhja, pastaj kopshti, arsimit parauniversitar, arsimit i lartë, me konvikt ose jo dhe, së fundmi, në prodhim. Në të gjitha etapat e rritjes dhe edukimit të njeriut zbehet jashtëzakonisht shumë, për të mos thënë që zhduket tërësisht, familja dhe roli i saj qenësor në edukimin e njeriut si personalitet. Kështu formohet, sendërtohet "personaliteti" i njeriut të ri, i edukuar dhe i kalitur me parimet e ideologjisë sunduese në shërbim të të ashtuquajturit interes i përgjithshëm. Indoktrinimi ideologjik përmes dresurës së sistemit arsimor, skajshmërisht të politizuar, prodhonte individë që besonin totalisht dhe verbërisht në vërtetësinë e ideologjisë sunduese dhe vijës së diktuar nga udhëheqësi. Këta "personalitete" të përçudnuar ishin zëdhënësit, përcjellësit, ushtarët e bindur, të partisë – shtet që jetonin në simbiozë me njëri – tjetrin, pasi furnizoheshin nga partia dhe furnizonin parti-në me gjakun e nevojshëm për vazhdimësinë e

pushtetit. Duke qenë se individi, si personalitet dhe jo si makineri, qëndron në themel të shoqërisë, ndryshimi i individit, për mirë apo për keq, qëndron në themel të vetë ndryshimit, për mirë apo për keq. Nënshtrimi dhe zhbërja e individit si personalitet nënshtronte çdo detaj të jetës ndaj shtetit dhe e ekspozonte individin përkundrejt pamëshirshmërisë dhe egërsisë faraoniane të udhëheqësit. Kontrolli tërësor shtetëror mbi jetën e individit dhe shoqërisë përshfaqej edhe me ekzistencën e organizatave të ndryshme që i shërbenin plotësisht nomenklaturës së sistemit monist, në procesin e vazhdueshëm trushpëlarës dhe ngjizjes së indoktrinimit ideologjik tek individi dhe shoqëria. Përmes ekspozimit të madhësisë së komb – shtetit, individi si personalitet humbet, zhduket në humbëtorin ideologjik, madje dhe si siluetë, dhe tashmë nuk është as më shumë e as më pak sesa anëtari anonim i shoqërisë, kolektivit, njeriu masë, levë e pushtetit, me të cilin luhet sipas nevojave të shtetit, madje deri në sakrifikim të jetës, pasi kësaj të fundit iu mohua shenjtëria dhe paprekshmëria me të cilat zbret në botën e vdekatarëve.

5) TERRORI DHE FRIKËSIMI MASIV⁵

Garantimi i sigurisë së vazhdimit të pushtetit monist nuk mund të mendohej pa ekzistencën e strukturave të posaçme, që i shërbenin shtetit (udhëheqësit), për kontrollin total të shoqërisë, në mënyrë që çdo tentativë goditjeje ndaj shtetit të goditej që në embrion. Strukturat e shërbimit të sigurimit, pavarësisht emërtimeve të ndryshme në vende të ndryshme, kishin si qëllim që, përmes goditjes ndaj çdo rrezeje mendimi ndryshe, të ngjallnin frikën, jo vetëm ndaj masave të popullsisë, por edhe ndaj elementëve të lëkundur apo kundërshtues brenda vetë partisë. Ushtrimi i terrorit bëhej në mënyrë që askush të mos guxonte të ndërmerre ndonjë kuturisje kundërrevolucionare. Terrori i ushtruar në forma nga më të ndryshmet dhe brutale, dëshmonte për pakufizueshmërinë e ndërhyrjes së organeve shtetërore në jetët njerëzore. Këto ndërhyrje penetronin deri në botën e ëndrrave, pasi edhe këtë botë iracionale njeriu duhej t'ia përshtaste ideologjisë sunduese. Edhe


5. Ibid, fq. 193.

Etja dhe ambicja për pushtet dhe kontroll tërësor të çdo veprimi dhe fjale të mbllaçitur nga buzët e terrorizuara dhe plot frikë, i shtyu udhëheqësit drejt bishëzimit edhe me anëtarët më të afërt të familjes.



ëndrrat duhej të shiheshin me fitore revolucionarësh dhe shembje armiqsh të revolucionit, sikur ëndrrat mund të porositeshin me recetë. Për vazhdimësinë e ushtrimit të terrorit nga sadistët që drejtonin shtetin, ishte e nevojshme sajimi i vazhdueshëm i armiqve të klasës, tradhëtarëve të kombit, sabotatorëve që minonin "arritjet", "fitoret" e popullit nën udhëheqjen "e ndritur" të partisë – shtet. Ndëshkimi i elementëve të padëshirueshëm ushtrohej në forma të ndryshme. Ndër këto forma përmendim deklasimin, kulakëzimin, reaksionarizimin, internimin, burgosjen, punën e detyruar në kampe përqendrimi, dënimin kapital. Terrori psikologjik shoqëronte çdokënd, deri në vdekjen e gjithësecilit. Gjuetia e shtrigave përdorej dhe ushtrohej ndaj të pabindurve të çdolloj përkatësie; tesarist, pjesëtar i nomenklaturës dhe aparatit burokratik, intelektual, njeri i thjeshtë, mjaft që armiku të eliminohej dhe udhëheqja të "qetësohej" e "gëzohej", nga spastrimi i kundërrevolucionarëve që guxonin t'i preknin pushtetin. Etja dhe ambicja për pushtet dhe kontroll tërësor të çdo veprimi dhe fjale të mbllaçitur nga buzët e terrorizuara dhe plot frikë, i shtyu udhëheqësit drejt bishëzimit edhe me anëtarët më të afërt të familjes. Dyshtoj ndaj çdokujt, dyshim që do të shkakësonte implementimin e kontrollit dhe survejimit piramidial utilitarist të Bentamit, duke hamendësuar sigurinë dhe "qetësinë" e udhëheqjes, në mënyrë që të mendonte, të punonte i qetë, i pashqetësuar, për të marrë vendime të drejta dhe jo të gabuara për fatet e atdheut dhe të popullit.

Dhe së fundi përmendim: **"Ç'kemi bërë, kur e liruam këtë tokë nga drita e Tij? Në çfarë drejtimi lëvizet tani? Në ç'drejtim lëvizim ne?"**, Fridrih Niçe, "Legjenda e të çmendurit".



Trojet shqiptare dhe trashëgimia shtetformuese

Prof. dr. Selman Sheme

Hapësirat rajonale janë të shumëllojta, rrjedhë e kombinimeve të dy dimensioneve fizike e humane. Elementët fizikë e humanë të organizimit të territorit në hapësira të caktuara kanë një lloj uniformiteti dhe integrohen në nivele të ndryshme të ndërlihdjes. Rajonet historike janë krijuar përreth një ndërgjegjeje të përbashkët, uniteti gjeografik i të cilëve, është para së gjithash, një konstruktion mental (psikologjik, mendor). Manifestimet e sotme tregojnë se ka një vazhdimësi të ndjeshmërisë rajonale, produkt i jetës së përbashkët në një territor gjatë rrjedhave të historisë. Vetëdija ndaj trashëgimisë historike përbën bazën e një uniteti rajonal. Regjioni etnik shqiptar, për të ardhur në përfitimin e një kombi të konsoliduar, të zhvilluar, ka kaluar përmes një rruge historike etnokulturore tepër të gjatë. Kemi një zhvillim shkallë -shkallë ndër shekuj, por dhe kthime prapa për arsye të pushtimeve të ndryshme, pra për kushte historike tepër të vështira e të komplikuar. Një bashkim politik i qëndrueshëm i tërë hapësirës etnike nuk u bë asnjëherë, as në lashtësi, as në mesjetë, as në kohët moderne. Bashkimi politik i qëndrueshëm i etnisë, ndikon shumë në shpejtimin e proceseve etnike konverguese, në forcimin e faktorëve të lidhjeve ekonomike e etnokulturore mbarë-etnike në rrugën e një unifikimi

(njëjtësimi) të elementëve të ndryshëm etnik. Megjithatë, traditat shtetërore, ndonëse fragmentare, ve-tëm në një pjesë të caktuar të trojeve etnike e jo në mënyrë tërësore, tërë-etnike dhe jetëshkurtra, janë mjaft të hershme.

Në historinë e lashtë të Ballkanit, popujt më të njohur janë Ilirët, Grekët dhe Trakët. Ilirët, si trashëgimtarë të Pellazgëve janë ndër banorët më të vjetër të Gadishullit Ballkanik. Studimet arkeologjike të kryera në gjysmën e dytë të shekullit XX sjellin argumente bindëse se Ilirët janë autoktonë në Ballkanin Perëndimor. Në këtë hapësirë gjeografike, ilirët formuan kulturën, gjuhën dhe tiparet antropologjike, fakt të cilin e përmendin në veprat e tyre shkrimtarët antikë. Formimi i etnosit ilir përbën një proces të gjatë shumë-shekullor, i cili fillimin e ka në periudhën e bronzit të mesëm (vitet 1800-1500 pk) dhe vazhdon deri në periudhën e hekurit të hershëm (1100-500 pk), kur procesi i formimit etnik përfundoi plotësisht. Autoktonia ilire nënkupton formimin etnik në vend, mbi bazën e një vazhdimësie të gjerë kulturore, e cila ka pësuar ndryshimet e kohës, duke marrë edhe nga kultura e popujve fqinjë apo të ardhur, gjithnjë duke ruajtur tiparet e veta etnike. Trojet e shtrirjes së popullsisë ilire ishin mjaft të gjera. Ilirët banonin në të gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, që nga degët e

Danubit, lumenjtë Sava e Drava në veri e deri te gjiri i Ambrakisë në jug, kurse në lindje banonin edhe në Maqedoninë Perëndimore. Ashtu si popujt e tjerë, ilirët përbëheshin nga shumë fise të mëdha dhe të vogla. Fiset më të përmendura ilire ishin enkelejët, taulantët, ardianët, dardanët, paionët, dalmatët, albanët, molosët, thesprotët e të tjerë.

Fisi i Enkelejve banonte në krahinat përreth liqenit të Ohrit; i Taulantëve në ultësirën e bregdetit të Adriatikut. Në tokat e taulantëve përmenden më vonë fisi i albanëve dhe ai i parthinëve. Fisi i albanëve u dha emrin vetë shqiptarëve dhe Shqipërisë, gjatë mesjetës, kur ata njihen me emrat Arbër, Alban dhe Arbëri, Albani. Albanët banonin në prapatokën e qytetit të Durrësit. Kryeqendra e tyre ka qenë Albanopoli që mendohet të jetë Zgërdheshi i Krujës.

Ardianët shtriheshin në hapësirat përreth liqenit të Shkodrës.

Dardanët ishin ndër fiset më të mëdha e të fuqishme të Ballkanit Qendror. Ata shtriheshin në trevën e Kosovës e në krahinat përreth saj.

Pajonët banonin në luginën e sipërme të Vardarit, në kufi me dardanët dhe shtriheshin deri te lumi Struma. Dalmatët banonin në brigjet e Adriatikut të Mesëm.

Në shek. II p.k., në shkrimet e vjetra historike, përmendet fisi i oenestëve me banim në luginën e Drinit të Zi e përreth saj. Dihet se pjesë e etnosit ilir ishin edhe fiset epirote (epaieros = banorë të tokës, të steresë si të dalluar nga popullsitë ishullore të detit Jon). Epirotët shtriheshin nga Vjosa e deri në Ambraki e quheshin nga autorët grekë fise barbare, pra jogrekë. Për rrjedhojë, ata kishin përkatësi ilire. Këtë na e dëshmojnë si autorët grekë, ashtu edhe burimet arkeologjike. Albanologu i shquar Johann Georg Von Hahn, në studimet e tij, argumenton se, jo vetëm epirotët, por edhe maqedonësit e lashtë, ishin me afri etnike ilire. Një nga fiset kryesore të tokave të Epirit ka qenë ai i Molosëve me banim në qendër të Epirit antik. Molosët luajtën një rol kryesor si drejtues, në historinë e lindjes dhe formimit të shtetit të Epirit. Fisi epirot i kaonëve kishte një shtrirje të gjerë, që nga lumi Thyamis e deri në Gjirokastër, në luginën e Drinosit e malet e Vetëtimës, në afërsi të gjirit të Vlorës. Në pjesën jugore të Epirit banonte fisi i thesprotëve, që shtrihej në jug të lumit të sotëm Kallama, deri në gjirin e Ambrakisë (Prevezë).

Në shekullin V p.k. fillon krijimi i shteteve ilire. Mbretëria e parë ilire ishte ajo e enkelejve. Në vitin 335 p.k., në skenën politike të Ballkanit doli mbretëria ilire e taulantëve. Shteti ilir, gjatë mbretërimit të kësaj dinastie, siguroi një zhvillim të hovshëm të

ekonomisë dhe kulturës në të gjithë Ilirinë. Ekonomia qytetare ilire, pothuaj gjatë një shekulli, përjetoi një lulëzim të plotë.

Ndër qytetet kryesore ilire, që njohën një zhvillim të vrullshëm, ishin Damastioni, Bylisi, Albanopoli, Dimali, Skodra, Ulcini, Rizoni e të tjerë.

Në mesin e shek III p.k. u fuqizua fisi i ardianëve, i cili, me krijimin e dinastisë mbretërore të Agronit, përfshiu nën zotërimin e tij tokat, që më përpara u takonin taulantëve dhe enkelejve.

Në jug të mbretërisë së ardianëve, nga lumi Vjosa e deri në gjirin e Ambrakisë dhe, nga deti Jon deri në malet e Pindit, shtrihej shteti i Epirit. Ky shtet arriti kulmin e lulëzimit ekonomik dhe fuqinë politike e ushtarake në kohën e sundimit të Pirros. (307-272 p.k.).

Në territorin e sotëm të Kosovës dhe krahinat e tjera përreth saj, u krijua mbretëria dardane. Kufijtë e saj shkonin në veri deri në qytetin e Nishit, kurse në jug deri në Kukës dhe në rrjedhën e sipërme të Vardarit. Pas luftimesh të gjata me romakët, nga fundi i shek. I p.k., mbretëritë ilire e humbën pavarësinë e tyre dhe hynë në vartësinë e plotë të Romës. Romakët e ndanë Ilirinë në disa njësi administrative. Tokat në jug të Matit u përfshinë në provincën e Maqedonisë, kurse tokat ilire në veri të lumit të Matit e deri në Danub u përfshinë në provincën e Ilirikut.

Në shekujt që vijuan, romakët bënë ndarje të reja administrative, duke e ndarë Ilirinë në krahina të tjera më të vogla. Në shek. IV Iliria e jugut u nda në katër provinca:

- Prevalitana (me qendër në Shkodër)
- Dardania (me qendër Shkupin)
- Epiri i ri (me qendër Durrësin)
- Epiri i vjetër (me qendër Nikopojën)

Gjatë kësaj periudhe, Perandoria Romake u përfshi nga një krizë e thellë socialekonomike e politike dhe në vitin 395 u nda në dy pjesë: Perandoria Lindore dhe ajo Perëndimore. Me gjithë ndryshimet, efektet romanizuese të pushtimit romak, nuk arritën të shuanin traditat etnike vendase, për arsye kryesore se, kur u krye pushtimi i Ilirisë, ilirët kishin arritur një nivel të lartë kulturor e social.

Me ndarjen e Perandorisë Romake (395) në dy pjesë, viset ilire kaluan nën sundimin e Perandorisë Romake të Lindjes ose, siç u quajt ndryshe, Perandoria Bizantine, sipas emrit të lashtë të kryeqytetit të saj Bizantit (Kostandinopoja). Territorët e Ilirisë Jugore, nga pikëpamja administrative shtetërore, mbetën të ndara ashtu si më parë, në katër provinca. Viset ilire shënonin kufijtë më perëndimorë të Perandorisë Bizantine, duke luajtur një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërmjet lindjes dhe perëndimit.

Në perandorinë bizantine u përfshinë popuj të ndryshëm, si grekë, ilirë, thrakë, sirianë, armenë, egjiptianë e të tjerë.

Deri në shek. VII, gjuha latine vazhdoi të përdorej si gjuhë e administratës, pastaj gjuhë zyrtare e Perandorisë u bë gjuha greke. Ashtu si në treva të tjera të Ballkanit edhe në viset ilire, gjatë shek. V-VI u dyndën fise barbare, si gotët, hunët, vandalët, avarët e, në fund, sllavët. Ndryshe nga dyndja e popujve të tjerë, të cilët nuk u vendosën në Gadishullin e Ballkanit, por vetëm kaluan përmes tij, dyndjet sllave u shoqëruan me kolonizimin sllav. Perandoria Bizantine u detyrua të lejonte vendosjen e sllavëve në vise të ndryshme të Ballkanit. Kjo sollti ndryshime të mëdha etnike.

Sllavët u vendosën në masë, sidomos në viset e Ilirisë Veriore, d.m.th. në viset e sotme të Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë, Bosnjë- Hercegovinës, të Malit të Zi dhe Maqedonisë. Asnjë burim historik i shek. VII nuk flet për vendosjen e sllavëve në Dardani, në Epirin e Ri apo në Epirin e Vjetër. Në këtë mënyrë, popullsia autoktone ilire u ruajt në Shqipërinë e Sipërme (Provinca e Prevalit) në Kosovë (Dardani), në Shqipërinë Qendrore (Epiri i ri), në Shqipërinë Lindore (Maqedonia e sotme Perëndimore) dhe në Shqipërinë e Poshtme (Epiri i vjetër).

Ndonëse popullsia e vjetër ilire mbijetoi duke u bërë ballë sundimeve të huaja romake, bizantine dhe dyndjes së popujve, emri i saj i mëparshëm ilir dhe i vendit të saj Iliri, u zëvendësuan përkatësisht me emrat e rinj arbër dhe Arbëri. Këta emra të hershëm të shqiptarëve dhe Shqipërisë e kanë origjinën nga fisi ilir i Albanëve, i cili banonte në viset midis Durrësit dhe Dibrës dhe përmendet nga gjeografi i shek. II, Ptolemeu. Ky emër u shtri edhe në popullsinë shqiptare të trevave të tjera, që më parë emërohej sipas emrave të krahinave e të qyteteve.

Gjatë mesjetës, trevat shqiptare fillonin nga gryka e Kotorrit në veri e vazhdonin deri në gjirin e Artës në jug. Të gjitha së bashku u përfshinë nën emrin ARBËRIA (ALBANIA). Lidhjet e shqiptarëve të mesjetës së hershme me ilirët dhe vazhdimësia iliro-shqiptare, tashmë është provuar nga shkencat arkeologjike, gjuhësore, etnografike, antropologjike, historike e të tjera.

Në shek. XII-XIV, Shqipëria njohu ndryshime të reja politike dhe u kthye në një shesh luftimesh ndërmjet ushtrive anzuine, serbe dhe bizantine. Duke përfutur nga këto luftra, në shek. XIV shteti serb pushtoi pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik. Megjithatë procesi i kolonizimit serb në tokat shqiptare e, sidomos në Kosovë, mori përpjesëtime të gjera, popullsia shqiptare i bëri ballë këtij presioni dhe vazh-

doi të qëndronte në trojet e veta etnike.

Në shek. XIV principatat shqiptare të topiajve (me qendër në Durrës), balshajve (me qendër në Shkodër), muzakajve, zenepishtëve dhe e Artës, në rrugën e tyre të zhvillimit dhe emancipimit, e ngritën në një shkallë më të lartë traditën shtetërore në Shqipëri.

Në shek. XV Shqipëria u pushtua nga turqit osmanë. Pas vitit 1443, nën udhëheqjen e Skënderbeut, principatat shqiptare u bashkuan për të luftuar okupatorin. Skënderbeu formoi shtetin feudal shqiptar të unifikuar. Pas vdekjes së Skënderbeut, turqit e pushtuan Shqipërinë. Ky pushtim zgjati pesë shekuj me radhë.

Pushtimi i gjatë turk nuk arriti të ndryshojë strukturën etnike të popullsisë shqiptare, por luftrat e vazhdueshme dhe emigracioni, ia ngadalësuan asaj ritmet e rritjes.

Krahas vendosjes së sundimit osman, në Shqipëri ecën edhe proceset e kolonizimit dhe të islamizimit. Islamizimi luajti një rol pozitiv në rajonet kufitare të trojeve shqiptare, si në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore e në Çamëri. Duke përqafuar fenë islame, shqiptarët e atyre zonave ruajtën karakterin etnik ndaj sllavizimit, serbizimit e greqizimit (helenizimit).

Në vitet 80 të shek. XIX, hapësira etnike shqiptare u nda në katër vilajete: i Shkodrës, i Kosovës, i Manastirit dhe i Janinës. Këto njësi administrative mbetën pothuajse të pandryshueshme deri në shpalljen e pavarësisë.

Në mesin e shekullit XIX, hapësira etnike shqiptare zinte një sipërfaqe prej 75.000 km².

Në të katër vilajetet banonin rreth 1.700.000 banorë, kurse në 1912, afërsisht 2.354.000 banorë.

Vendi i popullsisë shqiptare në këto vilajete ishte si më poshtë:

Nr.	Vilajete	Popullsia	Pop. Shqiptare	%
1.	Kosovë	909.700	558.900	61.4
2.	Manastir	694.800	275.900	54.1
3.	Janinë	559.700	330.800	59.1
4.	Shkodër	190.000	186.500	98.2
5.	Gjithsej	2.354.200	1.452.100	61.7

Nga 2.354.000 banorë, 61.7% ishin shqiptarë, 13.5% ishin maqedonas, 7.3% grekë, 6.9% serbë, 5.3% turq, 5.4% vllahë dhe 0.1% të ndryshëm.

Cilat janë trojet e shqiptarëve?

Ç'quajmë troje shqiptare?

Cili është ndryshimi mes kufijve etnikë e atyre politikë?

Troje shqiptare quhet tërësia e vendeve e krahina-ve që banohen në mënyrë masive nga shqiptarët, po ajo hapësirë gjeografike që ka qenë e banuar nga paraardhësit e shqiptarëve, arbrit mesjetarë e, më parë, nga ilirët e iliro – epirotët. Vendet ku popullsia arbnore ka qenë asimiluar nga popujt e tjerë që në mesjetë, nuk quhen troje shqiptare.

Trojet shqiptare kanë ardhur duke u ngushtuar nga koha në kohë. Në fillim të viteve '70 të shek. XIX, në qarkun e Nishit krahinë e Toplicës, që shkon nga Nishi e deri në Kurshumli, ka qenë banuar në mënyrë masive nga shqiptarët. Po në vitin 1875-1878 Serbia i ka masakruar dhe dëbuar nga trojet e tyre në këtë krahinë rreth 350.000 shqiptarë, duke u shkatërruar të gjitha xhamitë, teqetë dhe varrezat e tyre.

Ky territor i shpopulluar nga shqiptarët ka qenë më i madh se Kosova. Serbët, më parë, aty ishin minoritet. Me shpërnguljen me forcë të shqiptarëve, u ripo-pullua në mënyrë masive nga serbët.

Procese të tilla ka pasur edhe në jug të vendit, ku Greqia, në mënyrë sistematike, në kuadrin e programit politik të megallo – idesë, ka synuar shpopullimin dhe asimilimin e Çamërisë (Epirit të jugut) dhe push-timin e Vorio Epirit (Korçën dhe Gjirokastrën).

Troje shqiptare quhen edhe rajonet gjeografikë, ku popullsi joshqiptare ka imigruar në gji të popu-llit shqiptar. Dropulli i Gjirokastrës e Vurgu i Delvinës janë troje shqiptare dhe pakicat greke kanë ardhur si bujq rreth dy shekuj më parë.

Trojet shqiptare të sotme fillojnë që nga kepi i Spi-cës në veri të Tivarit e deri në gjirin e Artës në Çamë-ri. Nga 75.000 km² të trojeve etnike, në Republikën e Shqipërisë përfshihen vetëm 28.748 km². Trojet shqiptare, që ndodhen në Mal të Zi, janë Kuçi, Kraja, Anamali, Ulqini, Hoti dhe Gruda, Plava e Gucia.

Dallohet për homogjenitetin etnik shqiptar Kosova me mbi 90% të popullsisë shqiptare. Troje shqiptare janë Bujanovici, Presheva dhe Metvegja (sot nën su-ndimin serb).

Në rrjedhë të shekujve e deri sot, viset e Maqedoni-së banohen nga shqiptarët.

Perëndimore: Tetova, Gostivari, Kërçova, Dibra, Struga, Kumanova, Manastiri, Prespa e të tjera. Këto troje shqiptare sot janë në shtetin maqedon. Krahi-nat e Janinës, Kosturit, Follorinës e të tjera kanë qenë të banuara në mënyrë masive nga shqiptarë. Në gjys-mën e parë të shek. XX, shqiptarët janë dëbuar me forcë nga trojet e tyre (elementë myslimanë) ose janë drejt shpërbërjes (elementë ortodoksë), në mungesë të të drejtave për të zhvilluar traditat e tyre, kulturën shqiptare, në mungesë të shkollave shqipe. Pas vitit 1912 janë dëbuar me forcë nga Kosturi dhe Follorina

35.000 shqiptarë.

Trojet në jug të Vurgut të Delvinës e të Vrinës e deri në gjirin e Artës, përbëjnë viset shqiptare të krahinës së Çamërisë. Deri në vitin 1912 Çamëria ishte nën ju-ridiksionin e vilajetit të Janinës. Pas shpalljes së pava-rësisë (1912), kufijtë e shtetit të ri shqiptar u përcak-tuan në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në 1913. Në bazë të vendimeve të kësaj konference, një rrip verior i Çamërisë mbeti brenda kufijve të shtetit shqiptar. Në kohën e monarkisë së mbretit Zog, në këtë zonë u krijua një njësi e vetme administrative që u quajt "Nënprefektura e Çamërisë". Me vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve (1913), pjesa më e madhe e sipërfaqes së Çamërisë, rrethet e Filatit, Gumenicës, Margellicit, Prevezës, Artës e të tjerë, mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Kjo krahinë iu aneksua Greqisë.

Me vendimet që mori Konferenca e Ambasad-o-rëve në Londër më 29 korrik 1913, territoret etnike shqiptare u copëtuan në katër pjesë, nga të cilat, më pak se gjysma u përfshi në kufijtë politikë të shtetit shqiptar, ndërsa tri pjesët e tjera, ndonëse me po-pullsi kryesisht myslimane, u aneksuan nga monarki-të e krishtera, nga Serbia, Greqia e Mali i Zi. Me këto vendime, parimi i së drejtës kombëtare, i trumbetuar nga Fuqitë e Mëdha gjatë shek. XIX, u shkel. Platfor-ma e rilindasve frymëzoi Kuvendin e Vlorës (1912), i cili i dha shtetit Shqiptar, që në lindjen e vet, karakter demokratik laik dhe iluminist. Formimi i shtetit të pa-varur shqiptar krijoi premisën për realizimin në të ar-dhmen, të programit madhor të Rilindjes Kombëtare për bashkim kombëtar.


Pas afro 100 vitesh të shtetit të pavarur shqiptar, pa-raqitja, përpunimi dhe zbatimi i një platforme mba-rëshqiptare, mbetet një detyrë ende e paplotësuar.

Nga pikëpamja gjeografike, njësia mbarëshqiptare do të përfshinte trojet e mëposhtme:

- a. Republikën e Shqipërisë në kufijtë e sotëm.
- b. Republikën e Kosovës në kufijtë e sotëm.
- c. Çamërinë dhe trojet e tjera shqiptare në Greqi.
- d. Trojet shqiptare në Maqedoninë Perëndimore.
- e. Trojet shqiptare në Mal të Zi (Ulqini, Hoti, Gruda, Plava, Gucia, Rozhaja etj.)
- f. Trojet shqiptare në Serbinë Jugore (Preshevë, Bu-janovsk, Medvegjë).

Një Shqipëri e së ardhmes, me një trung të plotë e të përcaktuar, përafërsisht në pesëkëndëshin, Ulqin - Podujevë - Preshevë - Strugë - Prevezë do të kishte kushte të mjaftueshme për begati ekonomike, për-parim shoqëror e qëndrueshmëri politike.

Rrjedhimisht, ky vend do të kthehej në një faktor paqeje dhe stabiliteti në Ballkan e më gjerë.



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Përmende Zotin tënd me vete, i përulur dhe me frikë; jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!” (A'raf, 205)

Ky ajet ka zbritur në Meke para natës së miraxhit, në të cilën namazi është bërë obligim. Allahu na mëson mënyrën e dhikrit, pra përmendjen e Tij. Por qëllimi kryesor i ajetit është nxitja e besimtarëve në përmendjen e Allahut dhe tërheqja e vëmendjes për të mos u bërë neglizhentë, indiferentë dhe të pakujdesshëm në raport me krijuesin e tyre.

Dhikri i përmendur në këtë ajet nuk nënkupton dhikrin që bëhet vetëm me gojë, por dhikri që realizohet nëpërmjet gjuhës, zemrës dhe shpirtit. Nëse gjatë dhikrit nuk dridhet zemra, nuk zgjohet ndërgjegjja dhe nuk shoqërohet me ndjesinë e modestisë dhe përgjërimit, nuk mund të quhet dhikër. Përkundrazi, kjo është një gjendje hutimi karshi Allahut. Sepse dhikri është sjellja vazhdimisht ndërmend e madhësisë së Allahut, duke iu drejtuar me përgjërimit dhe devotshmëri dhe të jetuarit në çdo moment dhe çdo situatë me vetëdijen e plotë se je nën mbikëqyrjen e Tij. Kjo gjendje e zemrës pasqyrohet nëpërmjet gjuhës, e cila e shoqëron me një zë të lehtë që nuk e prish qetësinë e dhikrit.

Në mëngjes dhe në mbrëmje

Me dhikrin në agim dhe në aksham, zemra lidhet me të dyja skajet kohore të ditës. Natyrisht që përmendja e Allahut nuk është e kufizuar vetëm me këto dy kohë. Përmendja e Allahut duhet ndier në zemër në çdo moment dhe situatë, por theksimi në veçanti i këtyre dy kohëve, është për shkak të ndikimit që kanë këto dy kohë në zemrën e njeriut. Në agim dhe aksham njeriu vëren një ndryshim të qartë, ndjen fuqinë e Allahut në shndërrimin e errësirës në dritë dhe anasjelltas. Allahu e di shumë mirë se zemra e njeriut është shumë më e gatshme të ndikohet në këto dy segmente kohore. Prandaj tërhiqet vëmendja e bërjes së dhikrit, veçanërisht në këto kohë.

Dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje.

Pra mos e neglizho dhikrin ndaj Allahut, sepse kjo sjell shkëputjen e lidhjes që ekziston ndërmjet teje dhe Atij, shkëputje e cila sjell me vete gjendje letargjie dhe përhumbje të plotë ndaj argumenteve të qartë të Allahut të madhërishtëm.

Një Hadith

Ebu Musa el-Esh'arij, transmeton se Resulullahi (s.a.o.s.) ka thënë:



“Shembulli i atij që përmend Allahun e lartësuar dhe atij që nuk e përmend, është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit.”

Pejgamberi (a.s.), e ka përngjasuar gjendjen e besimtarit që i shkëlqen zemra nga përmendja e Allahut, me trupin e shëndetshëm, nëpër damarët e të cilit qarkullon gjak, kurse gjendjen e atij që është neglizhent ndaj përmendjes së Allahut, me të vdekurin që nuk lëviz. Nga ky hadith kuptojmë që dhikri është i domosdoshëm për njeriun, ashtu siç është i domosdoshëm uji për peshkun. Zemra e besimtarit njomet, qetësohet me anë të dhikrit. Këtë fakt e përforcon edhe ajeti kuranor, ku Allahu thotë: **“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Ra’d)

Dhikri ndahet në tre lloje: artikulum me gjuhë, që nënkupton shqiptimin e fjalëve të caktuara që përmbajnë madhërim, falënderim dhe lartësim të Allahut. Përmendje me zemër, që nënkupton kontemplimin rreth krijesave të Allahut, që të depërtojë në kuptimin e tyre dhe të thellohet në fshehtësitë që mbajnë ato dhe, përmendja me trup, që konsiston në kryerjen e akteve, sipas përcaktimit të Allahut. Çdo vepër, që i shërben përmbushjes së qëllimit për të cilin është krijuar njeriu, është dhikër. Ibadeti i njeriut ndaj Allahut të madhërishëm realizohet në forma të ndryshme. Njëra nga këto forma, që arrin ta mbajë të fortë lidhjen e njeriut me Allahun, është dhikri. Madje, mund të themi që, të gjitha adhurimet janë pjesë e dhikrit; çdo veprim gjatë namazit shoqërohet me dhikër. Dobitë e dhikrit janë të shumta, ndër të cilat mund të përmendim: nëpërmjet dhikrit fitohet kënaqësia e Allahut, dëbohet shejtani, largohen brengat, vuajtjet dhe hidhërimet, kurse zemrën e përfshin gëzimi dhe lumturia. Të përmendurit e Allahut forcon zemrën dhe trupin. Të kujtuarit e Allahut pakëson dhe shlyen mëkatet. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: **“Kush deklaroi brenda një nate dhe dite: Subhanallahi ve bi hamdihi (Allahu qoftë madhëruar dhe lëvduar) njëqind herë, do t’i falen mëkatet, madje, edhe nëse janë shumë, sa shkuma e detit”**. Kush braktis dhikrin, është i destinuar të bëjë një jetë të vështirë dhe të trishtuar **“kushdo që lë pas dore dhikrin, do të ketë jetë të vështirë e të vuajtur...”** (taha 124) Të harrosh Krijuesin, do të thotë të harrosh veten, të humbësh lidhjen me jetën, të biesh në përhumbje të plotë ndaj çdo gjëje që të rrethon.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Zemra që nuk përmend Allahun, është si organ i vdekur.
2. Duhet t’i gjallërojmë zemrat dhe shtëpitë, duke përmendur Allahun vazhdimisht.



DISIPLINA E DHURIMIT

Nëse do t'i hedhim një vështrim thelbit dhe qëllimit të tasavvufit, do të vërejmë se mjeti me të cilin ai realizon zhvillimin shpirtëror, është "dashuria", ndërsa majën e këtij zhvillimi e realizon me "disipilinë (edukatë)". Besimtari, aq sa ka arritur ta qendërojë në shpirtin e tij Allahun dhe të Dërguarin e Tij, aq hapa ka hedhur drejt afrimit me Krijuesin. Ndërsa shenja më e dukshme e kësaj arritjeje është të pajisurit e tij me moralin e Profetit.

Thelbin e moralit profetik e përbën "**ndjenja e turpit**". Sipas sahabëve, Hazreti Pejgamberi, alejhis-salatu ves-selam, ishte më i turpshëm se një vajzë e virgjër që fshihet në mbulesën e saj. Për të shprehur edukatën që natyrshëm zotëronte, ai ka thënë: "*Mua më ka edukuar Zoti dhe edukatën time e ka bërë më të lartën.*" (Sujuti, *el-Xhamiu's-Sagir*, I, 12)

Në lidhje me moralin dhe edukatën, që përbën edhe pikën më të lartë të virtytit njerëzor, Mevlana ka thënë:

"Nëse do t'i shtypësh kokën djallit, hap sytë dhe shih mirë; ajo gjë që e shkatërron shejtanin është edukata. Nëse njeriu nuk ka edukatë e moral, me të vërtetë ai nuk është njeri..."


Mendja ime pyeti zemrën: «Çfarë është imani (besimi)?». Zemra i tha mendjes në vesh: «Imani (besimi) është edukata, morali i lartë.»

Edukata që përbën thelbin e besimit është një gjendje që rrok çdo etapë të jetës së besimtarit. Në mënyrë të veçantë, jetën e tij të adhurimit dhe të veprimit (muamelat)... Allahu i Lartmadhëruar është shprehur qartë, kur thotë se qenien njerëzore e ka krijuar vetëm e vetëm për ta adhuruar Atë. Për këtë arsye, adhurimet dhe veprimet (muamelat) janë zemra e shprehjes sonë të robërisë ndaj Tij. Nuk mund të mendohet një jetë kushtuar robërisë ndaj Zotit, pa adhurime dhe pa maturi në veprime (muamelat).

Sa ç'ka rëndësi kryerja e çdo obligimi fetar, po aq rëndësi ka cilësia e kryerjes së tij. Të kujdesurit për rregullat e edukatës (disiplinës) gjatë adhurimeve dhe gjatë aplikimit të rregullave të shëriatit, përbën kushtin kryesor të dashurisë dhe pëlqimit të Hakut. Për këtë arsye, nëse adhurimet kryhen gati si për inerci dhe për forcë zakoni e, jo sipas rregullave dhe mënyrave të caktuara, prej tyre nuk fitohet asnjë sevap ose nuk përftohet asnjë mirësi. Atij, që detyrimet fetare i kryen në këtë formë, i mbetet vetëm lodhja e stërmundimi i kotë. Në një hadith thuhet:

"Sa shumë agjërues ka, agjërimi i të cilëve është vetëm uri! Sa shumë ka prej atyre që falen natën e që namazi i natës së tyre është vetëm pagjumësi!" (Ibn-i Maxhe, Sijam, 21)

Siç ka namazi kushtet e tij të jashtme e të brendshme, ashtu ka rregullat e tij zekati, sade-



kaja dhe dhurimi për hir të Allahut. Bashkësia e këtyre rregullave përbën edukatën, disiplinën e zekatit, sadekasë dhe infakut (dhurimit), të cilat duhen ndjekur me përpikmëri. Përndryshe, ashtu siç thuhet në Kuran për përfundimin e keq të atyre që falin namazin të hutuar e të pavetëdijshëm **“Mjerë për ata, të cilët falen...”** (el-Mâûn, 4), të njëjtin fund do të kenë edhe ata që janë të pakujdesshëm gjatë kryerjes së adhurimit të dhurimit.

MOS I ÇONI DËM DHURIMET DHE LËMOSHAT TUAJA!...

Allahu i Lartmadhëruar, në lidhje me kujdesin që duhet shfaqur kur dhurojmë, ka thënë:

“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.

Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë (nuk nxiton në dënime).

O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit!..” (el-Bakara, 262-264)



“Sa shumë agjërues ka, agjërimi i të cilëve është vetëm uri! Sa shumë ka prej atyre që falen natën e që namazi i natës së tyre është vetëm pagjumësi!”

(Ibn-i Maxhe, Sijam, 21)

Në ajetet e mësipërme, Allahu i Lartmadhëruar e shpjegon në mënyrë të qartë edukatën që duhet të ndjekim kur bëjmë ndonjë të mirë. Tek Allahu i Lartmadhëruar nuk ka asnjë vlerë ajo mirësi që bëhet duke e përçmuar nevojtarin, duke e vënë në siklet dhe duke ia përmendur të mirën që i është bërë. Kështu, ata që japin dhe ndihmojnë pa dashuri e zemër të pastër, i zhdukin të gjitha sevapet e ndihmesave të tyre!..

Dhurimi, bujaria dhe mirësia, kur përmenden, jo vetëm që shkojnë dëm, por sjellin edhe dënimin e Allahut të Lartmadhëruar. Njëherë, Hazreti Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sellem, ka theksuar tri herë këtë hadith:

- Ekzistojnë tre persona me të cilët, nuk do të flitet në Ditën e Kiametit. Atyre nuk do t’u hidhet fare shikimi dhe ata nuk do të pastrohen nga mëkatet. Për ta ka një dënim të dhembshëm.

Ebu Dherr, radijallahu anhu, ka vijuar:

-U shofshin emrat e tyre, mos e arritshin kurrë atë që shpresojnë dhe dënimi i kaploftë! Kush janë këta që sapo përmende, o i Dërguari i Allahut?

Hazreti Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sellem, i është përgjigjur:

-Ai që (me mendjemadhësi) e zvarrit rrobën për tokë, ai që betohet duke gënjyer, për ta shitur mallin e tij dhe ai që ia përmend dikujt të mirat (të dhuruarat, lëmoshat etj), për ta ulur e përcmuar atë.” (Myslim, Iman, 171)

Dhurimet e lëmoshat, të cilat përmenden më vonë e që janë dhënë sa për sy e faqe, në vend që të bëhen sevape, sepse janë vepra të pëlqyeshme, bëhen gjynahe, duke sjellë dënime e vuajtje. Zemrat janë vendi ku Allahu i Lartmadhëruar hedh shikimin. Prandaj nuk bën që të thyhen dhe të shqetësohen...

Zekati dhe lëmoshat janë përcaktuar nga Allahu i Lartmadhëruar, prandaj themi që nga pasuria e të kamurve, ato janë e drejta (haku) e natyrshme e çdo të varfëri. T’u japësh hakun të varfërve nga pasuria që të është dhuruar nga Allahu i Lartmadhëruar, nuk është ndonjë mirësi e madhe, por është thjesht dorëzimi i asaj që i takon merituesit. Pasuria e kësaj bote është një amanet hyjnor. Prej se Zoti të ka zgjedhur ty për t’i dhënë robit të Tij nevojtar nga mirësitë e Tij, ti tregon një gjendje hutimi, indiference dhe injorance, po të biesh në kurthet e nefsit e të japësh sa për sy e faqe një gjë që do të të shërbente më shumë si argument përmendjeje në të ardhmen, sesa sinqeriteti e vetëdijeje.

Në dhurim nuk duhet të krenohemi. Nuk duhet ta përcmojmë nevojtarin, por duhet të mendojmë se një ditë edhe ne mund të biem në gjendjen e tij. Pasuria ose varfëria, edhe pse lidhet pak me përpjekjen e njeriut, tekefundit është rrisht. Allahu i Lartmadhëruar mund ta bëjë të pasurin të varfër dhe të varfërin të pasur. Tek Allahu i Lartmadhëruar, këto nuk janë parametra vlerësimi ose nënvlerësimi. Të dyja gjendjet, si pasuria ashtu edhe varfëria, janë forma sprovimi, që lidhen me jetën e kësaj bote. Epërsia ose vlerat e vërteta lidhen me takvanë (devotshmërinë). Të krenohesh përballë nevojtarëve me atë që ke, gjoja duke e dhuruar atë, tregon nivelin tënd të pavetëdijes, në lidhje me sekretin e qenies së kësaj bote vetëm një provë. Shejh Saadiu, në veprën e tij *Gjylistani dhe Bostani*, është shprehur:

“Kur t’i bësh mirë ndonjë njeriu, mos u mburr,



duke thënë: «Unë jam zotëri, ndërsa ai ma ka nevojën mua!» Mos thuaj që koha e ka goditur atë! Shpata që godet akoma nuk ka hyrë në këllëf. Mundet që një ditë, shpata në fjalë të të godasë edhe ty.”

Të kamurit duhet të dinë të vendosin veten në vendin e fukarenjve dhe të mund të mendojnë kështu: *“Allahu i Lartmadhëruar mund të na krijonte në gjendjen e tyre, ndërsa ata në gjendjen tonë. Ai na i la amanet të varfërit duke na dhuruar të mira materiale. Ai ka dashur që të varfërit t’i strehojë tek të pasurit, na ka bërë përgjegjës për ta dhe ka urdhëruar që t’i shprehim Atij falënderimet tona, duke u dhuruar atyre prej të mirave që vetë Ai na i ka besuar...”*

Sa kuptimplote këshilla që Shejh Saadiu na ka dhënë në të njëjtën vepër:

“Nëse të troket ndonjë hallexhi në derë, mos e nis atë duarbosh! Larg qoftë, ndoshta një ditë bëhesh ti vetë i tillë, e detyrohesh të trokasësh derë më derë.

Intersohu për zemërthyerit, kujdesu sa të mundesh për ta! Ndoshta një ditë edhe ti do të biesh në gjendjen e tyre.

Ti që nuk ke nevojë të dalësh derë më derë për të lypur, falëndero, duke mos kthyer asnjërin prej tyre duarbosh! Mos ua rrudh fytyrën atyre, por honepsi ata me buzëqeshje...”

Në Kuran thuhet:

“A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt? Prandaj, mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shty me ashpërsi dhe shpalli

*“Dhuro nga pasuria jote
ashtu siç duhet, fito më mirë
një zemër! E kështu, dua (lutja)
e asaj zemre do të japë ty dritë
në jetën e varrit
në atë natë aq të frikshme
e të zezë!..”*



dhuntitë e Zotit tënd!” (ed-Duha, 8-11)

Mirësjellja ndaj nevojtarëve duhet shprehur duke mos ua përmendur të mirat që u ke bërë, duke mos i bërë të ndihen keq dhe duke i harruar menjëherë të mirat që u ke bërë. Sa bukur shprehet Llokman Hakimi:

“Mos harro dy gjëra: Allahun e Lartmadhëruar dhe vdekjen.

Ndërsa këto dy gjëra harroji menjëherë: Të mirat që i ke bërë ndokujt dhe të keqen që të ka bërë ndokush.”

Të arrish të jesh nga besimtarët dhurues, është një mirësi që të fal qetësi, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Për ata që e kryejnë siç duhet adhurimin e dhurimit, Allahu i Lartmadhëruar ka paralajmëruar shpëtim nga dëshpërimi dhe frika në momentet aq të vështira të Kijame-tit. Në qindra ajete kuranore, i Plotmëshirshmi, por edhe Hazreti Muhamedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që dridhej nga dhembshuria për umetin e tij, në shumë hadithe, na nxisin që të arrijmë të përjetojmë lumturinë dhe qetësinë e dhurimit, nga ajo që zotërojmë në mënyrë të përkohshme.

Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar, në lidhje me dhurimin për hir të Tij, mirësi kjo, vlera e së cilës në mënyrë të plotë do të kuptohet në botën e amshuar, na tërheq vëmendjen që të mos e çojmë dëm me veprime të pamatura e injorante, duke u shprehur **“Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja!”**

Besimtari është njeri **bujar**. Bujaria e vërtetë është të dhuruarit me plot shpirt, pa t’u dridhur qerpiku, pa t’u dridhur dora, me rehatinë e na-

tyrshmërinë e shiut që bie nga qielli. Mirësitë për të pasur vlerë tek Allahu i Lartmadhëruar, duhet të bëhen në mënyrë aq të natyrshme e pa hasur ndonjë vështirësi të brendshme, siç sillen natyrshëm lulet me aromën e tyre të këndshme në mjedisin ku gjallojnë!..Vetëm dhurimet e tilla arrijnë tek Allahu i Lartmadhëruar. Tekefundit, në një ajet kuranor thuhet **“Allahu është Ai që i merr sadekat (lëmoshat, bamirësitë)”** (et-Tevbe, 104)

Hazreti Mevlana e shpreh kështu mirësinë e të dhuruarit për hatër të Zotit:

“Dhuro nga pasuria jote ashtu siç duhet, fito më mirë një zemër! E kështu, dua (lutja) e asaj zemre do të japë ty dritë në jetën e varrit, në atë natë aq të frikshme e të zezë!..”

Ashtu siç nuk duhet ta shtrëngojmë pasurinë tonë dhe mundësitë tona ndaj nevojtarëve, nuk duhet ta kursejmë as buzëqeshjen dhe mirësjelljen ndaj tyre.

TË DHUROSH PËR TË SHLYER BORXHIN E FALËNDERIMIT

Mirësjellja dhe disiplina islame të shpie në perceptimin e aftësisë për të dhuruar, si mirësi në vetvete. Ai që jep duhet ta falënderojë shumë atë që merr, sepse ky i fundit, bëhet shkak që dhënësi të fitojë sevape e mirësi të mëdha. Në një ajet kuranor thuhet:

“..Çfarëdo të mire që të jepni, është në dobinë tuaj, nëse ju këtë e bëni vetëm për hir të Allahut! Çfarëdo që të jepni nga të mirat, do t’ju rikthehet e plotë dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.” (el-Bakara, 272)

Kur bëhet ndonjë mirësi, sevapi dhe qetësia i takon atij që e ka kryer atë. Shpërblimi do të bëhet në raport me sinqeritetin që është përjetuar gjatë aktit të bamirësisë. Kur diçka dhurohet për hir të Allahut të Lartmadhëruar, duket sikur po përfiton marrësi, por në të vërtetë, nga ajo ve-për përfiton më shumë dhënësi. Për këtë, ai që dhuron, nuk duhet ta ngarkojë atë që merr me detyrimin e mirënjohjes, por të përjetojë vetë mirënjohje ndaj personit që po i dhuron diçka. Shabiu ka thënë:

“Një të pasuri, që nuk mendon se, më shumë ka

nevojë ai vetë për sevapin e sadesë, sesa i varfëri për lëmoshën e tij, nuk i pranohet dhurimi.”

Ka shumë njerëz që bëjnë mirësi për interesa të kësaj bote, duke e vënë në siklet dhe duke ia përmendur atë mirësi tjetrit. Ata që janë të vetëdijshëm për vlerën e dhurimit, për hir të Allahut, janë krejt pak. Njeriu duhet të falënderojë fort Allahun e Lartmadhëruar për mundësinë që i ka dhënë për të dhuruar për hir të Tij e, për këtë, duhet t’i jetë shumë mirënjohës nevojtarit, pa të cilin ky adhurim nuk do të kryhej dot.

Shejh Saadiu, në lidhje me temën në fjalë, ka thënë:

“Falëndero Allahun e Lartmadhëruar që të ka dhënë mundësinë të bësh mirë! Allahu nuk të la ty pa mirësitë e Tij. Ai që i shërben Padishahut, nuk mundet ta ngarkjë atë me detyrimin e mirënjohjes. Të duhet ty të jesh mirënjohës, për arsye se ai ta besoi ty shërbimin ndaj tij.”

Hazreti Mevlana, në vargjet e tij të famshme, ka thënë:

“Nevojtarët janë pasqyra e të pasurve. Mos i thuaj kurrë asaj fjalë fyese, që thyejnë zemrën, në mënyrë që ajo të mos vishet me avull.”

“Ashtu siç ka nevojë një i varfër për bujari dhe mirësi, ashtu edhe një bujar dhe mirëbërës ka nevojë për të varfërin. Ashtu si kërkojnë të bukurat pasqyrë të pastër, të pandryshkur dhe të shndritshme, për të vëzhguar bukurinë e tyre, ashtu edhe të pasurit, me atë dëshirë e përpjekje duhet të kërkojnë të varfërit e nevojtarët.”

“Të varfërit janë krijesat ku manifestohen cilësitë e të qenit bujar të Zotit. Ata të varfër, të cilët kërkojnë prej njerëzve bujarë e të ndershëm dhe u hapin zemrën atyre, duke ua treguar të gjitha hallet.”

Nëse një nevojtar vjen tek ne dhe na e beson hallin, duhet kuptuar si një mirësi nga Allahu i Lartmadhëruar dhe si një nder robërie ndaj Tij. Sa bukur e shpreh Hazreti Aliu, radijallahu anhu, këtë të vërtetë:

“Dy gjëra më lumturojnë më së shumti, por nuk e di se cila më shumë se tjetra. E para, kur një njeri vjen tek unë dhe ma beson hallin e tij, me plot sinqeritet. Ndërsa e dyta, kur Allahu i Lartmadhëruar

“Nevojtarët janë pasqyra e të pasurve. Mos i thuaj kurrë asaj fjalë fyese, që thyjnë zemrën, në mënyrë që ajo të mos vishet me avull.”



mundëson që nëpërmjet meje t’ia zgjidhë apo t’ia lehtësojë zgjidhjen e hallit njeriut në fjalë. Më parë do të zgjidhja t’i bëhem ndihmë besimtarit, sesa të kisha në zotërim ar dhe argjend sa kjo botë. (Ali el-Muttaki, Kenzu’l-Ummal, VI, 598/17049)

Të krenuarit e të priturit falënderim dhe mirënjohje gjatë aktit të dhurimit, i fshin të gjitha sevapet dhe lumturitë që sjellin mirësitë e bëra. Ai që dhuron, nuk duhet të ketë asgjë tjetër në mendje veç pëlqimit të Allahut. Pra pritshmëritë duhet t’i ketë të orientuara vetëm nga Allahu i Lartmadhëruar. Nuk duhet harruar se, të kërkosh qoftë edhe dua apo falënderim, mundet ta dëmtojë ihsasin (sinqeritetin) e këtij adhurimi.

Ajeti që erdhi për të përgëzuar dhurimin që bënë Hazreti Aliu dhe Hazreti Fatimeja, radijallahu anhu, duhet të shërbejë si model për të gjithë dhuruesit:

“Ata i ushqejnë të varfërit, jetimët dhe të zënë rob, edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: «Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.» Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim” (el-Insan, 8-11)

Shembulli i nënave të këtij umeti, në lidhje me dhënien e lëmoshës vetëm për hir të Allahut, duke mos pritur as falënderim që të mos u zvoqëlohen sevapet, është shumë i bukur:

Hazreti Aishe dhe Hazreti Ummu Seleme, kur u dërgonin fukarenjve ndonjë gjë, kërkonin nga dërguesi të mësonte përmendsh duanë e fukarenjve, në mënyrë që edhe ata të bënin të njëjtën dua për ta. Ato mendonin se duaja e të varfërve do të shlyhej me të njëjtën dua që ato bënin për



ta. Ato nuk prisnin as dua prej të varfërve, sepse mendonin që të kesh sadopak pritshmëri të çfarëdollojshme ua ulin sinqeritetin dhe vlerat bamirësisë. (*Ihja*, I, 601)

RRUGA QË TË SHPIE TEK PËRKUSHTIMI I VËRTETË...

Për të na bërë t'i afrohemi sa më shumë, Allahu i Lartmadhëruar, me anë të ajetit **"Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që doni..."** (Âl-i İmrân, 92) na ka treguar objektivin më të lartë të robërisë ndaj Tij.

Njëri nga kushtet themelore të disiplinës që duhet plotësuar me rigorozitet, në aktin e dhurimit, është: **"Të mund të ndajmë (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që duam"**. Kjo tregon nivelin e dashurisë së imanit (besimit) të besimtarit ndaj Krijuesit të tij.

Ajo që na bie si detyrë, është përcaktimi i gjërava më të dashura në mesin e atyre që zotërojmë dhe përpjekja e të fituarit të kënaqësisë së Allahut të Lartmadhëruar, nëpërmjet tyre. Kështu do të hedhim hapa konkrete në rrugën e devotshmërisë dhe përkushtimit. Duhet të japim sadeka (lëmoshë), duke e vënë veten në vendin e të varfërit dhe duke menduar se çfarë do të dëshironim të na dhurohej neve. Në një ajet kuranor thuhet:

"O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t'i pranoni ndryshe, veçse symbyllur.

Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë." (el-Bakara, 267)

Njeriu nuk duhet të mendojë se po jep sadeka, kur jep atë, që po t'i dhurohej atij, nuk do ta preferonte. Nuk konsiderohet sadeka ajo ndihmë që bëhet me gjëra të vjetra, që nuk i përdor më askush e as ushqime të ndenjura apo një ndihmë simbolike që shërben vetëm për një çast. Çdo ndihmë, që tekefundit të varfërin e lë prapë keq dhe në mesin e halleve, nuk konsiderohet në kuptimin e plotë sadeka.

Besimtari është njeri bujar. Ndërsa bujaria e vërtetë nuk shprehet me shuma të papërfillshme e simbolike, por me dhurimin e asaj që ka vlerë e është e dëshirueshme për ne, dhurim i cili ka për t'ia zgjidhur problemet të varfërit dhe ka për t'ia shuar dhembjet atij.

NDIHMËJENI NJËRI-TJETRIN NË PUNË TË MIRA DHE NË DEVOTSHMËRI

Qëllimi i dhurimit është të shpëtuarit tërësisht të nevojariat nga vështitësitë ekonomike. Sigurisht, jo çdokush ka mundësi të mjaftueshme ekonomike për ta bërë vetëm këtë. Prandaj në vepra të mira duhet të bashkohemi dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin.

"...Ndihtmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në devotshmëri..." (el-Maide, 2)

Për sa kohë që nuk është formuar një forcë shumëplanëshe, që do të shuante çdo hall a vështirësi të besimtarëve, duhet bërë një përpjekje serioze për të hedhur në jetën tonë praktike urdhrin e Allahut të Lartmadhëruar **"ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në devotshmëri"**.

Një besimtar është vazhdimisht në kërkim të punëve të mira. Nëse nuk zotërojmë diçka materiale për të dhuruar, atëherë, duke dhënë kohën dhe energjitë tona, mund të bëhemi shkak për realizimin e një bamirësie.

Nuk duhet të biem edhe ne pre e mendimit të gabuar, por shumë të përhapur në kohët tona, që të varfërve t'u jepet diçka simbolike, sa për t'i larguar prej nesh dhe sa për të qetësuar apo gënjyer ndërgjegjen tonë.

Duhet të mendojmë me shqetësim, sa jemi duke dhuruar nga të mirat që na ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar, për hatër të Tij?...Në çfarë raporti qëndrojnë shpenzimet që bëjmë për vete me dhurimet, lëmoshat dhe ndihmat që u bëjmë të tjerëve? Apo ngushëllojmë veten me shuma krejt të papërfillshme që ne dhurojmë, duke u krahasuar me të tjerët që nuk e kanë vetëdijen e dhurimit për hir të Allahut të Lartmadhëruar? Por në fakt, besimtari nuk duhet të krahasohet me të pavetëdijshmit, por me Hazreti Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, apo me sahabët e tij të zgjedhur. Allahu i Lartmadhëruar, në një ajet kuranor, urdhëron çdo besimtar që të marrë shembull apo model njerëzit e devotshëm:

“...Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ta dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim...” (et-Tevbe, 100)

Gjenerata e sahabëve, të cilën Allahu na e paraqet në kuran si shembull e model, **fillimisht** pagoi çmimin e besimit me jetën dhe pasurinë e saj, kur ishte në Meke.

Së dyti, kur ata ishin në Medine paguan çmimin e të jetuarit si myslimanë, duke u ballafaquar me çdo mësymje të jobesimtarëve. **Së treti**, me përpjekjen që ata bënë në rrugën e davetit (ftesës për në fenë islame), duke bartur dritën e udhëzimit përgjatë shekujve, paguan çmimin e përgjegjësisë së besimit.

Ata jetuan me vetëdijen e ajetit **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për çdo të mirë që u është dhuruar!”** Ne duhet të marrim shembull sahabët dhe të jetojmë në përputhje me tri veçoritë e tyre kryesore.

AI QË BËHET SHKAKTAR PËR NJË TË MIRË ËSHTË NJËSOJ SI TA KISHTE KRYER VETË

Në rast dhurimi, duhet të sigurohemi që, ajo çfarë dhurohet do të shërojë plagët e shoqërisë. Kur mbetemi vetëm dhe të pamjaftueshëm për t’ia arritur kësaj, nuk duhet të themi: *“Unë vetëm kaq pata mundësi, për më tepër më ndjeni...”*, e kështu të lihet nevojtari i vetëm dhe i zhytur në halllet e tij. Një besimtar duhet të mendojë: *“A thua mundem të gjej ndonjë person t’ia heq hallin?”* Në këtë mënyrë, do të ndërtohen ura komunikimi

midis të varfërve dhe të pasurve, detyrë kjo e çdo besimtari. Në një hadith thuhet:

“Ai që bëhet shkaktar për një punë të mirë, është njësoj si ta ketë kryer vetë atë.” (Tirmidhi, Ilim, 14)

Si përfundim, themi se besimtari që dhuron, është njeri me tipare të theksuara **empatie**. Ai di të ekuilibrojë shumë mirë përpjekjet për shpëtimin e vetes dhe të tjerëve. Allahu e ka refuzuar tipin e njeriut që mendon veç për interesin e tij, si egoist, kabah dhe koprrac. Nuk duhet të harrojmë kurrë se, aq

sa ndjejmë përgjegjësinë për të tjerët, aq herë më të lehtë do të japim llogari në botën tjetër.

Allahu na dhuroftë dëshirën për t’u përpjekur me të gjitha forcat për fenë tonë të bukur! Dhëntë Allahu i Lartmadhëruar që të bëhemi nga njerëzit që dhurojnë, duke mos shkelur edukatën dhe parimet e dëshiruara prej Tij, vetëm për hir të Allahut dhe vetëm me shpresën tek Ai. E Allahu e bëftë të mundur që prej këtyre dhurimeve të përjetojmë kënaqësinë dhe lumturinë që të fal ky adhurim!

Amin...



“...Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ta dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim...”

(et-Tevbe, 100)



Njëri nga dijetarët e njohur të islamit, hirësia e tij Osman Nuri Topbash, librat e të cilit janë botuar vazhdimisht nga shtëpia botuese “Progresi”, bëri, më datën 09.05.2011, një vizitë në Shkodër për të promovuar librin e tij më të fundit të përkthyer në shqip, me titull “Meditimi”. Me këtë rast, ai komunikoi me intelektualë të fushave të ndryshme të këtij qyteti. Vizitoi medresetë e Shkodrës, atë të vajzave dhe të djemve. Nga të dy medresetë iu bë një pritje madhështore. Për nder të tij u organizuan programe të ndryshme artistiko-letrare. Në mesazhin e tij, drejtuar nxënësve, ai u shpreh se tek ata mbështet e ardhmja shpirtërore e intelektuale e kombit shqiptar. Vuri theksin tek i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, si modeli më i përkryer për çdo njeri. Trajtoi gjithashtu rëndësinë që ka arsimimi në të ardhmen e një populli dhe vlerat që feja islame i jep atij. Mori shumë shembuj nga jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe sahabëve të tij për të ilustruar domosdoshmërinë e ndërthurjes së besimit me diturinë, si parakusht i formimit të plotë të individit.

Në takimin që pati me stafin e shtëpisë botuese “Progresi”, u vu në dijeni nga afër për veprimtarinë e këtij institucioni. Duke çmuar punën e mirë që është bërë gjatë këtyre viteve nga kjo shtëpi botuese, sugjeroi një shtrirje të mëtejshme në pasqyrimin e vlerave të qytetërimit islam. Më pas, hirësia e tij Osman Nuri Topbash, vizitoi Myftininë Shkodër, duke bërë dua për mbarëvajtjen e këtij institucioni kaq të rëndësishëm.

Në vizitën që bëri në Kosovë u takua me lexuesit dhe dashamirët e tij, si dhe me autoritete të ndryshme të vendit. Në qytetin e Prizrenit, në Xhaminë Bajrakli, mbajti një ligjëratë. Xhamia u mbush plot me besimtarë, që ndoqën me interesim fjalën e mbajtur nga hirësia e tij. Më pas, ai vizitoi Medresenë e Madhe të Gjakovës.

Një ditë më vonë, në vizitën e tij në Shkup, në Xhaminë Dykanxhik, u takua me xhematin, që përbëhej nga moshat të ndryshme dhe mbajti një ligjëratë. Po kështu, vizitoi Shtipin në Maqedoninë Lindore, ku u ndal në medresenë e këtij qyteti.

SHPIFJA NË MORAL DHE MASAT NDËSHKUESE

“Në të vërtetë, ata që shpifin për gratë e ndershme, të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër i pret një dënim shumë i madh.” (En-Nur, 23)

“Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i rrihni me nga tetëdhjetë të rëna dhe mos ua pranoni kurrë më dëshminë. Të tillët janë të pabesueshëm.” (En-Nur, 4).

Ma. sci. Flamur Sofiu

HYRJE

Sheriati islam është ligji i vetëm hyjnor që nuk ka asnjë mangësi dhe asnjë të metë, ngase burimi i tij është nga Ligjdhënësi i Vetëm, Allahu i Lartësuar. Sheriati islam i ka përcaktuar interesat e myslimanëve në pesë çështjet jetësore, të cilat kurrsesi nuk mund të cenohen. Njëra prej këtyre interesave jetësore është edhe ruajtja dhe mbrojtja e nderit-moralit të myslimanit.

Kur lexojmë dhe studiojmë tekstet (ajetet dhe hadithet) që flasin për çështjen e shpifjes për kurvëri, shohim se janë shumë të qartë dhe të prerë. Përveç se janë të qartë, ata e sulmojnë në mënyrë të prerë këtë fenomen shumë të përhapur në shoqëri. Jo rastësisht sheriati islam e ka sulmuar këtë fenomen që i sjell vetëm telashe dhe probleme shoqërisë. Po ashtu, juristët myslimanë i kanë shpjeguar dhe vendosur normat që kanë të bëjnë me shpifjen në moral.

Ajo që ne myslimanët duhet të kemi parasysh është se çdo gjë e përcaktuar prej Allahut të Lartësuar është në dobinë dhe të mirën e mbarë njerëzimit. Edhe urtësinë e ndalesës për shpifjen në moral e di më së miri Krijuesi ynë. Neve na mbetet t’i nënshtrohemi urdhrit të Allahut, ngaqë jemi të mësuar t’u nënshtrohemi urdhrave të Tij dhe të largohemi prej ndalesave që ka përcaktuar Ai. Por ne do t’i përmendim disa nga urtësitë e ndalimit të shpifjes në moral:

1. Pengimi për të akuzuar njëri-tjetrin për kurvëri.
2. Ruajtja e nderit të njerëzve nga trillimet dhe mashtrimet e të pandershmëve.
3. Mospërhapja e armiqësisë dhe urrejtjes në mesin e njerëzve, që shpesh ndodh për shkak të shpifjes në moral.
4. Ruajtja pastër e opinionit të shoqërisë nga tri-

llimet dhe gënjeshtat.

5. Pengimi i përhapjes së kurvërisë në mesin e besimtarëve duke eliminuar edhe shpifjen dhe trillimin si faktorë të drejtpërdrejtë në nxitjen e kësaj dukurie negative.

Të gjithë njerëzit janë të mendimit se shpifja dhe trillimi janë fenomene shumë të këqija dhe të dëmshme për shoqërinë njerëzore.

Në të drejtën islame, shpifja në moral nënkuptohet me shprehjen **الغش**. Në kuptimin etimologjik kjo shprehje do të thotë gjuajtje me gurë apo me diçka të ngjashme, ndërsa në kuptimin terminologjik të shariatit nënkupton shpifjen për kurvëri (zina).

Sipas shariatit islam të shpifurit për kurvëri është vepër rreptësisht e ndaluar. Si mbështetje për këtë kemi ajetet kuranore dhe hadithet e të Dërguarit (s.a.v.s.), ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Në të vërtetë, ata që shpifin për gratë e ndershme, të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër i pret një dënim shumë i madh”**, **“Edhe ata që shpifin për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i rrihi me nga tetëdhjetë të rëna dhe të mos u pranoni kurrë më dëshmi. Të tillët janë të pabesueshëm”**². Po ashtu, i Dërguari (s.a.v.s.), e ka luftuar në mënyrë shumë të ashpër këtë fenomen, duke e konsideruar si njërin prej mëkateve më të mëdha: **“Largohuni prej shtatë gjërave shkatërruese!”** Ata (shokët e tij) i thanë: **“Cilat janë ato?”** E i Dërguari (s.a.v.s.), u tha: **“Të bërit shok Allahut, magjia, mbytja e njeriut kur Allahu e ka ndaluar, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, ikja prej betejës dhe shpifja ndaj grave të ndershme dhe të pafajshme”**.

MËNYRAT E SHPIFJES PËR KURVËRI

Sipas juristëve hanefitë, shpifja për kurvëri mund të konsiderohet si shpifje, nëse është shprehur në njërin prej këtyre dy formave:

1. Që shpifja të bëhet qartazi, duke akuzuar dikë në mënyrë të prerë dhe me shprehjet përkatëse. Në këtë rast duhen zbatuar masat ndëshkuese ndaj shpifësit.

2. Që shpifja të bëhet duke i mohuar dikujt gjeonealogjinë. Edhe në këtë rast zbatohen masat ndëshkuese për shpifësin.

1. En-Nur: 23.

2. En-Nur: 4.

“Në të vërtetë, ata që shpifin për gratë e ndershme, të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër i pret një dënim shumë i madh”



LLOJET E DËNIMIT PËR SHPIFJE NË MORAL

Dënimi për shpifje, sipas së drejtës islame është dy llojesh:

1. Dënimi fizik.

Kjo formë e dënimit shprehet duke e zbatuar masën ndëshkuese me rrahje deri në tetëdhjetë të rëna me kamxhik.

2. Dënimi edukativ.

Ky dënim parashikon ndaj shpifësit mospranimin e dëshmisë për asgjë dhe, në të njëjtën kohë, konsiderohet si mëkatar dhe i pabesueshëm.

Shënim: Të gjithë dijetarët janë të mendimit se personi, i cili është viktimë e shpifjes s’duhet të kërkojë kompensim material nga shpifësi.

Kushtet që duhet të plotësohen për t’u zbatuar masat ndëshkuese për shpifje.

Këto kushte kanë të bëjnë me shpifësin, të shpifurit dhe shpifjen.

Kushtet që duhet të plotësojë shpifësi për t’u dënuar për shpifje:

1. Të jetë shëndosh në aspektin psikik. Ai që ka të meta psikike dhe nuk është në gjendje të arsyetojë, nuk u nënshtrohet masave ndëshkuese për shpifje në moral.

2. Të jetë në moshë madhore. Kur ndodh që të bëjë shpifje fëmija, i cili ende nuk ka hyrë në moshën madhore, atëherë ai nuk dënohet.

3. Të mos jetë në gjendje të sjellë katër dëshmitarë. Në këtë rast do t’i nënshtrohet dënimit.

4. Të mos jetë i detyruar me dhunë të bëjë shpifje. Nëse ndodh që dikush të bëjë shpifje për shkak të presionit të dhunshëm, nuk dënohet.

5. Të mos i ketë dhënë leje personi për të cilin është shpifur. Kur ndodh që dikush i jep leje dikujt për të shpifur ndaj tij, atëherë shpifësi nuk dënohet.



het me masat e caktuara për shpifje në moral.

6. Që shpifësi të jetë prej myslimanëve. Si i tillë, duhet ta ketë të ditur se shpifja është vepër e ndaluar.

Kushtet që duhet të plotësojë personi, për të cilin është shpifur:

Personi ndaj të cilit është bërë shpifja, duhet të plotësojë disa kushte, me qëllim që shpifësi të meritojë dënimin për shpifje në moral.

1. Duhet të jetë shëndosh në aspektin psikik. Kur ndodh që të shpifet ndaj personit që nuk është i aftë në aspektin psikik, atëherë nuk mund të zbatohet dënimi për shpifje ndaj shpifësit.

2. Personi të cilit i është bërë shpifja të jetë i hyrë në moshën madhore. Nëse ndodh që t'i bëhet shpifje personit i cili është ende i pa hyrë në moshën madhore, atëherë shpifësi nuk dënohet me dënimin e shpifjes, por caktohet dënim i veçantë prej kadiut (te'azir).

3. Personi ndaj të cilit është bërë shpifja duhet të jetë mysliman.

4. Personi ndaj të cilit bëhet shpifja duhet të jetë me status civil i lirë e jo rob.

5. Personi ndaj të cilit është bërë shpifja të jetë i pastër në aspektin e nderit. Pra, nëse dikush ka flirtuar kur ka qenë i pamartuar e më pas është penduar dhe dikush tjetër shpif ndaj tij për kurvëri, ky i fundit nuk dënohet për shpifje në moral, por kadiu përcakton një masë ndëshkuese për të (te'azir).

6. Personit të cilit i është bërë shpifja ta ketë të

përcaktuar emrin e tij në shpifje. Kur ndodh që të bëhet shpifje, por ajo bëhet me fjalë të përgjithshme, pa u përcaktuar emri i ndonjë personi, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shpifje të veçantë.

VËRTETIMI I SHPIFJES NË MORAL

Shpifja në moral vërtetohet në dy mënyra:

1. Që vetë shpifësi të pranojë se ka bërë shpifje.
2. Dëshmia e dy meshkujve të drejtë.

QËNDRIMI I KADIUT NDAJ SHPIFËSIT KUR VËRTETOHET SE AI KA SHPIFUR

Nëse i akuzuari për kurvëri sjell fakte se akuza drejtuar atij është shpifje e hapur, atëherë kadiut nuk i mbetet asgjë tjetër veç të kërkojë prej shpifësit të sjellë faktet për shpifjen që ka bërë. E nëse ndodh që shpifësi sjell katër dëshmitarë për atë që ka thënë dhe me këtë vërteton fjalët e veta, atëherë zbatohet masa ndëshkuese për kurvëri ndaj atij që është akuzuar, apo, nëse i shpifuri pranon se ka bërë kurvëri, atëherë shpifësi nuk dënohet, por dënohet i akuzuari. Ndërsa nëse shpifësi nuk mund të sjellë dëshmitarë për shpifjen që ka bërë, atëherë ndaj tij zbatohet dënimi për shpifje në moral.

Ka mundësi të ndodhë që akuzuesi të kërkojë prej kadiut që t'i jepet afat për t'i sjellë dëshmitarët, duke pretenduar se ata momentalisht janë jashtë shtetit. Në këtë rast kadiu nuk i jep afat, por e zbaton dënimin për shpifje ndaj shpifësit. E nëse akuzuesi i kërkon kadiut t'i japë afat të sjellë dëshmitarët që janë brenda shtetit, atëherë i jepet afat akuzuesit që ai të urdhërojë dikë për t'i sjellë dëshmitarët. Nëse ata vijnë, atëherë ky shpëton prej dënitit të shpifjes e, nëse ndodh që nuk mund t'i sjellë, atëherë ndaj akuzuesit zbatohet masa ndëshkuese për shpifje në moral. Por nëse ndodh që fillon të zbatohet dënimi ndaj shpifësit dhe në atë moment paraqiten dëshmitarët, atëherë ndalet dënimi ndaj shpifësit dhe zbatohet dënimi për kurvëri ndaj të akuzuarit.

PËRSËRITJA E SHPIFJES NDAJ NJË PERSONI DISA HERË

Nëse ndodh që shpifësi të shpifë për dikë më shumë se një herë, ai duhet të dënohet vetëm një herë, edhe pse e ka përsëritur disa herë shpifjen, kur ende nuk është zbatuar masa ndëshkuese për shpifje në moral ndaj tij. Por, nëse ndodh që shpifësi ka shpifur ndaj dikujt dhe është zbatuar

dënimi ndaj tij e, ai prapë shpif, atëherë prapë zbatohet ndaj tij dënimi për shpifje në moral. Pra, këstu dënohet sa herë që të shpifë.

SHPIFJA NDAJ NJË GRUPI NJERËZISH

Si duhet të dënohet dikush që shpif ndaj një grupi njerëzish?

Dijetarët ndajnë këto mendime:

1. Disa prej dijetarëve janë të mendimit se shpifësi në një rast të tillë duhet të dënohet vetëm me një dënim.

2. Ndërsa disa prej dijetarëve mendojnë se, nëse shpifësi ka shpifur ndaj një grupi njerëzish, duke u thënë në mënyrë të përgjithshme: "Ju jeni lavira", duhet të dënohet vetëm me një dënim, mirëpo nëse i është drejtuar secilit prej atij grupi në mënyrë të veçantë, atëherë ai do të dënohet për secilën shpifje më vete.

KUR NUK ZBATOHET DËNIMI PËR SHPIFJE

Masat ndëshkuese për shpifje në moral nuk mund të zbatohen në këto raste:

1. Kur vërtetohet me anë të miratimit se i akuzuari ka bërë kurvëri (kur vetë i akuzuari pranon se ka bërë kurvëri) apo me anë të dëshmisë (kur dëshmojnë katër meshkuj se e kanë parë haptas duke u kryer akti seksual).

2. Kur njëri prej bashkëshortëve e akuzon tjetrin për kurvëri dhe që të dy betohen nga pesë herë se po flasin të vërtetën, sipas tyre dhe herën e fundit kërkojnë mallkimin e Allahut të lartësuar, nëse janë prej gënjeshtarëve.

Shënim: Po qe se ndodh që babai apo nëna të shpifin ndaj fëmijës së tyre, ata nuk dënohen me dënimin e shpifjes. Po ashtu nuk zbatohet dënimi për shpifje ndaj gjyshit apo gjyshes, nëse këta shpifin ndaj nipit apo mbesës së tyre. Për këtë janë në ujdi që të gjithë dijetarët.

Dënimi për shpifje kushtëzohet të zbatohet, nëse shpifja është bërë në shtetin islam. Kur shpifja bëhet në shtetin joislam, atëherë nuk zbatohet dënimi për shpifje, ngase në atë shtet nuk është udhëheqësi mysliman. Ky veprim mbështet në rregullën e shariatit.

"Nuk zbatohet asnjë masë ndëshkuese që është e përcaktuar me shariat, kur nuk ka prijës mysliman apo person që është i autorizuar prej tij". Ajo që duhet të përmendim në këtë rast është se sot, në

"Nuk zbatohet asnjë masë ndëshkuese që është e përcaktuar me shariat, kur nuk ka prijës mysliman apo person që është i autorizuar prej tij"



mungesë të shtetit islam, nuk mund të zbatohen dënimet që janë caktuar për shpifjen në moral. Në këtë rast myslimani, i cili ndodh të bëjë një mëkat të tillë, duhet të kërkojë falje prej Allahut dhe të pendohet sinqerisht me shpresë që Allahu do ta falë.

Gjithashtu është kusht që, kur të bëhet shpifja, të mos kushtëzohet me ndonjë veprim. Pra, nëse thuhet: "Po hyre në këtë vend, atëherë ti je lavirë", ai që hyn nuk ka dënim për shpifje. Po ashtu, nuk konsiderohet shpifja në kohën e ardhshme. Në këtë rast nuk ka dënim për shpifje.

PËRFUNDIMI:

Duke parë rregullat e shariatit, mund të nxjerrim këto konkluzione:

1. Shpifja është njëri prej mëkateve më të mëdha dhe Allahu i Madhërishëm ka përcaktuar masa ndëshkuese të prera për këtë mëkat.

2. Shpifja është një vepër e palejueshme për myslimanin, pavarësisht se ndaj kujt e bën atë.

3. Shpifja si mëkat shkakton hutim dhe probleme në shoqëri, ndaj myslimani nuk duhet as të mendojë për një veprim të tillë.

4. Shpifja është një gënjeshtër e madhe dhe dihet qartë se i Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë që njeriu nuk mund të jetë edhe mysliman edhe gënjeshtar.

5. Praktikimi i këtij mëkati në shoqëri është shumë i dëmshëm. Për këtë, Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari (s.a.v.s.), e kanë luftuar ashpër.

6. Kur ndalet shpifja dhe trillimi në shoqëri, atëherë edhe shoqëria është e kënaqur dhe e sigurtë.

7. Myslimani i sinqertë do të largohet prej këtij mëkati dhe do të mundohet të ndikojë tek tjetri që të mos bjerë pre e këtij fenomeni të shëmtuar.

8. Duhet që të gjithë së bashku të përpiqemi ta eliminojmë këtë fenomen prej shoqërisë ku jetojmë dhe veprojmë.



Shkrimtari, personazhi, lexuesi i vogël - marrëdhënie, raporte dhe aspekte të komunikimit artistik në poezinë për fëmijë të Adelina R. Mamaqit



Xhahid Bushati

-PJESA E PARË-

Emri i Adelina R. Mamaqit u shfaq në fushën e let-rave shqipe nga fundi i viteve '50. Në agimin e vite-ve '60 botoi librin e parë poetik për të rritur "Ëndrra vashërie".¹ Si dëshmi e kësaj vepre poetike, Adelina R. Mamaqi u bë poetja e parë në letërsinë shqipe.

Si krijuese i takon brezit të shkrimtarëve për fëmi-jë të viteve '60, brezi me kontribute të rëndësishme, me risi në problematikë e tematikë, gjini, zhanre e rrëfim në letërsinë për fëmijë. Dekadat flasin se kjo shkrimtare solli një krijimtari të pasur e të larmishme, krijimtari që vazhdon edhe sot.

Shqyrtimi i këtij aspekti të krijimtarisë poetike të Adelina R. Mamaqit, u bë nga besueshmëria e kësaj formule: "Ndër librat që të interesojnë, qëmto ata që ia vlejnë të shqyrtohen e të konsiderohen dhe që të rrë-mbejnë në botën e tyre, në të vetmen botë të pacenue-shme nga tirania e kohës."²

Gjatë vështrimit tonë në lëmin shkrimor e histo-rik, herë pas here në periudha të ndryshme kohore, kemi gjetur në disa shkrime e studime të botuara në organe të ndryshme, mendime e interpretime shpesh kontradiktore në lidhje me fillimet e sakta të

1. Mamaqi, Adelina. : "Ëndrra vashërie" (poezi), Sh.B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1963; Prishtinë, 1969.

2. Bloom, Harold.: "Si dhe përse lexojmë", (përkthyer nga Albana Sala), Botimet Dudaj, Tiranë, 2008; pjesa "Prolog" (Përse të lexojmë?), faqe 14.

jetës letrare të kësaj autoreje, pra atë që e quajmë biografi e shkrimtarit. Saktësinë e këtij problemi, re-alisht na e ofroi libri i saj i parë: "Ëndrra vashërie" dhe krijimet letrare të kësaj autoreje botuar në periodi-kët e gazetave e të faqeve letrare të tyre, para se të botohej libri me poezi.

Evidentimi i vlerave të librit të parë për të rritur e prezantoi denjësisht si poete Adelina R. Mamaqin, e cila rrezatimin më të madh dhe jehonën e pati më shumë në Kosovë se sa në Shqipëri. Me këtë libër me poezi ajo hyri e sigurtë e me dinjitet në botën e letërsisë.

Në marrëdhënie me kohën kur u botua ky libër dhe me lexuesin, më mirë se kushdo flet ky fragment, të cilin po e citojmë: "Në vitin 1963 (Adelina Mamaqi, nënvizimi im) e botoi librin me poezi për të rritur "Ëndrra vashërie", libri i parë i një poeteje shqiptare, i cili bëri jehonë te lexuesit dhe te kritika, jo vetëm për vlerat artistike, por edhe për faktin se theu një tabu: Kjo poete e re merrte guximin t'i shprehte ndjenjat e dashurisë femërore, në një kohë kur fjala "dashuri" ishte thujse një mëkat."³

Siç ndodh jo rëndom, zakonisht ndodh te poetët e vërtetë, po në këtë vit poetja Adelina R. Mamaqi, në krijimtarinë e saj, ndërron vështrim e objekt, proble-matikë e tematikë, personazh e psikologji, fantazi e

3. Gazeta "LAJM" (Kosovë), dt. 26 tetor 2009, shkrimi: "Adelina Mamaqi në Kosovë, pas 40 vjetëve".

situatë, imazhe dhe lexues. Ndoshta pak e çuditshme, por ja që ndodhi në jetën artistike të kësaj autoreje. Në vitin 1963 botoi librin poetik për fëmijë "Bubi i vogël". Edhe pse tani flitet për një adresë të re, autorja ruan gjithnjë statusin e shpirtit lirik, përjetimin, pozicionimin (e narratorit) e vetës së parë "unë", të rrjedhës së vetëdijes "unë", të vetës së dytë "ti", të vetës së tretë "ai"; dialogun e magjinë e përrallës, pasurinë e figurave letrare, si: epitetin, metaforën, anaforën, hiperbolën e paralelizmin figurativ; imazhin aural, si përsëritjet, aliteracionin, anomatopenë, tonin si mëvetësi e si shkrirje organike brenda strukturës së poezisë. Me këtë arsenal mjetesh e shprehësish në stil dhe në rrëfim, kjo poete është cilësuar me të drejtë nga studiuesi e poeti Agim Deva, "si krijuese që hyn në gjeneratën poetike që manifestojnë **Poezinë e imagjinatës së lirë**".

Krijimtaria letrare e Adelina R. Mamaqit, krahasuar me individualitetet krijuese të së njëjtës periudhë, si dhe ata që erdhën më vonë, të cilët ende kontribuojnë në letërsinë për fëmijë, qëndron në vlera të spikatura, të dallueshme dhe me tipare të papërsëritshme. Në prurjet cilësore, rrezaton veçanërisht opusi letrar i botuar pas viteve '90, opus që numëron afro 21 vepra letrare që u adresohen disa grupmoshave të lexuesve të vegjël: parashkollorë dhe shkollorë.

Krijimtaria e shkrimtares Adelina R. Mamaqi, paraqitet në dy tablo. Më saktë në dy periudha kohore dhe të një **paule** (ndonëse për një krijues të vërtetë termi **paule** është i trishtueshëm), siç do ta quaj unë.

Periudha e parë nis me librin "Bubi i vogël" dhe i takon vitit 1963. Pastaj vazhdon me një bibliotekë librash nëpër vite, për të arritur në vitin 1990. Spektri tematik zgjerohet. Problemet e rrëfyera flasin për një hapësirë më të gjerë trajtimi në prozë dhe poezi. Gjinitë dhe zhanret pasurohen gjatë lëvrimit të tyre. Prurjet dhe individualiteti krijues i Adelina R. Mamaqit i "interesojnë" kritikës letrare. Ndaj, bëhet objekt studimesh i shkrimtarëve dhe studiuesve, si: Muzafer Xhaxhiu, Odhise K. Grillo, Bedri Dedja, Pandora Dedja, Bekim Gaçe, Agim Deva, Astrit Bishqemi, Muharrem Xhaxho, Viktor Qurku, Çapajev Gjokutaj, Faik Shkodra, Xhevat Sylja, Qibrie Demiri, Fatos Kongoli, Ramazan Çadri, Hasan Ulqini, Ibrahim Ibishi, Shukrie Rama, Milaim Nelaj, etj. Kjo periudhë mbyllet si proces studimi me monografinë "Shpirti plot rubinë"⁴ dhe shkrimin "Kopshti i bukur" i vjershave dhe për-

4. Rama Shukrije: "Shpirti plot rubinë" (studim, Vepra letrare e Adelina Mamaqit), botim Shtëpia Botuese "Rozafa", Prishtinë, 2007.

Krijimtaria letrare e Adelina R. Mamaqit, krahasuar me individualitetet krijuese të së njëjtës periudhë, qëndron në vlera të spikatura, të dallueshme dhe me tipare të papërsëritshme.



rallave të Adelina Mamaqit"⁵

Në këto shkrime dhe studime evidentohen disa tipare të krijimtarisë për fëmijë të kësaj autoreje, të cilat po i radhisim:

*Autorja lëvront me sukses të gjitha gjinitë e zhanret letrare. Më të dashura ka poezinë dhe përrallën.

*Përralla e kultivuar nga ana e autores ka natyrë poetike.

*Zhvillon përrallën shkencore.

*Në fillimet e krijimtarisë, autorja gjen mbështetje tek përralla popullore. Kjo marrëdhënie shpreshtohet në vitet e mëvonshme.

*Njeh kërkesat pedagogjike e artistike të fëmijëve, kërkesa që shtron koha dhe letërsia shqipe për fëmijë.

*Autorja priret drejt vështrimit të fenomeneve më të rëndësishme që shtron e sotmja dhe e nesërmja e fëmijëve.

*Shfaq aftësi në njohjen e "enigmave" të botës dhe psikologjisë fëminore.

*Shquhet për mënyrën e të rrëfyerit dhe të komunikimit të ngrohtë dhe të çiltër me fëmijët. Në të rrëfyerit e saj, autorja shfaqet si nënë, edukatore, prind e gjyshe.

5. Nelaj Milaim: "Profile letrare (studime), botim OMSCA-1, Tiranë, 2008; shkrimi "Kopshti i bukur" i vjershave dhe përrallave të Adelina Mamaqit, faqe 9-15.



*Universi i saj poetik shfaq këto dukuri: sinqeritet, çiltërsi, qartësi maksimale në të shprehur, imagjinatë dhe zgjon së tepërmi kërshtërinë e fëmijëve.

*Poezia, krahas fabulës, priret drejt një lirizmi që është pjesë e botës poetike të autores.

*Mesazhet mbartin probleme të kohës.

Punimet e studiuesve dhe të kritikëve në zbërthimin e kodit poetik të shkrimtares, në të shumtën e rasteve përmbajnë vlera të rëndësishme, që edhe sot e kësaj dite nuk i kanë humbur shumë pika referimi. Por e shohim me vend të themi se është e nevojshme të paraqitet hopi i ri cilësor i autores, veçanërisht pas viteve '90. Disa aspekte, si pasurimi tematik kohor në gjinitë e vjershës, përrallës në vargje e poemës, këndvështrimet e trajtesat e reja në rishikimin e veprave të botuara vite më parë, elementet e humorit në zhanrin e fabulave, komunikimi "intim" me personazhin, që është protagonist i ngjarjeve e ndodhive të librit, etj., meritojnë trajtim e interpretim më të thelluar për të dritësuar më tej individualitetin poetik të autores.

Periodha e dytë, të cilën e quajta **pauzë**, ka si cak vitin 1990. Vazhdon afro një dekadë. Janë vite emigracioni, ku autoren e shoqërojnë një pafundësi dhembjesh, dëshirash dhe ëndrrash të trazuara si vetë dallgët e detit. Malli dhe dashuria për lexuesit e saj nuk tjetërsohen. Sepse kanë lindur nga ama e shpirtit të poetes dhe burojnë përjetësisht si një krua që mbart ujë të pastër si një pikë loti.

Emri i poetes së mirënjohur sikur "hesht" në botime veprash e në publikime të përditshme. Boton më pak, vëzhgon dhe akumulon më shumë. Rikthimi te procesi krijues është diçka e natyrshme në jetën e shkrimtares Adelina R. Mamaqi. Sepse natyra e saj krijuese ndjek këtë marrëdhënie: "Secili prej njerëzve (fëmijëve, - nënvizimi im) që takoj është një dallgë, tek e cila zhytem me kënaqësi. Dhe më pëlqen kush ëndërron, kush buzëqesh, kush jeton..., kush nuk humbet besimin, kush mendon që një perëndim nuk

është një fund, por një fillim. Dhe e gjithë kjo nuk ka të bëjë me moshën. E dashuroj kureshtjen, kur është dëshirë për të njohur dhe jo ndërhyrje diku. ... Por besoj se kureshtja është e bukur... Asnjë nuk të dëgjon nëse nuk je i besueshëm. **Dhe je i besueshëm kur nuk e fsheh universin tënd.**⁶

Periodha e tretë fillon aty te pragu i vitit 2000 e në vazhdim. Autorja ka një varg botimesh. Të pritshme, sigurisht. Është në një moment vrulli krijues. E ka më se të nevojshme dhe të domosdoshme. "Të rrëfesh është të tejkalojë veten. Pastaj t'u thuash të tjerëve, pa u pozicionuar, vetëm me dëshirën për t'u njohur e për të ndarë bashkë diçka. Kush jam... pyetje e vështirë."⁷

Kjo periudhë (e tretë) është pothuajse e "paprekur" nga kritika e studimet tona letrare. Lënda krijuese që na ka ofruar autorja kërkon optikë të re leximi, rileximi dhe interpretimi.

Librat e botuar që i takojnë kësaj periudhe mund t'i ndajmë në dy grupe: a) krijimtari e mirëfilltë, b) krijimtari që përfshin ripunime, përshtatje e përpunime të veprave të ndryshme të botuar nëpër vite.

Në grupin e parë hyjnë: "Përrallëzat e shkronjave", "Lodërzat e alfabetit", "Ora e Shibës", "Xhoi Toi", "Sa shtëpi ka dielli?", "101 gjëgjëza", "Ariu dhe dy karriget" (fabula), "Pinguini Ping Ping Pi", etj. Motivin kryesor e zë përditshmëria e ndodhive dhe e ngjarjeve të fëmijëve e të kafshëve, shpendëve, insekteve, etj., e cila bashkëshoqërohet nga një fantazi e tyre e ndezur dhe plot mrekulli të imagjinatës, perceptimi i objekteve në largësi, onomatopetë e gjetura me mjeshtëri, shpirti lodërtar, përcjellja e informacionit shkencor dhe të një fjalori të zgjedhur poetik, etj., etj.

Në grupin e dytë hyjnë: "Bardhoshi, Xhepkoshi", "Hedhin valle bletët", "Zogu Pup në shtëpinë prej xhami", "Si e gjete follenë, moj dallëndyshe", etj. Konstatimi i parë që përftojme për këto vepra është se, shkrimtarja kthen kokën herë pas here, ndalet në vite dhe "bisedon" përsëri me këto vepra të botuara më parë. I sjell shpesh, me një koncept e strukturë të re, ku dëgjohet shpesh freskia e motivit dhe freskia e kohës. Bashkëkohësia është pjesë e personalitetit krijues të Adelinës.

Me këto vepra, autorja sikur shlyen një detyrim ndaj ndërgjegjes së saj artistike e lexuesit të saj, njëkohësisht fisnikëron figurën prej krijueseje me emër në letërsinë shqipe për fëmijë.

6. Moccia Federico: "Kush jam...", gaz. SHQIP, 22.10.2009.

7. Po aty.

Ndikimi i librit

“Muhtasar Sahihul-Buhari”

në jetën e përditshme
të një myslimani shqiptar



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Kohë më parë, saktësisht nga fillimi i vitit 2009, doli në qarkullim një përmbledhje e “Sahihul-Bukhariut”, mbështetur në përmbledhjen e Imam Zejnuddin Ez-Zubejdiut. Libri “El-xhamius-sahih” i Imam Bukhariut, është padyshim një ndër librat më të rëndësishëm në literaturën e fesë sonë, ndër më të dobishmit për shoqërinë islame, por jo vetëm.

I përmbledhur në “Muhtasarin” e Imam Zubejdit dhe i përkthyer në gjuhën shqipe, ai hyn në mënyrë të drejtpërdrejtë në listën e librave më të rëndësishëm islamë pas Kuranit Famëlartë në bibliotekën e madhe të librit islam në gjuhën tonë.

Ky libër që kemi në duar, përherë ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe hulumtuesve të shumtë, jo vetëm të hadithit profetik, por edhe përtej tij, duke u bërë në këtë mënyrë një ndër librat më të kërkuar dhe pikë referimi në studimin e fesë islame nga njëri prej dy burimeve të saj kryesore; fjala e të Dërguarit të Allahut.

Në këta rreshta, do të përmend disa aspekte

të ndikimit që ka ky libër në jetën e përditshme të një myslimani. Kështu, me mbarësinë e Allahut, them se leximi dhe studimi i përmbledhjes së haditheve të Imam Bukhariut, nxit më së miri për:

1. Besimin dhe respektimin e të dërguarit (a.s.), duke u bërë kështu shembëlltyra kryesore për myslimanin në jetën tij.

2. Vlerësimin dhe ruajtjen e Sheriatit islam.

3. Ndërtimin e individit dhe shoqërisë islame mbi bazën e dashurisë për të dërguarin dhe gjurmët e traditave të tij.

1. BESIMI NË PROFETIN MUHAMED (A.S.), RESPEKTIMI DHE PRANIMI I TIJ SI SHEMBËLLTYRË E INDIVIDIT DHE SHOQËRISË ISLAME

“Besimi në dërgesën profetike të hz. Muhamedit (a.s.) na obligon me dorëzimin absolut para asaj më të cilën është dërguar, vërtetimin e tij, bindjen dhe nënshtrimin ndaj urdhëresave dhe ndalesave të tij, pa asnjë mëdyshje, ngushtim,

“...pastaj jepuni salam prej meje
vëllezërve tuaj që munguan
dhe kujt do që do të hyjë në fenë
tuaj pas meje. Ju dëshmoj se unë
u jap salam atyre dhe kujt do
që do të më ndjekë në fenë time,
nga kjo ditë e deri
në ditën e kijametit”

konfuzion a kapriço spontane”¹

Për këtë, argumentet kuranore janë të shumta.
Po përmend disa prej tyre:

- **“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën (e Allahut).”²**

- **“Thuaju, (o Muhamed): Nëse ju e doni Allahu, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet!”³**

- **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.”⁴**

- **“Ndërsa përgjigja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë në mes tyre, është: Dëgjojmë dhe bindemi! Pikërisht këta janë të shpëtuarit.”⁵**

- **“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”⁶**

Këto ajete kuranore dhe shumë të tjera brenda këtij konteksti, janë argument i qartë dhe i mjaftueshëm për të vërtetuar obligimin e myslimanit ndaj shembëlltyrës së Resulullahit (a.s.), në jetën e tij.

E duke lexuar dita-ditës, fjalët dhe porositë e

1. Dr. Abdulkerim Zejdan, “Usulud-dave”, botimi i 8- të, Bejrut, 1998, fq. 33.

2. Ali Imran: 132.

3. Ali Imran: 31.

4. Nisa: 80.

5. Nur: 51.

6. Hashr: 7.

shumta të sinqerta e plot dobi, me të cilat Resulullahi i drejtohet çdo myslimani, ai kupton qartë dashurinë e vetë profetit për njeriun në përgjithësi e myslimanin në veçanti. Kupton lartësinë e mendimit dhe këshillës së tij (a.s.). Kupton dëshirën e tij të madhe për udhëzimin e njerëzisë. Kupton sinqeritetin dhe përlësinë me të cilat ai Zotëri (a.s.) u komunikon njerëzve fjalën e Zotit dhe porositë e zemrës së tij të madhe. E si të mos jetë shembëlltyrë për myslimanin, më i dashuri i krijesave të Allahut? Zotëria i bijve të Ademit? Imami i të dërguarve, vula e tyre? Ndërmjetësuesi në ditën e gjykimit? Ai që na deshi pa na parë dhe u lut për ne pa e ndjerë? Ai, që në momentet e fundit të jetës së tij u thoshte njerëzve të afërt: **“...pastaj jepuni salam prej meje vëllezërve tuaj që munguan dhe kujt do që do të hyjë në fenë tuaj pas meje. Ju dëshmoj se unë u jap salam atyre dhe kujt do që do të më ndjekë në fenë time, nga kjo ditë e deri në ditën e kijametit”⁷**

2. RUAJTJA E SHERIATIT ISLAM

Në Kuranin Famëlartë thuhet: **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”⁸** Ndërsa vetë profeti (a.s.) ka thënë: “Unë ju kam lënë juve Kuranin dhe fjalët e mia. Mbështetuni në to, se kurrë nuk do të humbni”⁹.

Në komente të ndryshme të ajetit të lartpërmendur, dijetarët kanë sqaruar se, përveç ajeteve të Kuranit, edhe hadithi profetik *ka garancinë e Allahut për të mos devijuar e për të mos humbur*. Ajo që e vërteton më së miri këtë pohim, është edhe libri shumë i dashur për mbarë botën islame “Sahihul-Bukhari”, i cili ka tejkualuar kufijtë e shumësisë në përhapjen dhe përkthimin e tij në shumë gjuhë të botës. Ai dëshmon dukshëm dorën hyjnore që mbron nga fshirja dhe devijimi fjalën e të dërguarit të Tij, që është shtylla e dytë mbi të cilën ndërtohet feja islame dhe Sheriati i saj.

Duke lexuar hadithin profetik, në veçanti përmbledhjen e “Sahihul-Bukharit”, myslimani

7. Transmetuar nga Bezzari, nga Abdull-llah ibni Mes’udi (r.a).

8. Hixhr: 9.

9. Transmetuar nga Hakimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

shqiptar ka mundësinë të lexojë rregullat e fesë së tij dhe t'i nënshtrohet asaj, nëpërmjet këtij burimi të kulluar e origjinal. Të lexojë të lejuarat dhe të ndaluarat dhe të ndalet në kufijtë e tyre, të shohë me sytë e objektivitetit realitetin e marrëdhënieve të njeriut me Zotin, veten dhe tjetrin, nën hijen e udhëzimit profetik etj.

Nëpërmjet kapitujve të shumtë që përfshijnë vendimet profetike mbi çështje të ndryshme që lidhen me jetën e përditshme të myslimanit, ai kupton qëndrimin e fesë së tij në lidhje me çdo paqartësi. Në këtë mënyrë, duke respektuar kufijtë e Islamit, duke rritur gradët e përkushtimit, ai ruan njëkohësisht edhe fenë, duke u bërë garant i denjë i saj me veprat dhe sjelljen e tij.

3. NDËRTIMI I INDIVIDIT DHE I SHOQËRISË ISLAME

I shkroi Jahja ibn Muadh, Jezid Bestamiut duke i thënë: "U deha, kaq shumë kam pirë nga gota e dashurisë së Tij". Ebu Jezidi ia ktheu: "Të tjerë kanë pirë detrat e qiejve e të tokës dhe akoma s'u është shuar etja. Ata thonë: A ka më..?"¹⁰

Duke lexuar hadithet e sakta të profetit Muhammed (a.s.), në përmbledhjen e tyre në gjuhën shqipe, myslimani shqiptar ka mundësinë më të mirë të prekë prej afër shpirtin e madh ndërtues, me të cilin u dërgua "mëshira e dhuruar", hz. Muhammedi (a.s.). Nëpërmjet udhëzimeve të tij, myslimanit shqiptar i afrohet një mundësi e madhe për të ndërtuar veten sipas porosive të më të dashurit profet! Nëpërmjet kësaj, i jepet mundësia për të arritur gradën e sahabiut që i drejtohej profetit (a.s.), në ndodhinë e transmetuar nga Tabaraniu¹¹, nga Aishja (r.a.) që ka thënë: "Erdhi një burrë te Profeti (a.s.) dhe i tha: "O i dërguar i Allahut, ti je më i dashur për mua se vetja e fëmija im, saqë, kur jam në shtëpi dhe të kujtoj, mezi duroj sa të vij e të të shoh. Por, kur kujtoj vdekjen time dhe tënden, e di mirë se kur të hysh në xhenet, do të jesh me profetët, e nëse unë hyj në xhenet, kam frikë se s'do të të shoh". Profeti (a.s.), s'i ktheu përgjigje, derisa erdhi Xhibrili me këtë ajet: **"E kushdo që**

10. "Er-Risaletul-Kushejrrije", fq. 325.

11. Marrë nga: "Hajatus-sahabe", i Shejkh Muhammed Jusuf el-Kandehlevi, v. 2, fq. 317.



i bindet Allahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që Allahu i shpërbleu: (me) Pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shoqëri e mirë janë ata!"¹²

Duke lexuar këto hadithe e, mbi të gjitha, duke u udhëzuar drejt gjuhëzimit (si nxënësi para mësuesit), para duarve të një shpjeguesi të ditur e të urtë, myslimani shqiptar ka mundësi reale të marrë atë që i mjafton për të ndërtuar modelin e myslimanit të udhëzuar e të afruar me Krijuesin dhe fenë e Tij të pastër.

Ky libër është si një torçë udhëzimi për çdo mysliman shqiptar, i cili dëshiron të perfeksionojë besimin dhe fenë e tij. Nëpërmjet haditheve të shumta, të përzgjedhura nga imam Zubejdi në këtë përmbledhje të çmueshme nga libri i famshëm i Imam Bukhariut, kemi mundësinë të marrim drejtpërsëdrejti nga burimi i pastër i Resulullahit (a.s.), të përfitojmë prej tij dhe ta përhapim këtë mirësi edhe tek të tjerët.


E teksa e marr nëpër duar këtë libër të çmuar, e shfletoj, e hulumtoj dhe përfitoj nga përmbajtja e tij, më vjen ndër mend dijetari i madh i kohës së tabiinëve, Said ibnil-Musejjib (105 h.), i cili, i etur për dituri, në mungesë të librave të këtij lloji, thoshte: **"Kam udhëtuar ditë e net të tëra në kërkim të një hadithi të vetëm!"**¹³ ...

12. Nisa: 69.

13. Dr. Subhi Salih, "Ulumul-hadithi ve mustalahuhu", botimi i 19-të, Bejrut, 1995, fq. 54.

Ndërroi jetë

Haxhi Faik Hoxha



Më 12.05.2011, u nda nga jeta H. Faik Hoxha, ish myftiu i Zonës Shkodër, Myfti Nderi i asaj zone dhe një prej figurave të shquara të Islamit në Shqipëri. Ai ishte gjithashtu "Qytetar Nderi" i qytetit të Shkodrës, si dhe kishte dekoratën e lartë "Pishtar i Demokracisë", dhënë nga Presidenti i Republikës. Ceremonia e varrimit është zhvilluar ditën e enjte, më 12 maj 2011, në qytetin e Shkodrës, me pjesëmarrjen e personaliteteve të larta të fesë, pushtetit vendor dhe miqve të Haxhi Faikut, të ardhur nga të katër anët e Shqipërisë dhe trevave shqiptare.

Ceremonia e xhenazes u zhvillua në xhaminë "Ebu Bekër" në Shkodër. Të pranishëm në këtë ceremoni kanë qenë, kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipëri-

së Haxhi Selim Muça, nënkryetari i KMSH-së, z. Gazmend Aga, kancelari z. Ali Zaimi, anëtarë të Kryesisë së KMSH-së, kryetari i Këshillit të Përgjithshëm z. Ylli Gurra, myftiu i Zonës Tiranë, Hafiz Shaban Saliaj, myftiu i Zonës Berat, z. Murat Duro, myftiu i Vlorës, Fierit, Librazhdit, Lezhës, Malësisë së Madhe, etj.

Fjalën e rastit e mbajti Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, që theksoi se: "Lajmi i ndarjes suaj nga jeta i ka kaluar kufijtë e Shkodrës. Në një mesazh ngushëllimi, miqtë tuaj nga Shkupi shkruajnë se: "Haxhi Faik Hoxha do jetë përherë në kujtimet tona një burrë i madh intelektual, një atdhetar i flaktë i çështjes shqiptare, një edukues i shkëlqyer i brezit të ri, një humanist, i cili gjatë luftës në Kosovë, ishte në ballë të organizimit të ndihmave humanitare dhe në sistemimin e refugjatëve nga Kosova nëpër familjet shkodrane dhe nëpër kampet e ngritura për refugjatë."

Më pas ka ngushëlluar edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Selim Muça, që e ka vlerësuar H. Faik Hoxhën si mësues të tijin në medresenë e Tiranës. Ai ka përmendur se roli dhe kontributi i të ndjerit ka qenë i madh në shërbim të mësimeve të fesë islame në Shkodër dhe përtej saj.

Edhe Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Lorenc Luka, ka shprehur ngushëllimet e tij me këtë rast. Ai ka vlerësuar kontributin e madh që ka dhënë H. Faik Hoxha në ruajtjen e harmonisë dhe vlerave qytetare në Shkodër, sidomos në drejtim të Myftinisë.

Më pas, namazin e xhenazes e ka drejtuar H. Selim Muça. Ndërkohë, në varreza është kënduar sureja "Jasin" nga Hafiz Shukri Kapllan dhe është

kënduar telkina nga H. Bashkim Bajraktari, i cili pasoi H. Faik Hoxhën në drejtimin e Myftinisë Shkodër.

Kush ishte Haxhi Faik Hoxha?

H. Faik Hoxha u lind në Shkodër, më 14.4.1930. Ishte i biri i Sheh Qazim Hoxhës, njërit ndër predikuesit dhe dijetarët më të shquar islamë të atyre viteve.

Mësimet e para i mori në "Shkollën e Kuqe" të Tiranës, kurse më pas studioi në "Medresenë e Përgjithshme" në Tiranë, të cilën e përfundoi në vitin 1948 me rezultate të shkëlqyeshme.

Në vitin 1950 emërohet profesor në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë, ku dha lëndë fetare dhe të përgjithshme. Në këtë detyrë u tregua i aftë e i dashur. U nderua nga nxënësit dhe u vlerësua nga eprorët. Në vitin 1966, kohë kur punonte në Kooperativën e Artizanatit të Shkodrës, u arrestua dhe, për 23 vite rresht, vuajti dënimin si i burgosur nga regjimi komunist.

Ndryshimet shoqërore të pas viteve '90 krijuan mundësi të reja për Haxhi Faikun. Ai u angazhua me të gjitha energjitë për rizgjimimin e ndjenjave të qytetarëve në besimin të Zotit i madhërishëm dhe për hapjen e xhamive të reja në Shkodër.

Në mbledhjen e parë të përfaqësuesve të rretheve të vendit tonë, në shkurt të vitit 1991, Haxhi Faiku u emërua Myfti i Shkodrës dhe u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman.

Në të gjitha këto detyra Haxhi Faiku u shqua për një veprimtari të dendur dhe të dobishme për gjallërimin e fesë Islame. Gjatë periudhës kur ishte Myfti Haxhi Faik Hoxha, u ndërtuan 9 xhami në qytet dhe 38 në fshatra, u vunë në funksionim xhamitë që kishin mbetur pa u shkatërruar nga diktatura komuniste, u hap Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", në lagjen Dudas, si dhe u ndërtuan dy godina madhështore në lagjen Perash, dega e vajzave, aty ku ishte shtëpia e "Daut Boriçit", e ajo e djemve, në truallin e Xhamisë së Haxhi Bajramit. Në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", Haxhi Faiku dha mësimin e besimit, duke u bërë kështu një ndër aktivistët kryesorë dhe shembull i përhapjes së islamit në fëmijët e këtyre shkollave.

Me ardhjen e refugjatëve kosovarë gjatë luftës në Kosovë, Faik Hoxha ishte në ballë të organizi-



Njerëz të tillë në fushën e besimit islam dhe të atdhedashurisë, historia i radhit si figurat model cilësish mendore, shpirtërore, humane e qytetare...



mit të ndihmave dhe të sistemimit të familjeve kosovare në kampet e refugjatëve, të ngritura nga shoqatat e ndryshme dhe në familjet shkodrane. Qe pranë tyre që ata njerëz të shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre, ta ndjenin veten sa më të qetë në strehimet e reja të përkohshme dhe të kishin mundësitë e një jete sa më normale. Në çdo kamp u ngritën, në baza vullnetare, organizmat për ceremonitë fetare, u caktuan imamët dhe myeziniët provizorë dhe filloi jeta e rregullt fetare në kushtet e kampeve të improvizuara në zona të ndryshme të qytetit.

Faik Hoxha ishte njeri i veprimit dhe i sakrificës, i cili me entuziazëm dhe me besim të madh tek Zoti, nuk e ndjeu as moshën dhe as peshën e mundimit të viteve e të burgjeve komuniste, por gjithnjë me karakteristikat e një kuadri, kleriku dhe intelektualit të formuar e të talentuar në misionin e islamit, u tregua shembullor. Njerëz të tillë në fushën e besimit islam dhe të atdhedashurisë, historia i radhit si figurat model cilësish mendore, shpirtërore, humane e qytetare...

Stafi i revistës "Etika" shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjen dhe të afërmit dhe merr pjesë në dhimbjen e tyre. Nga ana tjetër, i drejtohet Zotit me lutje të sinqerta duke shpresuar prej Tij që ta presë Haxhi Faikun me mëshirë, falje e pëlqim dhe t'i dhurojë atij si shpërblim Xhenetin e Amshuar. Amin!

Mesazhet e katër halifeve me ardhjen në pushtet

Në këtë shkrim do të përcjellim në mënyrë të shkurtër dhe të përmbledhur disa ajete, në të cilat Allahu i madhëruar na urdhëron drejtësinë. Gjithashtu do të përcjellim mesazhet e katër halifeve me ardhjen e tyre në pushtet.

Allahu (xh.sh.), në Kuran thotë: ***“Allahu urdhëron për drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën... (Nahl, 90)***

“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj...” (Nisa, 135)

Në një hadith të transmetuar nga Myslimi, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Kushdo që merr pushtetin në dorë për të udhëhequr dhe nuk bën përpjekje maksimale për t’i shërbyer popullit, nuk do të hyjë në xhenet”*


FJALIMI I PARË I EBU BEKRIT (R.A.), NË PUSHTET

Ebu Bekri (r.a.), pasi mori votëbesimin, doli para njerëzve e u ligjëroi atyre, duke u thënë: *“O njerëz! Jam zgjedhur nga ju për të udhë-*

hequr këtë vend, por nuk e shoh veten si më të mirin ndër ju. Nëse do të më vëreni duke punuar mire, më ndihmoni e, nëse më shikoni duke vepruar keq, atëherë me drejtoni dhe më këshilloni. Singëriteti është amanet, kurse gënjeshtria është tradhëti. I dobëti në mesin tuaj është i fortë tek unë, për sa kohë që unë t’i garantoj atij të drejtën. Ndërsa i forti në mesin tuaj është i dobët tek unë, deri në çastin që t’i kthej hakun në emër të Zotit. Askush prej jush mos t’i shmanget luftëmbrojtjes, sepse sa herë që një popull i është shmangur luftëmbrojtjes, Zoti e ka goditur me nënçmim. Bindmuni mua, për sa kohë që unë t’i bindem Allahut dhe të Dërguarit të Tij e, nëse nuk i nënshtrohëm Zotit, mos m’u bindni.”

FJALIMI I PARË I OMERIT (R.A.), NË PUSHTET

Menjëherë pas zgjedhjes së tij si halife, pas ndërrimit jetë të Ebu Bekrit, Omeri (r.a.), u ngjiti në minber dhe tha këto fjalë: *“...O njerëz, ju zotëroni disa të drejta ndaj meje, të cilat mund t’i kërkon çdo herë. Një nga të drejtat tuaja është se, nëse ndonjëri prej jush vjen tek unë me ndonjë këkesë, ai të kthehet i kënaqur. E drejtë tjetër e juaja është që të më*



*“Allahu urdhëron për drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmeve,
dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën...”*

~ Nahl, 90 ~

ndaloni nga përdorimi jo i drejtë i pasurisë së Shtetit. Është po ashtu e drejtë e juaja që, në rast se shkoni në luftë, të kujdesem për familjet tuaja, ashtu si kujdeset babai juaj, kur ju nuk jeni të pranishëm. O njerëz, qëndroni të nënshtruar ndaj Allahut, më falni për gabimet dhe më ndihmoni në misionin tim. Më ndihmoni të urdhëroj në të mirë dhe të ndaloj nga e keqja. Më këshilloni në lidhje me obligimet e Allahut (xh.sh.). Shembulli i besimtarit është si shembulli i devesë së bindur që i bindet drejtuesit të saj. Le të shohë drejtuesi se nga po e drejton atë?! Përsa më përket mua, betohem në Allahun se do t’ju mbaj në rrugë të drejtë”.

FJALIMI I PARË I OTHMANIT (R.A.), NË PUSHTET

Othmani (r.a.), pasi mori votëbesimin e besimtarëve, u ngjiti në minber, dhe pasi falënderoi Allahun dhe Pejgamberin (a.s.), tha: “Jemi në një botë kalimtare. Përbusheni kohën tuaj që keni në dispozicion me mirësi e punë të mira sa të mundeni, ditë e natë. Kjo botë është mashtruese, prandaj s’duhet t’ju largojë nga premtimi i Zotit. Merrni mësim prej atyre që kanë kaluar para jush.”

FJALIMI I PARË I ALIUT (R.A.), NË PUSHTET

Aliu (r.a.), pasi falënderoi Allahun dhe Pejgamberin (a.s.), tha: “Allahu i Madhëruar zbriti librin (Kuranin) udhëzues për ne, në të cilin sqaroi të mirën dhe të keqen. Prandaj, merreni të mirën dhe largohuni nga e keqja. Përbushni detyrimet që keni ndaj Allahut, që të fitoni xhenetin. Allahu (xh.sh.), jua bëri të qarta ndalesat dhe ju kërkoi sinqeritet dhe unitet. Mysliman është ai, nga gjuha dhe dora e të cilit njerëzit janë të qetë... Ju jeni përgjegjës për vendin tuaj... Bindjuni Allahut dhe mos devijoni nga rruga e Tij. Nëse shikoni një të mirë, merreni atë dhe, nëse shikoni një të keqe, shmanguni prej asaj...”

I lutemi Zotit që e sotmja të jetë më e mirë sesa e djeshmja dhe e nesërmja e vendit tonë të jetë më e mirë se sa e sotmja!

I lutemi Zotit që udhëheqësve tanë t’u ndriçojë mendjet, t’u japë mirësi dhe urtësi!

I lutemi Zotit që çdo zgjedhje të jetë për të mirën e vendit dhe mbarë popullit shqiptar!

Urojmë që këto zgjedhje të bëhen në paqe dhe qetësi, ku secili të shprehë lirisht vullnetin e tij!

Zoologjia dhe shkencat e veterinarisë

Ma. Artur Tagani

Që në shekullin VIII zoologët e parë myslimanë, si **Ebi Nadir Ibn Shumaji**, **el-Esmail** dhe **Ebu Hatim es-Sixhistani** kanë shkruar vepra lidhur me këtë shkencë.

Zoologjia shkencore fillon me **en-Nadhdhamin** (vd.845) dhe **el-Xhahidhin** (vd.869).

Libri "**Kitabu'l-hajavan**" i **el-Xhahidhit** është vepër e shquar në fushën e zoologjisë. Ky libër u bë vepër burimore për shumë libra që do të vijjnë në vazhdim në këtë fushë. Kjo vepër nuk ka si temë vetëm përbërjen fizike dhe biologjike të kafshëve, por është një sociologji dhe psikologji e kafshëve. Më pas, edhe **el-Kindi** (vd. 866) është marrë me këtë shkencë, por akoma gjer më sot nuk është gjetur ndonjë vepër e tij, sado që pasardhësit e tij i përshkruajnë me ëndje. Më pas vijne shkencëtarët: **Ibn Kutejbe** (vd. 889), **Ihavan-i Safa** (shek. X), **Ibn Sina** (1037), **Biruni** (vd. 1051), **Ibn Baxhxhe** (vd. 1138) dhe **Ibn Rushd** (vd. 1198), të cilët i kanë ndarë një pjesë të mirë të studimeve të tyre edhe shkencës së zoologjisë.

Në shekullin XIV fillojnë të shkruhen vepra enciklopedike në fushën e zoologjisë. Njëra

prej këtyre është "**Kitabu'l-akval**", e jemenasit **Ali er-Resul**, vepër e cila përfshin të dhëna shkencore të fushës së zoologjisë dhe veterinarisë. Më pas vjen vepra e **Damiri-t** "**Kitabu'l-hajavan**" dhe me radhë, ed-**Dimeshki**, en-**Nuvejri**, el-**Xhildaki**, etj.

Veprat e këtyre që përmendëm më sipër janë më shumë për sëmundjet e kafshëve dhe shërimet e mundshme të tyre, ndërsa si specialistë të veterinarisë janë **Ibn Bajtari**, **Ibnu'l-Munzir**, **Ali Ibn Rabban et-Taberi**, **Isa Ibn Ali** dhe **Ibn Bahtishu**.

PËRBËRJA E SEDEFIT, SIPAS ED-DAMIRI-T (VD. 1405)

"Sedefi është një gjallesë deti...

Veçoritë: ecën përmes vibrimeve. Gjaku i zemrës dhe i mëlçisë së zezë është në ngjyrë të hapur. Shikon përmes ngjyrave të hapura. Sedefi është i përbërë nga përzierja e kolirumit." (Damiri, Hajatu'l-hajavan, përkth. anglisht, Jayakar, London 1908, v. II, fq. 144)

DISA SËMUNDJE TË BLETËVE, SIPAS IBNU' L-AVVAMIT (SHEK. XII)

Ekziston një sëmundje me emrin "Hassa", e



cila i zë edhe bletët më të shëndetshme. Është një krimb shumë i vogël në koshere, që bëhet shkak për këtë sëmundje. Ky lloj krimbi që shumohet shpejt, bashkë me krimbat e tij të vegjël, rrethojnë kosheren dhe hanë lëngjet e ëmbla të hojeve. Pjesa tretëse e krimbave bëhet shkak për sëmundjen e bletëve. Edhe sëmundja e fluturave vjen si pasojë e atyre lloj fluturave që ngordhin duke u djegur, ndërkohe që rrotullohen rreth qiririt. Kjo lloj fluturë, sikur të hyjë në koshere, prodhon disa pluhura të ngjashme. Një tjetër sëmundje për bletët është sëmundja e të rënit të fikët. Shkak për këtë sëmundje bëhen aromat e ndotura që vijnë nga jashtë. Fillimisht bletëve u bie të fikët, më pas vdesin... (Ibnu'l-Avvam, Kitabu'l-filaha, përkth. frëngjisht, Paris 1867, v. II, fq. 264)

PËRKUFIZIMI I LEOPARDIT, SIPAS IBN BAHTISHU-S (SHEK. X)

Leopardi është një armik i betuar i njeriut. Nuk i hahet mishi, është kafshë gabitqare. Ha vetëm gjahun e vet. Në kohët kur është i ngopur, fle tri ditë e tri net. Ditën e katërt zgjohet me një bërtitje të tillë, që kafshët e tjera i drejtojnë veshët nga ai. Një leopard i dobët, shëndoshet duke ngrënë minj arash. Lëkurën e ka të butë.

Mishi dhe dhjami i tij i valuar me lëng ulliri përdoren si ilaç për lungë dhe për puçrrat e ndryshme e, në veçanti, për ato që dalin gjatë

adoleshencës. Gjaku i tij përdoret si mbrojtës për të gjitha sëmundjet e lëkurës. Nëse pihet me ujë të ftohtë zifti i lëngët i përzier me lëngun e vrerit të leopardit, ndikon për mirë ndaj sëmundjeve të shpretkës dhe verdhëzës. (Ibn Bahtishu, Menafiu'l-hajavan, New York, Morgan Library, fq. 139)


SIMPATIA DHE ANTIPATIA MES GJALLESAVE, SIPAS XHABIRIT

Sipas **Xhabir Bin Hajjanit** (vd. 815), mes gjallesave (kafshë, shpendë e zvarranikë), ka një marrëdhënie simpati-antipati, siç ka mes njerëzve. Gjallesat që kanë simpati mes tyre, pra që shkojnë mirë, janë:

Mushka me luanin dhe gjarpri me dyzetkëmbëshin.

Ndërsa ato që nuk kanë marrëdhënie të mira, pra që kanë antipati janë:

Macja me ujkun, qeni me hienën, ujku me dashin, mushka me këlyshët e derrat, akrepi me hardhucën, gjarpri me kukuvajkën dhe hardhuca me shafranin. (Xhabir Bin Hajjan, Kitabu'l-havas, pj. I, fq. 18-26)



Ebu Hasan Eshariu

U lind në Basra, në vitin 260/873. Që në moshë të re u orientua drejt shkollës mutezilite, mësimet e së cilës i studion te njëri nga përfaqësuesit më të lavdishëm të kësaj shkolle, Xhubai (vdiq më 303/917). Deri në moshën 40 vjeçare ndoqi mësimet e shkollës mutezile dhe në tërë këtë periudhë i mbrojti doktrinat e kësaj shkolle, lidhur me të cilat shkruan edhe shumë punime. Kur mbush 40 vjeç, Eshariu mbyllet në shtëpi, ku vetmohet për dy javë. Prej aty del në Xhaminë e Madhe në Basra, në çastin kur njerëzit ishin tubuar për namaz. Aty shpall botërisht se braktis shkollën mutezile, për t'u lidhur pas parimeve të ehli sunetit dhe xhematit.

Ekzistojnë shumë shkaqe me të cilat biografët e kanë shpjeguar këtë kthesë spektakolare.

Pikë së pari, Ebu Hasan Eshariu qe ngopur me racionalizmin e ekzagjeruar të dijetarëve mutezili në lidhje me perceptimin e Zotit dhe të shpëtimimit të njeriut. A thua Zoti nuk ishte shndërruar në abstraksion të pastër, që nuk ka lidhje me botën dhe njeriun? Cili është kuptimi dhe domethënia metafizike e njohjes dhe adhurimit të njeriut, nëse ajo është përcaktuar me faktin e thjeshtë të shkakut në krijim?

Gjatë periudhës së vet mutezilije, si edhe pas konvertimit të vet, Eshariu ka shkruar vepra të shumta. Sipas fjalëve të tij, ka hartuar së paku 90 vepra, të cilat përfshinin dijen e tërësishme teologjike të asaj kohe. Ka shkruar komentin e Kuranit. Ka hartuar përmbledhjen që merrej me sheriatin, përmbledhje me hadithe dhe rrëfime;

trajtesa kundër materializmit, harixhive dhe, pas konvertimit, vepra kritike kundër mutezilëve. Ndër veprat e ruajtura të tij, dy janë më të rëndësishmet, Makalatu'l-islamijin dhe Ibane.

Në veprën Makalatu'l - islamijin, Eshariu i shtron objektivisht të gjitha mësimet që njiheshin në atë kohë. Kjo trajtesë mund të konsiderohet një prej përmbledhjeve më të rëndësishme të historisë së dogmave, aq më tepër, e para e këtij lloji në historinë e mësimet dhe dogmave në islam. Ajo ka tri pjesë: e para përmban ekspozimin e hollësishëm të sekteve dhe mësimëve të ndryshme islame; e dyta ekspozon rrugën "e njerëzve të hadithit", literalistëve, ndërkaq pjesa e tretë dhe e fundit, ka të bëjë me degët e ndryshme të kelamit.

Sa i përket veprës së dytë, Ibane, ajo shtron mësimin e Islamit sunnit. Vepra fillon me lavdërimin e Ibn Hanbelit (themeluesit të shkollës juridike hanbelite, që vdiq më 241/855). Pastaj pasojnë, pa ndonjë rend të përcaktuar, temat e ndryshme teologjike, të zbërthyer në dritën e orientimit të ri të autorit. Nëse me siguri mund të thuhet se vepra e dytë është e shkruar në periudhën e dytë të jetës së Eshariut, këtë nuk mund ta pohojmë edhe përtë parën.

Eshariu vdiq në Bagdad, më 324/935.

Në sistemin e Eshariut dominojnë dy tendenca, të cilat në shikim të parë janë kundërthënëse, kurse në fakt plotësojnë njëra-tjetrën. Nga njëra anë, ai duket aq i afërt ndaj kësaj apo asaj shkolle juridike të Islamit, sa ka mundur të po-

hohet që herë ishte shafii, herë ishte maliki ose hanbeli. Nga ana tjetër, është evidente matura e tij, pasi ai dëshironte para së gjithash t'i pajtonte shkollat e ndryshme sunitë, të cilat i dukeshin se ishin në pajtim në aspekt të parimeve, por ndaheshin vetëm në çështjet e aplikimit të tyre.

Eshariu nuk e refuzon vlefshmërinë e dëshimit racional, siç e kanë bërë këtë literalistët. Por nëse nuk pranon se përdorimi i dëshimit racional është herezi, nuk shkon deri aty sa arsyen ta konsiderojë kriter absolut, para fesë dhe të dhënave themelore fetare.

Eshariu pohonte se qenia e Zotit zotëron Atributet dhe Emrat që theksohen në Kuran. Ata Emra dhe Atribute kanë njëmendësinë pozitive, por janë të ndryshëm nga esenca, dhe megjithatë, jashtë saj nuk kanë as ekzistencë as njëmendësi. Këtu Eshariu, nga njëra anë e dallon atributin si koncept dhe, nga ana tjetër, mendon se dyjësia ndërmjet qenësisë dhe atributit duhet vendosur në rrafshin cilësor dhe jo në atë sasior.

Kur Kurani dhe disa hadithe e paraqesin hyjinë në formën antropologjike (Zoti ka duar, fytyrë, ai ulet në Fron etj.), sipas mendimit të mu'tezilitëve, kjo ka të bëjë me metafora. Dora metafizikisht tregon fuqinë; fytyra tregon qenësinë, ulja e Zotit në Fron është pasqyra metafizike e sundimit të Zotit etj. Këto fenomene, literalistët i konsiderojnë të njëmendta, që i përkasin Zotit.

Ato duhen konsideruar si të tilla dhe ashtu duhen perceptuar. Eshariu pajtohet me literalistët në aspekt të njëmendësisë së atyre fenomeneve që lidhen me Zotin, por ai tërheq vërejtjen kundër çdo domethënieje trupore materiale, kur ato i përshkruhen Zotit. Ai thotë se myslimani duhet të besojë se Zoti ka duar, fytyrë etj., por, "duke mos pyetur si" (bi-la kejfë).

Mutezilët kanë predikuar se Kurani është fjalë e krijuar e Zotit dhe nuk e kanë dalluar fjalën si atribut të amshueshëm hyjnor nga thënia arabe që e paraqet në Kuran. Këtë mënyrë këndvështrimi literalistët e kanë refuzuar kategorikisht. Ç'është më e keqja, disa prej tyre kanë pohuar se në Kuran është e amshueshme, jo vetëm përmbajtja dhe fjalët që e përbëjnë, por edhe ajo që

materialisht e krijon, për shembull faqet, ngjyra, kopertinat etj.

Eshariu ndërmjetëson mes këtyre dy skajshmërive. Ai mendon se natyra e fjalës, qoftë njerëzore, qoftë hyjnore, nuk reduktohet me atë që është thënë dhe përbëhet nga zërat dhe fjalët e artikuluar, siç mendojnë mutezilët. Ajo është thënie e shpirtit (hadith nefsi), dhe me këtë është e pavarur nga çdo manifestim verbal (hadith lafdhi).

Kur thuhet se Kurani është i amshueshëm, me këtë nënkuptohet atributi hyjnor i kelamit, i cili vazhdimisht mbijeton në Zotin, dhe i cili, si i tillë, është i lirë nga çdo artikullim verbal dhe i zëshëm. Por Kurani po ashtu, është i sajuar prej fjalëve. Ai është i shkruar. Nga ky aspekt,

Kurani është fakt i krijuar kohor.

Eshariu nuk i afrohet nocionit të kudret-it (fuqisë krijuese) në kuptimin mutezili, por nocionit kesbe (arritjes). Eshariu mendon, jo pa arsye, se postulati mutezili fut një lloj dualizmi në raport me veprimtarinë hyjnore. Në të vërtetë, sipas mutezilëve, njeriu nuk është vetëm i lirë dhe përgjegjës; pos kësaj, ai zotëron kudretin, d.m.th. fuqinë krijuese, aftësinë e krijimit të veprave personale. Kështu, ai nuk i ekspozohet rrezikut të ndikimit të ndonjë fuqie tjetër krijuese, pos asaj hyjnore, por duke ia ndarë njeriut lirinë, e cila e bën përgjegjës për veprat e veta. Eshariu i jep njeriut, jo kudretin, krijimin e veprave të veta, por kesbin, "arritjen" e veprave të veta. Ai lejon dallimin që zbatonjë mutezilët ndërmjet dy llojeve të aktiviteteve të njeriut: aktivitetit të detyrueshëm dhe të lirë. Në mënyrë të njëjtë lejon edhe postulatit e tyre se njeriu është krejtësisht i vetëdijshëm për dallimin. Por mendon se kudreti, fuqia krijuese e veprave njerëzore, është e jashtme për njeriun. Po ashtu, në çdo vepër të lirë të njeriut Eshariu dallon aktin e krijimit, i cili është kontribut i Zotit, dhe aktin e arritjes, fitimit, i cili është kontribut i njeriut. E tërë liria e njeriut konsiston në bashkëveprimin e Zotit "krijues" dhe njeriut "fitues".

Në të gjitha zgjidhjet që ofron, Eshariu nuk udhëhiqet aq shumë nga nevojat spekulative dhe Racionale, sa nga motivet shpirtërore dhe religjioze. Ajo, ndaj së cilës priret më shumë, është

të njohja e besimit në Zotin, në një Zot, shenjat e të cilit nuk janë të zbrazëta, sepse ai njëkohësisht është qenësi dhe atribut, dhe sipas kësaj, mund të jetë objekt i adhurimit dhe dashurisë së besimtarit.

Nga mesi i shekullit IV/X, shkolla esharije u forcua nga nxënësit e drejtpërdrejtë të Eshariut. Me shekuj të tërë kjo shkollë pothuajse ka mbizotëruar, madje në disa epoka dhe në disa fusha esharizmi ka qenë i identifikuar me sunizmin.

Nga fundi i jetës së vet, Ebu Hasan Eshariu ka mundur të shohë se si tubohen rreth tij nxënës të shumtë, të cilët janë mahnitur me jetën shembullore të tij, mendimin e tij të përshkruar me vlera religjioze dhe me përpjekjen e tij që t'i ruante ato. Ai njëkohësisht ka shërbyer si strehim kundër literalizmit të ngushtë dhe kundër racionalizmit ekzagjerues të mutezilëve. Kështu, esharizmi ka filluar të marrë trajtë gjatë jetës së themeluesit.

Porsa esharizmi u formësua qartë krahas shkollave të tjera të atëhershme, ai u bë cak i shumë sulmeve. Para së gjithash, mutezilët e kanë akuzuar shkollën esharite se me oportunizmin e vet u bën lajka masave, ndërsa literalistët, me hanbelitët në krye, janë habitur duke e parë se Eshariu nuk ka pasur guximin që thjesht t'u kthehej burimeve, me fjalë të tjera, tekstit të shpallur dhe traditës fillestare. Në të njëjtën kohë kur në Basra dhe në Bagdad Eshariu bëhet i vetëdijshëm për problemet me të cilat ballafaqohet islami dhe tenton t'i zgjidhë ato, një dijetar tjetër, Ebu Mansur Maturidiu (vdiq më 333/944, në Samarkand), ofron këndvështrime të reja për zgjidhjen e këtyre debateve fetare. Nxënësit e Ebu Mansur Maturidiut e shikonin Eshariun dhe platformën e tij si një reformë të pasuksesshme, duke kritikuar konservatorizmin dhe konformizmin e saj.

Por me të gjitha kritikën drejtuar esharizmit fillestar, shkolla zhvillohet dhe zgjerohet dhe me kohë bëhet komentuese e besimit sunit në pjesën më të madhe të botës myslimane. Nga mesi i shekullit V/XI, lëvizja pushon së përparuari dhe has në vështirësi. Princat iranianë të dinastisë bujide janë sundues të vërtetë të mbretërisë abasite. Por ata janë shii. Kur princat selxhukë

turq, të përkatësisë sunite e fitojnë sundimin, situata ndryshohet.

Esharizmi e fiton sërish vendin e vet të privilegjuar në shoqërinë sunite myslimane. Shkollën madje e përkrah edhe pushteti zyrtar e veçan, veziri i famshëm selxhuk Nidhamulmulku (vdiq më 485/1093).

Nidhamulmulku themelon dy universitete të mëdha, në Bagdad dhe në Nishapur. Mësimi i vetëm i lejueshëm në këto dy institucione është esharizmi, i cili atëherë bëhet mësimi zyrtar i mbretërisë abasite. Në atë kohë përfaqësuesit e tij u bënë edhe komentues të vetë mësimi sunit.

Në këtë situatë, esharitët filluan sulmin kundër sekteve dhe mësimëve që nuk kanë qenë në pajtim me pikëpamjet e tyre, jo vetëm në planin ideologjik, por edhe në planin politik.

Ofensiva e Gazaliut kundër "batinive" (ezoterizmit ismailit) dhe kundër filozofëve njëkohësisht, është betejë e drejtuar kundër pushtetit fatimi në Kajro.

Në shekullin VII/XIII esharizmi fiton kundërshtarë në personalitetin e Ibn Tejmijes dhe të nxënësit të tij Ibn Kajim Xhevziu, që të dy nga Damasku. Ibn Tejmije e konteston esharizmin për reformën e tij në mendimin sunit.

Ndër figurat e mëdha që e zhvilluan shkollën esharite, duhen përmendur Ebu Bekr el-Bakilani (vdiq më 403/1013), autori i Kitabu't-Temhid, përpjekja e parë që esharizmit t'i jepej një sistemim i mirëfilltë doktrinor; Ibn Furaku (vdiq më 400/1015); Ebu Ishak Isfaraini (vdiq më 418/1027); Abdulkahir ibn Tahir Bagdadi (vdiq më 429/1037); Ebu Xhafer Ahmed ibn Muhamed Simnani (vdiq më 444/1052); Imamu'l-Haremejn Xhujejni, (vdiq më 478/1085), vepra me titull Kitabu'l-Irshad që konsiderohet forma e përfunduar e esharizmit, Gazaliu (vdiq më 505/1111), Ibn Tumarti (vdiq më 524/1030); Shehrestani (vdiq më 548/1153); Fahrudin Raziu (vdiq më 606/1210) dhe Xhurxhani (vdiq më 816/1413).

Esharizmi jo vetëm që u ka mbijetuar të gjitha kritikave, por arriti të siguronte edhe pozitë të rëndësishme në Islam sunit, veçanërisht në Lindjen e Afërt.

Dy ndërtime të sulltan Sulejmanit në Vlorë: Kalaja dhe Xhamia Muradije

Në shek. XVI kishte përfunduar ndërtimi i sistemit të fortifikimit nga ana e turqve dhe ishin ngritur një sërë qendrash të reja administrative. Ndërtimi i fortesave vazhdoi në ato zona ku kishte trazira, kryesisht në afërsi të bregdetit. Në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XVI u ndërtua një sistem fortifikimi pranë detit Jon, ndërsa në vitin 1574, kështjella e Ishmit në veri të Durrësit. Kështjellat osmane të kësaj periudhe ishin ndërtuar për të përmbushur detyra lokale përballë një armiku të paarmatosur. Në këtë kuptim, ato qëndronin larg fortesave për artileri të mesit të shek. XV.

Një përjashtim bën kështjella e Vlorës, e ndërtuar nga sulltan Sulejmani në vitin 1531, për ta pasur atë si bazë ushtarake dhe kantier ndërtimi anijesh, për zbarkimin e tyre në Pulja të Italisë. Kështjella ndodhej pranë skelës së sotme të qytetit, rreth 150 m larg bregut të detit. Ajo ka pasur formën e një tetëkëndëshi të rregullt me gjatësi brinjësh 90 m dhe një sipërfaqe prej 3,5 ha. Muret rrethoheshin nga një hendek i mbushur me ujë, që kishte një gjerësi prej 30-40 m. Ky hendek që rrethonte kështjellën nga ana e tokës, lidhej me detin nëpërmjet dy mëngëve.

Muret, të punuara me gurë të latuar, kishin një gjerësi prej 5,60 m dhe lartësi rreth 15 m. Kështjella ishte e pajisur me kulla poligonale e drejtkëndëshe, me ura të lëvizshme para hyrjeve dhe me një kryekullë pranë murit, që

shihte nga deti. Kjo e fundit ishte një kullë cilindrike masive, që mbizotëronte mbi gjithë ndërtimet e tjera me lartësinë e saj të madhe. Kulla ishte 7-katëshe dhe mbulohej me një kuppulë të veshur me plumb mbi një tambur të ulët poligonal. Brenda kullës gjendeshin magazina dhe banesa e komandantit të kështjellës. Ajo ishte e ngjashme me kullën e bardhë të Selanikut, Kullën e Rumeli-Hisarit dhe kullën qendrore në Kastel de Mare në Modon. Kështjella e Vlorës, ishte pa dyshim një nga ndërtimet ushtarake më të arritura të Perandorisë Osmane. Udhëtari osman i shek. XVII, Evlia Çelebiu, shkruan se "ata që s'kanë parë fortesat e Sekedinit, Benderit dhe Vlorës, nuk kanë dijeni mbi mjeshtërinë e osmanëve". Çelebiu thotë gjithashtu se, arkitekt i kështjellës së Vlorës ishte Sinani, autori i kullës së bardhë të Selanikut.

Kalaja e humbi rëndësinë e saj dhe, që gjatë viteve të fundit të sundimit osman, gurët që kishin mbetur prej saj, u përdorën për kryerjen e disa punëve botore pa rëndësi. Sot ajo nuk ekziston më.

Faltoret e para të kultit islam ishin në stil të importuar, por shumë shpejt filloi të ndihet në to ndikimi i arkitekturës vendase. Duke ruajtur të njëjtën ide arkitekturore (planimetrike e vëllimore), që lidhej me destinacionin e këtyre ndërtimeve, hetohen dhe veçanti që vërehen shpeshherë në trajtimin dekorativ të fasada-



ve, në futjen me vështirësi të disa elementëve ndërtimorë e zbukurues, si harku, në formë lundre etj. Me kalimin e kohës këto dallime thellohen, duke u shtrirë deri diku edhe në formulimin e shtrirjes planimetricke. Ato harmonizohen gjithnjë e më tepër me arkitekturën popullore dhe ansamblet e qyteteve tona mesjetare. Elementë të arkitekturës popullore fillojnë të futen në objektet e kultit edhe në gdhendjen e elementëve prej druri të interierëve etj.

Xhamitë e para shërbenin për garnizonet ushtarake dhe ndërtoheshin mbi portat e kështjellave, siç qenë ato në kështjellën e Elbasanit, Tepelenës, Bashtovës etj., që ishin të thjeshta si ndërtesa dhe mbulohehin me çati druri.

Por, duke filluar që nga vitet e fundit të shek. XV, kristalizohet një arkitekturë e mirëfilltë në ndërtimin e xhamive. Nga ana tipologjike ato mund të ndahen në dy grupe të mëdha. Ato të tipit me çati druri (Berat, Elbasan, Gjirokastrë) dhe të tipit sallë me kupolë, shembulli i parë

i të cilave është xhamia e Mirahorit në Korçë, e ndërtuar në vitin 1494. Pothuajse të gjitha xhamitë kanë qenë pajisur me portikë. Fillimisht portikët ndërtoheshin me mure guri të mbuluara me qemere e kupola, si në xhaminë e Mirahorit (Korçë), sipas modeleve të xhamive të Stambollit. Por gjatë shek. XVII e sidomos në shek. XVIII-XIX, përdoren gjithnjë e më shumë hajatet me strukturë druri, që zinin sipërfaqe të mëdha (Kavajë, Berat, Tiranë). Hapësira e brendshme e xhamive ishte me shumë dritë, muret dhe kupolat ishin shpesh të mbuluara me piktura murale.

Për vlerat e tyre arkitektonike dhe dekorative dallohen xhamia e Mirahorit 1496 (Korçë), Xhamia e Plumbit 1553-1554 (Berat), xhamia e Muradijes, shek. XVI (Vlorë), xhamia e Ethem Beut 1794 (Tiranë), Xhamia e Plumbit 1773-1774 (Shkodër), xhamia e Daut Pashës 1605 (Prizren), Xhamia Mbret, fundi i shek. XV (Elbasan), xhamia e Nazireshtës 1600 (Elbasan), xhamia e Gjin Aleksit shek. XV (Delvinë), xhamia e Allajbegisë shek. XVI (Peshkopi), Xhamia e Beqarëve shek. XVIII (Berat), kompleksi i Xhamisë dhe i Sahatit në Peqin, 1820 etj.

Vendosja e pushtetit osman mbi hapësirat shqiptare, shënoi mbylljen e një periudhe të gjatë arkitektonike me tiparet e veta specifike në gjininë e ndërtimeve të kultit të krishterë. Kjo traditë e lashtë në arkitekturën e ndërtimeve të kultit të krishterë, rishfaqet në momentin e volitshëm.

Në këtë periudhë trashëgohen mjaft parime figurative dhe konstruktive të ndërtimeve bizantine, por me një interpretim më të lirë të tipave dhe formave, në përputhje me rrethanat e reja ekonomiko-shoqërore, duke ndjekur një rrugë të vetën të zhvillimit dhe duke arritur shpeshherë në konceptime arkitektonike të veçanta.

Ngado që të shkosh në Vlorë, nuk mund t'i shmangesh xhamisë së Muradies. Gjendet para shtëpisë së Vlorajve dhe dikur, dhe ajo është quajtur prej kupolës, Xhamia e Plumbit.

Më vonë mori emrin e lagjes. Xhamia e Muradies u transformua në një vend kukullash. Ishte vendi i teatrit të kukullave për Vlorën. Që nga ajo kohë, xhamisë i shtuan hekurat, që ta ruanin nga keqbërësit.

Përballë portës së hyrjes për në sallën e lutjeve, tashmë është një hapësirë e tërë bosh. Mihrabi, me prerje gjysmërrethi, përballë, dekoruar me stalaktite në pjesën e sipërme dhe i rrethuar nga një kornizë drejtkëndore, të bën me shenjë. Në faqen veriore kanë mbetur vetëm dy dritare, ndërsa faqet e tjera kanë nga pesë dritare të vendosura me tri radhë. Dy dritaret e poshtme janë shumë më të mëdha se të tjerat. Ka hark të mprehtë në formë fundlunde, të ndërtuar me gurë të skuadruar në formë pyke, që këmbehen me nga dy tulla, nuk lejon më shumë. Harku rrethohet nga një shirit tullash pak të gdhendura, për tu dukur më të holla. Edhe dy dritaret e rreshtit të sipërm kanë forma të njëjta, por janë më të vogla.

Tërheqja kryesore është minarja. Bazamenti shumëfaqësh, i ndërtuar me gurë të punuar, ku pjesa kalimtare; trung piramide dhjetëfa-

qësh, po me gurë të punuar, trupi i minares katërbëdhjetëfaqësh me gurë të punuar e fuga të holla, kazani me stalaktite në pjesën e poshtme dhe përfundimi i minares. Nga saktësia e ndërtimit, edhe më i pagdhenduri e shikon se Minarja e xhamisë së Muradies është shumë cilësore. Mënyra e njëtrajtshme e ndërtimit me gurë të gdhendur, e bën atë të duket një cope. Në mënyrë të veçantë bie në sy puna e mirë e ndërtimit, me gurë të punuar në formë stalaktitesh e pjesës së nxjerrë konsol të kazanit, një ndër shembujt më të arritur në vendin tonë. Pjesa e ulët mbi kazan nuk është në nivel të njëjtë ndërtimi me trupin e minares dhe kazanin, çfarë i shtyn studiuesit të mendojnë se duhet t'i takojë ndonjë ndërtimi. 100 metra më tutje duket një nga shtëpitë më të bukura në Vlorë.

Monumenti islamik ka vuajtur. Në kohë të shkuara, në këtë vend punonin një grup piktorësh dhe skulptorësh dhe pastaj atë e kthyhen në një teatër kukullash. Sot pret që dikush të vërë vetëm pak dorë, që të restaurohet që t'u bëjë ballë viteve që kalojnë dhe rëndojnë mbi moshën e saj.





Edukimi i fëmijëve

Fëmijët, një nga mirësitë e mëdha që na ka dhuruar Allahu, janë amaneti i prindërve. Fëmijët janë dhuruar nga Allahu si një gjë e shtrenjtë dhe e shenjtë, si një xhevahir i pastër.

“O ju që besuat! Ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëj të rreptë dhe të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë, që Ai i urdhëron dhe bëjnë atë që janë urdhëruar. (El Tahrim: 6)

Prindërit duhet t'i mbrojnë fëmijët e tyre nga zjarri i xhehenemit, sepse është më i rëndë se zjarri i dynjasë. T'i ruash fëmijët nga zjarri i xhehenemit, do të thotë t'i ruash ata nga harami, t'u ruash imanin (besimin e tyre) për t'u mësuar adhurimet dhe për të pasur kujdes që të mos i lënë të shoqërohen me shokë të këqinj, sepse fillimi i çdo të keqeje buron nga shoku i keq.

Prindi, i cili nuk i mëson fëmijës së vet se kush është Allahu dhe Pejgamberi, që nuk i ngjall dashurinë ndaj Tyre, konsiderohet si katili i fëmijës së tij në këtë dynja dhe në dynjanë tjetër.

Një tjetër gabim i madh është koha e namazit, kur prindi nuk e zgjon fëmijën e tij, me pretekstin se do të ketë të ftohtë apo nuk do të ngopet me gjumë. Atëherë prindërit le të mendojnë pak doktorin që ka përballë një fëmijë që do ta operojë e për shërimin e fëmijës nuk merr parasysh asgjë dhe merr thikën që ky fëmijë të bëhet më mirë dhe të arrijë shëndetin e plotë. A thua vallë nuk ka mëshirë? A konsiderohet kjo mëshirë? Jo, sepse qëllimi i këtij doktori është më i rëndësishëm. Nëse prindërit do të kishin mëshirë, do t'i mësonin fëmijës së tyre fenë, pastaj dijet e tjera që i përkasin kësaj dynjaje. Nëse bëjnë të kundërtën dhe i mësojnë fëmijës sesi fitohet më shumë para në këtë dynja, atëherë ata janë më të pamëshirshmit e të pamëshirshmëve.

Duhet theksuar se, të kesh mëshirë për fëmijën, do të thotë të kesh mëshirë për veten tënde, sepse prindërit janë përgjegjës dhe do të japin llogari para Allahut për mësimet që u kanë dhënë fëmijëve të tyre. Prandaj, nëse i mësojnë në rrugë të drejtë të islamit, atëherë edhe ata vetë kanë shpëtuar nga zjarri i xhehenemit.

Të rritësh një fëmijë pa edukatën dhe dijen islame, është njësoj sikur të rritësh një pemë që e përgatit për ta ndezur në sobë.

Duhet falënderuar Allahu për mirësitë që na ka dhënë. Nëse nuk e falënderojmë në kohë, na e merr nga dora. Një nga mirësitë më të mëdha që Allahu i ka dhënë njeriut, është fëmija dhe, në qoftë se nuk u mësojmë fëmijëve tanë çështjet e fesë dhe edukatën islame, ne nuk kemi falënderuar Allahun për këtë mirësi që na ka dhënë. Në veçanti kemi tradhtuar amanetin e Tij, sepse Allahu na i ka lënë amanet fëmijët. Ai na mbroftë nga tradhtimi i amanetit dhe nga mosmirënjohja ndaj të mirave të pafundme të mirësive të Tij.

Edukimi i fëmijëve duhet të fillojë që në moshë të vogël (tre vjeçare), sepse më i vogël nuk arrin të kuptojë. Është më e lehtë të rritet e shëndetshme bima, nën shërbim dhe mbikëqyrje që në filiz. Kur rriten egërsohen, çdo gjë është më e vështirë.

Nuk i shkon bosh munda prindit që është i kuptueshëm më fëmijën e tij dhe që përpiqet ta çojë në rrugë të drejtë. Para së gjithash, fëmijës i duhet bërë e qartë ekzistenca e Allahut, madhështia e Tij, mirësitë e Tij, si ushqimi, mendja, koha etj.

Fëmijët duhen mësuar me dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe t'i duan Ata më shumë se çdo gjë tjetër. Nga një zemër që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij, nuk pritet veçse mirësi.

Fëmijëve duhet t'u tregojmë për sakrificat që ka kaluar Pejgamberi (s.a.s.), për të përhapur fenë islame, për moralin e tij të lartë etj.

Pejgamberi (s.a.s.), në një hadith thotë:

Çdo fëmijë lind mysliman, por pastaj jahudia e bën jahudi, i krishteri të krishterë.

Ndjenja e besimit dhe dashuria për Allahun, që në moshë të vogël, i bëjnë njerëzit më të sigurtë, më të vendosur, më të fortë, më të mbrojtur. U jep forcë për t'u përgatitur më mirë për jetën.

Prindërit kanë përgjegjësi para Allahut për t'i mësuar dhe përgatitur fëmijët e tyre me fenë e Allahut.

Pejgamberi (s.a.s.), ka thënë:

"O umeti im! Ju jeni të gjithë çobanë. Çdo pjesëtar i familjes është i detyruar të zbatojë disa detyrime ndaj tjetrit."

Burri është përgjegjës për të ardhurat, edukimin dhe mësimin sipas fesë islame, për fëmijët e tij. Gruaja është përgjegjëse të ruajë amanetin dhe t'i edukojë fëmijët sipas islamit. Ta përmbushë amanetin e dhënë.

Amaneti duhet përdorur me kohë dhe me vend e, nëse bëhet e kundërta, atëherë e tradhton atë. Në lidhje me këtë, Allahu (xh. sh.), ka thënë në shumë ajete :

"O ju që besuat! Mos e tradhtoni Allahun dhe të dërguarin e, ashtu amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo." (En Fal,27)

"Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre, kur të gjykoni drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni." (Nisa, 58)

"dhe ata, të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë." (Muminun, 8)

Çdo gjë që është urdhëruar dhe ndaluar nga Allahu, është amanet për ne. Dhe çdokush që e përmbush këtë amanet në vendin dhe në kohën e duhur, konsiderohet i devotshëm.

H. Enesi (r.a.), tregon se, kur sahabët e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut: "Kush është më i afërti i tij?" Muhamedi (a.s.), ka thënë:

"Unë jam i prijësi i çdo besimtari."



Alkooli shkakton kancerin



Doktori i famshëm australian Prof. Ian Olver, deklaroi se alkooli nxit kancerin, po aq sa duhani. Ndërsa Këshilli Australian i Kancerit theksoi faktin se “edhe përdorimi i pakët i alkoolit i hap rrugën sëmundjes së kancerit”.

Sipas studimit të bërë nga Këshilli Australian i Kancerit, shumica e grave që përdorin alkoolin sëmurën me kancerin e gjirit. Po sipas këtij studimi, përdorimi i alkoolit e rrit deri në pesë herë rrezikun e sëmundjeve kan-

ceroze. Ata shprehen se kanë prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë ndikimin e alkoolit në kancerin e gojës, fytit, gurmazit dhe ezofagut.

Prof. Ian Olver shprehet se pasojat e alkoolit janë më të mëdha se ç’mendohet dhe se çdo vit në Australi, rreth pesë mijë persona sëmurën me kancerin që ka lidhje direkt me alkoolin. Kemi provuar se lëndët kimike që përmban alkooli dëmtojnë qelizat e trupit të njeriut. Ndërsa qelizat e dëmtuara shkaktojnë anomali në gjene dhe si pasojë bëhen shkak i kancerit.

Një tjetër e vërtetë, e cila u zbulua në sajë të këtij studimi, është se pirja e një sasive të vogël vere nuk ndihmon në parandalimin e sëmundjeve të zemrës. Ndërsa në revistën mjekësore Australiane “Medical Journal of Australia”, shkruhej se pretendimi i disave se pirja e verës parandalon sëmundjet e zemrës, është veçse një ekzagjerim dhe asgjë tjetër. Një studiues tjetër, Todd Harper, tha se shumica e njerëzve nuk dinë asgjë rreth lidhjes së alkoolit me kancerin. Gjithashtu, studiuesit e tjerë u shprehën se pas lënies së alkoolit, në trupin e njeriut fillojnë të duken shumë përmirësime.


Prodhohet veshkë në laborator

Shkencëtarët scocezë arritën të prodhojnë veshkën njerëzore në kushte laboratorit me anë të qelizave embrionale. Ky zhvillim i ri hapi një derë shprese për të gjithë ata që presin radhën për transplantim veshke.

Specialistët e Universitetit të Edinburgut në Skoci, theksuan se veshka e prodhuar është vetëm pesë milimetra, pra në të njëjtën madhësi me veshkën e një fetusit. Por nëse do të arrijnë të kryejnë transplantimin në trupin e njeriut, veshka do të arrijë përmasat normale.

Veshka është prodhuar nga qelizat e lëngut amniotik që mbështjell fetusin në mitrën e nënës dhe prej qelizave të fetuseve të kafshëve. Në të ardhmen, lëngu amniotik do të merret që në çastin e lindjes dhe do të ngrihet për t’u përdorur më vonë në raste të shqetësimave të veshkës.

Prof. Jamie Davies, i cili kryeson ekipin kërkues, tha: “Tani jemi duke studiuar qelizat që notojnë në lëngun amniotik, me qëllim që të kuptojmë se si mund të prodhojmë një veshkë të plotë. Në këtë çështje kemi përparuar shumë. Deri tani prodhuam një veshkë që kryen të njëjtin fun-



ksion tek fetuset. Por ende nuk kemi arritur të prodhojmë një veshkë që të funksionojë tek të rriturit”.

Davies, ndër të tjera tha se brenda dhjetë vjetëve do të jetë e mundur që teknologjia e qelizave embrionale të përdoret tek njerëzit. Më parë, shkencëtarët amerikanë provuan se si një veshkë e një fetusit kafshe arriti madhësinë normale pasi ishte transplantuar tek një kafshë e rritur. Ndërsa, disa javë më parë, është deklaruar se në laboratorin e Universitetit të Minnesotës në SHBA, është prodhuar zemër njeriu.

Telefonët mobilë do të rimbushen me anë të zërit



Në të ardhmen telefonat mobilë do të rimbushen në çastin që ne jemi duke folur. Këtë lajm e bënë të ditur disa studiues, të cilët po kryejnë kërkime për mënyrën e rikarikimit të baterive me anë të zërit. Kjo do të bëhet e mundur nga një lloj teknologjie, e cila do ta kthejë zërin në energji elektrike, në sajë të telave të zinkut që do të vendosen midis dy elektrodave. Ndërsa një platformë që do të thithë zërat, do të tendosë dhe lëshojë kabllot e zinkut prej nga do të prodhohet energjia.

Dr. Sang Woo Kim, i cili po punon vazhdimisht për të projektuar këtë teknologji të re në institutin e nanoteknologjisë të Universitetit Sungkyunkwan në Seul, shprehet: *"Deri më sot e kemi anashkaluar burimin e energjisë së mjedisit. Prandaj tani po kërkojmë mënyrat e kthimit në energji të zërit tonë, muzikës ose thjesht zhurmave të ndryshme"*. Ndër të tjera, Dr. Kim thotë se, në sajë të teknologjisë së re, do të bëhet e mundur që zhurma e madhe që krijohet nëpër autostrada të kthehet në energji të dobishme.

Por kjo teknologji mund të ketë edhe disfavoret e saj. Njëra nga këto mund të jetë edhe sasia e energjisë, e cila do të prodhohet në bazë të fuqisë së zërit. Kjo do të ishte një shkak i mjaftueshëm që njerëzit të flisnin duke bërë turr.


Kompjuteri dhe telefoni - letër

Kërkimet e reja nanoteknologjike na lajmërojnë se në të ardhmen telefonat dhe kompjuterat tablet do të jenë të hollë dhe të përthyeshem si një letër.

Universiteti Queen's i Ontarios së Kanadasë, në bashkëpunim me Universitetin e Arizonës në SHBA, kanë arritur të prodhojnë një prototip telefoni të hollë dhe të përthyeshem si një letër, të cilin e kanë quajtur "PaperPhone".

PaperPhone, që ka marrë edhe nofkën "iPhone, i përthyeshem", është 9,5 cm, ka formë drejtkëndëshe dhe përbëhet nga një ekran E-Ink i përthyeshem. Në panelin teknologjik E-Ink, i cili funksionon pa pasur nevojë për dritë në sfond, janë përdorur grimca të ngarkuara që pasqyrojnë dritën dhe ndryshojnë pozicionin me fushën elektrike. Ky kompjuter, i cili mund të përdoret në të gjitha kushtet, futet lehtë edhe në xhep.

Roel Vertegaal prej Universitetit Queen's, i cili foli për zhvillimin e kësaj teknologjie, ndër të tjera u



shpreh: *"Ky është kompjuteri i së ardhmes. Brenda pesë vjetëve të gjithë kompjuterat do të fillojnë të prodhohen me këtë teknologji. Ata do të duken si një letër e vogël interaktive që ndjen dhe punon. Përveç se mund të përdoret si telefon mobil dhe kompjuter tablet, ai mund të përthyeshet dhe mbi të mund të shkruash"*.

Kompjuteri letër u prezantua në 10 Maj në konferencën Computer Human Interaction (CHI 2011), e cila u mbajt në Vancouver të Kanadasë.

Zgjedhje vendore në Shqipëri

Në 8 Maj 2011, në Shqipëri u zhvilluan zgjedhjet vendore. Zgjedhjet u zhvilluan në një atmosferë të nxehtë politike dhe për këtë arsye, u ndoqën me interes të madh si në Shqipëri, ashtu edhe në shtetet perëndimore.

Sipas raportit të OSBE'së, pavarësisht nga sjellja e papërgjegjshme e partive politike dhe normat e larta të polarizimit politik, zgjedhjet u zhvilluan në një mjedis transparent.

Në zgjedhjet e 8 majit garuan dy koalicione: "Aleanca për Qytetarin", e përbërë nga Partia Demokratike me 22 parti dhe "Aleanca për të Ardhmen", e përbërë nga Partia Socialiste me 23 parti. Sipas përfundimeve të zgjedhjeve, të cilat në shkallë vendi u vonuan përreth një javë, "Aleanca për Qytetarin" arriti të merrte 52,3 % të votave në të gjithë Shqipërinë dhe doli e para në garë me një përparësi prej 140 mijë votash. "Aleanca për të Ardhmen" arriti të siguronte vetëm 42,7 % të votave në të gjithë Shqipërinë. Ndërsa 5 % e votave shkoi për partitë e tjera. Nga ky rezultat del se "Aleanca për Qytetarin" do të qeverisë në 31 bashki në të gjithë vendin, përfshi këtu edhe bashkinë e kryeqytetit për të cilën gara përfundoi me një avantazh shumë të ngushtë në favor të kandidatit të Partisë Demokratike Lulzim Basha. Ndërsa "Aleanca për të Ardhmen" do të qeverisë në 34 bashki në të gjithë vendin.

Lufta më e ashpër u zhvillua për bashkinë e Tiranës, përfundimet e së cilës u shpallën pas tre javësh. Arsyja e kësaj vonese ishte rezultati fillestar, i cili

favorizonte kandidatin e majtë Edi Ramën, me një avantazh të ngushtë prej 10 votave dhe kërkesa që bëri kandidati i PD, Lulzim Basha për numërimin e votave, të cilat ishin hedhur në kutitë e gabuara. Numërimin e votave në kutitë e gabuara e mbështeti edhe ambasadori Amerikan në Tiranë Alexander A. Arvizu, duke thënë se ato vota pasqyrojnë vullnetin e popullit.

Pas numërimit të votave të hedhura në kutitë e gabuara, rezultati përfundimtar u përmbys në favor të kandidatit të djathtë Lulzim Bashës me një avantazh prej 90 votash. Rezultat ky që u kundërshtua kategorikisht prej koalicionit të majtë dhe u quajt si i paligjshëm.

Mund të themi se këto zgjedhje ishin diçka më shumë se një test politik. Në zgjedhjet parlamentare të viti 2009, partia opozitare PS, me pretekstin se zgjedhjet ishin të manipuluar, bojkotoi për një kohë të gjatë punimet parlamentare. Madje u organizuan protesta dhe greva urie, duke kërkuar zgjedhje të parakohshme. Ndërsa protesta më e madhe që organizoi PS, ishte ajo e 21 Janarit 2011 ku humbën jetën katër qytetarë dhe pas së cilës u thellua edhe më shumë kriza politike në vend.

Mendohet se pas fitores që arriti koalicioni "Aleanca për Qytetarin" në zgjedhjet vendore, ka mundësi që kryeministri Sali Berisha të pranojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare, sepse sipas tij, këto zgjedhje treguan besimin e popullit ndaj reformave të qeverisë së tij.

Bullgari: Sulmohen myslimanët gjatë faljes së xhumasë

Në kryeqytetin Bullgar, Sofie, një grup ekstremist i partisë së djathtë Ataka, sulmoi myslimanët gjatë faljes së namazit të xhumasë në xhaminë Banjabashë. Grupi ekstremist, duke protestuar zërin që dilte nga xhamia, filloi të hidhte slogane të tilla si: "Këtu është Bullgari", "Turqit të zhduken" dhe slogane kundra partisë turke DPS.

Sapo hatibi i xhamisë filloi të mbante vaazin e xhumasë, grupi ekstremist filloi të pengonte vaazin me fishkëllima. Duke mos u mjaftuar me kaq, ata filluan të hedhin vezë, gurë dhe shkopinj kundra xhematit. Ndërkohë, imami i xhamisë i bëri thirrje xhemati që të duronin dhe të qetësoheshin. Më vonë, me ndër-

hyrjen e policisë, situata u qetësua. Ngjarja përfundoi me katër protestues të arrestuar dhe dy myslimanë të lënduar.

